

**PROTOKOLL
I MENAXHIMIT
TË RASTEVE TË
DHUNËS
SEKSUALE
NË NIVEL
VENDOR**

**PËRMES
QASJES
SHUMË-
SEKTORIALE
TË
KOORDINUAR**

Mars 2021



PROTOKOLL I MENAXHIMIT TË RASTEVE TË DHUNËS SEKSUALE TEK TË RRITURAT/RRITURIT NË NIVEL VENDOR

PËRMES QASJES SHUMË- SEKTORIALE TË KOORDINUAR

Protokolli është përgatitur në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale me mbështetjen e UNDP Shqipëri, në kuadër të Programit të Përbashkët të Kombeve të Bashkuara “T’i japim fund dhunës ndaj grave në Shqipëri” financuar nga Qeveria e Suedisë.

TABELA E PËRMBAJTJES

I. HYRJE	3
1.1. QËLLIMI I PROTOKOLLIT DHE FUSHA E VEPRIMIT TË TIJ.....	4
1.2. PËRKUFIZIME	7
1.3. PARIME TË PËRGGJITHSHME DHE ELEMENTËT THELBËSORË	15
1.4. KUADRI LIGJOR DHE TË DREJTAT E VIKTIMAVE TË DHUNËS SEKSUALE.....	22
II. MENAXHIMI I RASTEVE TË DHUNËS SEKSUALE NË NIVEL VENDOR PËRMES QASJES SHUMË-SEKTORIALE TË KOORDINUAR	26
2.1. RËNDËSIA E MENAXHIMIT TË RASTEVE TË DHUNËS SEKSUALE PËRMES QASJES SHUMË-SEKTORIALE TË KOORDINUAR	26
2.2. HAPAT E PPROCESIT TË MENAXHIMIT TË RASTIT	28
2.3. MENAXHIMI I RASTEVE TË DHUNËS SEKSUALE TEK TË RRITURAT / RRITURIT. 30	
<i>HAPI I PARË: IDENTIFIKIMI DHE ANGAZHIMI</i>	30
<i>HAPI I DYTË: VLERËSIMI</i>	32
<i>HAPI I KATËRT: ZBATIMI I NDIHMËS SË PLANIFIKUAR</i>	40
<i>HAPI I PESTË : NDJEKJA E RASTIT NË VAZHDIMËSI</i>	49
<i>HAPI I GJASHTË: MBYLLJA E RASTIT</i>	50
2.4. MENAXHIMI I RASTEVE TË DHUNËS SEKSUALE TË USHTRUAR TEK PERSONAT E MITUR NË FAMILJE	51
<i>HAPI I PARË: IDENTIFIKIMI DHE ANGAZHIMI</i>	51
<i>HAPI I DYTË: VLERËSIMI</i>	52
<i>HAPI I KATËRT: ZBATIMI I NDIHMËS SË PLANIFIKUAR</i>	52
<i>HAPI I PESTË:NDJEKJA E RASTIT NË VAZHDIMËSI</i>	54
<i>HAPI I GJASHTË: MBYLLJA E RASTIT</i>	55
III. UDHËZIME TË MËTEJSHME PËR PARANDALIMIN DHE TRAJTIMIN E RASTEVE TË DHUNËS SEKSUALE	55
3.1. ROLI I INSTITUCIONEVE NË PARANDALIMIN E RASTEVE TË DHUNËS SEKSUALE	55
3.2. INFORMACION MBI INDIVIDËT MË NË RREZIK PËR T’U PREKUR NGA DHUNA SEKSUALE	56
3.3. KËSHILLA PËR PROFESIONISTET / PROFESIONISTËT QË PUNOJNË DREJTPËRDREJT ME VIKTIMAT E DHUNËS SEKSUALE.....	57
3.4. FAKTORËT E RISKUT TEK NJË VIKTIMË E DHUNËS SEKSUALE	58
IV.ANEKSE	60
ANEKS 1: FORMAT TIP REFERIMI TË RASTIT NË QENDRËN E MENAXHIMIT TË KRIZËS PËR RASTET E DHUNËS SEKSUALE	60
ANEKS 2: FORMAT REFERIMI I RASTIT NË INSTITUCIONET E TJERA	63
HARTA E SHËRBIMEVE REZIDENCIALE PUBLIKE DHE JO-PUBLIKE TË STREHIMIT AFATGJATË PËR VIKTIMAT E DHUNËS ME BAZË GJINORE DHE DHUNËS NË FAMILJE	68
V. REFERENCA	69

I. HYRJE

Protokolli i Menaxhimit të Rasteve të dhunës seksuale tek të rriturat/rriturit, në nivel vendor përmes qasjes shumë-sektoriale të koordinuar, u përgatit në vijim të Protokollit të Menaxhimit të Rasteve të dhunës në familje në nivel vendor përmes Mekanizmit të Koordinuar të Referimit (MKR), *për t'iu ardhur në ndihmë anëtarëve të këtij Mekanizmi (por edhe institucioneve të tjera përgjegjëse), për të standardizuar veprimet e nevojshme për një reagim të menjëhershëm, gjithëpërfshirës e me përgjegjshmëri për mbrojtjen dhe trajtimin e rasteve të dhunës seksuale.* Me Mekanizëm të Koordinuar të Referimit të rasteve të dhunës në familje nënkuptojmë mekanizmin e ngritur në nivel vendor në bazë të Ligjit nr. 9669 datë 18.12.2006 “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare” i ndryshuar dhe VKM 334/2011 “Për mekanizmin e bashkërendimit të punës për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare dhe mënyrën e procedimit të tij” (në proces rishikimi). Për rrjedhojë, parimisht ky MKR ka detyrim trajtimin edhe të rasteve të **dhunës seksuale në marrëdhëniet familjare**. Por, për sa kohë në Shqipëri nuk janë ngritur mekanizma apo ekipe të dedikuara për t'iu përgjigjur sulmeve dhe dhunës seksuale me qasje shumë-sektoriale, siç ekzistojnë shembuj të mirë të praktikës botërore, MKR *përmes Ekipit Teknik Ndërdisciplinar bërthamë*, siç do të shpjegohet më tej në këtë Protokoll, do të duhet të ndërmerret hapa dhe veprime konkrete për të mos lënë pa trajtuar edhe raste të sulmit apo dhunës seksuale jashtë marrëdhënieve familjare. Përrjashtim këtu do të bëjë trajtimi i rasteve të viktimave të trafikimit të qenieve njerëzore për qëllime të shfrytëzimit seksual, të cilat trajtohen përmes tërësisë së kuadrit ligjor, politikave e shërbimeve të ngritura dedikuar në mënyrë specifike kësaj forme të dhunës.

Ky protokoll **fokusohet kryesisht tek dhuna seksuale tek të rriturat/rriturit**, pavarësisht gjinisë së viktimës¹ apo marrëdhënies ndërmjet viktimës dhe dhunuesit (pra pavarësisht nëse kemi të bëjmë me dhunë seksuale në çift, midis bashkëshortëve, bashkëjetuesve, midis pjestarëve të tjerë të familjes, incest apo dhunë seksuale jashtë marrëdhënieve familjare siç u sqarua më sipër). Ndërsa trajtimi i rasteve të të miturave/miturve viktimat të dhunës seksuale (qofshin këto raste të incestit apo dhunë seksuale jashtë marrëdhënieve familjare) nuk do të jetë përgjegjësi parësore e punës së MKR-ve. Kjo për të respektuar edhe mënyrën se si këto raste trajtohen në praktikë, ku rolin kryesor e luan Njësia për Mbrojtjen e Fëmijëve, së bashku me Grupin Teknik Ndërsektorial dhe Agjensinë Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës, si dhe me Shërbimin Social Shtetëror. Megjithatë, menaxhimi i këtyre rasteve, padyshim do të krijojë mundësi bashkëpunimi për ofrimin e mbështetjes nga ana e MKR-ve të strukturave përkatëse, në faza të caktuara të trajtimit të rastit të fëmijëve të dhunuar seksualisht, sidomos kur bëhet fjalë për fëmijë të abuzuar seksualisht në familje (incest), siç do të sqarohet më në detaje në vijim në këtë Protokoll.

Protokolli i Menaxhimit të Rasteve të dhunës seksuale tek të rriturat/rriturit shpesh përshkohet nga një gjuhë neutrale nga këndvështrimi gjinor (sidomos ku flitet për “viktimë”, “person të dëmtuar”, “dhunues”, etj.) pikërisht për të dhënë mesazhin se dhuna seksuale prek dhe përjetohet nga njerëz të ndryshëm, pavarësisht gjinisë, identitetit gjinor, orientimit seksual, minoritetit, (pa)aftësive, vendbanimit, apo një tërësie karakteristikash të tjera individuale. Megjithatë, në seksione të veçanta të tij evidentohet fakti që viktimat e rritura, kryesisht nga rastet e ndeshura deri tani në praktikë, janë më së shumti gra, sikurse edhe dhunuesit, po nga rastet e ndeshura në praktikë, janë më së shumti burra.

¹Pavarësisht se në trajtimin e rastit “viktimat” është edhe “e mbijetuar”, në Protokoll është përdorur fjala “viktimë” në respektim të terminologjisë ligjore.

Në parimet e përgjithshme të protokollit theksohet *rëndësia e ofrimit të shërbimeve miqësore dhe me standarde për të gjitha viktimat e rritura të dhunës seksuale, duke u kushtuar vëmendje të veçantë grupeve më të cenueshme* për shkak të orientimit seksual dhe shprehjes së identitetit gjinor, minoriteteve, (pa)aftësive, etj., pra anëtarëve të komunitetit LGBTI+, popullsisë Rome, Egjiptjane, personave me aftësi të kufizuara, etj.

Siç u përmend më sipër, një seksion i veçantë i protokollit gjithashtu ndalet shkurtimisht tek *përgjegjësitë për trajtimin me prioritet edhe të rasteve të viktimave të mitura/mitur të dhunës seksuale në familje*. Në këtë seksion, qëllimi është të tërhiqet vëmendja e anëtarëve të MKR-së dhe institucioneve të tjera përgjegjëse për të trajtuar menjëherë dhe në mënyrë shumë-sektoriale rastet e fëmijëve të dhunuar seksualisht në familje, duke referuar² menjëherë rastin tek strukturat dhe institucionet përkatëse të cilat trajtojnë fëmijët (pra Njësitë e Mbrojtjes së Fëmijëve, Agjensinë Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijëve, etj), por duke mos harruar që, përderisa është një formë dhune e ushtruar ndërmjet anëtarëve të një familjeje, ata kanë përgjegjësi maksimale për të ofruar të gjithë ndihmën dhe burimet e nevojshme, si dhe të bashkëpunojnë në funksion të zgjidhjes së rastit.

Protokolli i Menaxhimit të Rasteve të dhunës seksuale tek të rriturat/rriturit në nivel vendor përmes qasjes shumë-sektoriale të koordinuar u përgatit përmes një procesi të udhëhequr nga Drejtoria e Përgjithshme e Politikave dhe Zhvillimit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, të mbështetur nga UNDP Shqipëri, ku u angazhuan specialistet e Sektorit të Politikave dhe Strategjive të Përfshirjes Sociale dhe Barazisë Gjinore dhe eksperte të fushës³.

Ngjashmërisht me Protokollin e Menaxhimit të Rasteve të dhunës në familje në nivel vendor përmes Mekanizmit të Koordinuar të Referimit (MKR), edhe ky protokoll i menaxhimit të rasteve të dhunës seksuale tek të rriturat/rriturit **miratohet nga anëtarët e Komitetit Drejtues të MKR-ve në nivel vendor**.

1.1. QËLLIMI I PROTOKOLLIT DHE FUSHA E VEPRIMIT TË TIJ

Qëllimi i Protokollit të Menaxhimit të Rasteve të dhunës seksuale tek të rriturat/rriturit në nivel vendor përmes qasjes shumë-sektoriale të koordinuar, është të sigurojë mbrojtjen, referimin, rehabilitimin dhe ri-integrimin e rasteve të dhunës seksuale tek të rriturat/rriturit, përmes ndërhyrjeve të menjëhershme e të standardizuara të anëtarëve të Mekanizmit të Koordinuar të Referimit të rasteve të dhunës në familje, sidomos të Ekipit Teknik Ndërdisciplinar bërthamë të MKR-së. Kjo do të realizohet në përputhje me detyrimet dhe rolin e tyre, të përshkruar në legjislacionin në fuqi për trajtimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare, përfshirë legjislacionin që fokusohet specifikisht tek dhuna seksuale edhe jashtë marrëdhënieve familjare, si dhe në të gjithë dokumentat e miratuara në funksion të zbatimit të këtij legjislacioni. Tërheqim vëmendjen në faktin që pjesë e rëndësishme e kuadrit ligjor në Shqipëri janë edhe të gjitha dokumentat ndërkombëtarë të ratifikuar, prandaj në këtë këndvështrim, brenda bazës ligjore kemi parasysh ndër të tjera edhe Konventën e Kombeve të Bashkuara për Eliminimin e të Gjitha Formave të diskriminimit ndaj Grave

² Për këtë qëllim, është menduar gjithashtu të përgatitet edhe një Protokoll i detajuar për trajtimin e rasteve të dhunës seksuale tek të miturat/miturit.

³Znj. Aurela Bozo, znj. Erjola Vako, znj. Marsela Allmuça dhe znj. Monika Kocaqi, të kontraktuara nga UNDP Shqipëri. Protokollin është pasuruar me sugjerimet e znj. Brunilda Dervishaj dhe znj. Irena Benussi në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, znj. Edlira Papavangjeli dhe znj. Elona Dini, UNDP Shqipëri, si dhe me kontributin e veçantë të stafit të Qendrës « Vatra » Vlorë dhe « Të Ndryshëm e Të Barabartë », Tiranë. Ky protokoll ka përfutur dhe nga mendimet e UN Women Shqipëri.

(Konventa CEDAW) apo Konventën e Këshillit të Evropës për parandalimin dhe luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje (Konventa e Stambollit), të cilat theksojnë rëndësinë e trajtimit të të gjitha formave të dhunës ndaj grave.

Thënë ndryshe, qëllimi i këtij Protokoll është:

1. Të mbrojnë të drejtat e viktimave të dhunës seksuale, duke garantuar ofrimin e një pakete të plotë të shërbimeve me në qendër viktimën si dhe të ndjeshme ndaj moshës dhe gjinisë.
2. Të sigurojnë një tërësi procedurash standarde të veprimeve të ndjeshme ndaj moshës dhe gjinisë, veprime këto që duhet të ndërmerren për të siguruar këtë përgjegje të plotë ndaj grave dhe fëmijëve të dhunuar seksualisht në familje apo jashtë saj.
3. Të forcojnë dhe qartësojnë rolet dhe përgjegjësitë ndërmjet ofruesve të shërbimeve dhe tërësisë së anëtarëve të Mekanizmave të Koordinuar të Referimit, duke rritur kështu llogaridhënien dhe besueshmërinë ndaj tyre.

Ky protokoll shërben si një mjet për t'u përdorur nga Mekanizmat e Koordinuar të Referimit të rasteve të dhunës në familje të ngritur në nivel të vetëqeverisjes vendore, për të përmirësuar përvojat e viktimave të rritura të dhunës seksuale, si dhe për orientuar institucionet anëtare mbi mënyrën se si duhet të funksionojnë për trajtimin e rasteve të tilla. Ky protokoll është hartuar për t'u përqendruar në elementët kritikë të reagimit ndaj dhunës seksuale që mbështesin dinjitetin e viktimave. Përmes miratimit të këtij protokoll, secili institucion anëtar i MKR-së në nivel vendor pranon të përdorë këtë informacion për të forcuar praktikën, politikën dhe procedurat e tyre. Pajtueshmëria me këtë protokoll mund të kërkojë ndryshime dhe secili institucion përgjegjës bie dakord të investojë kohën dhe burimet e duhura për të siguruar ndryshimin.

Përderisa u drejtohet anëtarëve të Mekanizmave të Koordinuar të Referimit në nivel vendor, kuptohet që kur flitet për menaxhimin e rasteve dhe tryeza të mbledhjes në funksion të këtij qëllimi, theksi vihet tek puna që duhet të bëjë **Ekipi Teknik Ndërdisciplinar (ETN) bërthamë** si dhe ETN në tërësi si struktura përgjegjëse brenda MKR-së, pikërisht për menaxhimin e rasteve, përfshirë edhe ato që lidhen me dhunën seksuale. Ndërsa eksperiencat e mirë botërore sugjerojnë ngritjen e **Ekipeve të Përgjigjes ndaj Sulmit Seksual**. Në vijim qartësohet se cili është dallimi ndërmjet tyre.

Përbërja e një Ekipi Teknik Ndërdisciplinar (ETN) është shumë më e gjerë sesa përbërja e një Ekipi të Përgjigjes ndaj Sulmit Seksual (SART-Sexual Assault Response Team). **SART** janë ekipe të ngritura në shtete të ndryshme të botës në përputhje me legjislacionin e tyre në fuqi, për të trajtuar menjëherë të gjitha rastet e sulmeve seksuale tek të rriturit/riturat apo të miturit/miturat. SART përbëjnë një model shumë specifik të ndërhyrjes dhe zakonisht përfshijnë profesioniste e profesionistë nga sistemi i drejtësisë, shëndetësisë dhe shërbimeve të kujdesit shoqëror. Anëtarët e SART kryesisht fokusohen në menaxhimin e rastit të spondodhur. Një shembull i ngjashëm me SART mund të jetë ekipi i qendrave të specializuara në trajtimin e rasteve të sulmeve seksuale, siç është për momentin në Shqipëri Qendra "LILIUM".

ETN janë ekipe të ngritura si pjesë e Mekanizmave të Koordinuar të Referimit të rasteve të dhunës në familje në nivel vendor dhe përbëhen nga specialiste e specialistë të të gjitha institucioneve anëtare të MKR-ve, që përfshijnë por nuk kufizohen tek njësitë e vetëqeverisjes vendore, gjyqësori, policia, prokuroria, përmbartimi, shërbimi i provës, mjeku ligjor, shëndetësia, arsimit, punësimi, shërbime të kujdesit shoqëror, prefekti, organizata të shoqërisë civile të specializuara të fokusuar tek dhuna në familje, përfaqësues të

komuniteteve fetare, etj. Por gjatë funksionimit të tyre për trajtimin e rasteve, brenda ETN krijohet një **ETN bërthamë** që përbëhet nga një numër i kufizuar antarësh të cilët mbidhen menjëherë dhe trajtojnë nevojat emergjente të rastit, e më pas bëjnë referimin e rastit edhe tek anëtarët e tjerë. ETN bërthamë përbëhet kryesisht nga Koordinatorja/Koordinatori Vendor kundër dhunës në familje, përfaqësues të policisë, shëndetësisë, mjeku ligjor dhe përfaqësues të shërbimeve të kujdesit shoqëror. Pra ETN bërthamë është shumë e ngjashme me SART që u përshkruan më sipër si ekipet e duhura për trajtimin e rasteve të sulmeve seksuale, sipas eksperiencës botërore. ETN, që funksionon mbi parimin e reagimit të koordinuar të komunitetit, trajton dhunën në familje në të gjitha format e saj, pra përfshirë edhe dhunën seksuale. Natyrshëm një pjesë e antarëve në përbërje të ETN mund të jenë edhe në përbërje të SART (derisa të ngrihen ekipe të tilla në Shqipëri), në përbërje të Grupeve Teknike Ndërsektoriale për menaxhimin e rasteve të fëmijëve të abuzuar, në përbërje të Tryezave Teknike për menaxhimin e rasteve të viktimave/viktimave të mundshme të trafikimit të qenieve njerëzore, (pavarësisht kuadrit ligjor të veçantë kur flitet për këtë formë dhune), apo edhe në përbërje të Këshillave Vendorë të Sigurisë Publike (KSVP) të cilat kanë filluar të ngihen në nivel vendor, duke pasur parasysh më shumë adresimin e esktrëmizmit të dhunshëm.

Një tjetër karakteristikë e ETN është se kur ngarkohet me përgjegjësinë e menaxhimit të rasteve të dhunës seksuale, ky ekip nuk fokusohet vetëm në trajtimin e rasteve të spondodhura. ETN gjithashtu zgjeron komunikimin, rrjetëzimin dhe bashkëpunimin ndërmjet një tërësie aktorësh, të cilët jo vetëm diskutojnë mbi fenomenin dhe pasojat e tij, por njëkohësisht edhe marrin pjesë në mënyrë të barabartë e gjithëpërfshirëse në dhënien e shërbimeve të nevojshme për menaxhimin e rasteve, pavarësisht nëse janë të spondodhura apo nëse kanë ndodhur vite më parë, si dhe përgatitjen e strategjive parandaluese dhe të ndërgjegjësimit të komunitetit, për të zvogëluar rastete dhunës seksuale.

Idealisht, ETN kundër dhunës në familje, do të ishte mirë të mos merrej me menaxhimin e rasteve të dhunës seksuale, por të mjaftohej vetëm me referimin e këtyre rasteve në ekipet përkatëse të specializuara të përgjigjes ndaj sulmeve seksuale. Por, siç u theksua më sipër, këto ekipe të dedikuara mungojnë në Shqipëri ndërsa numri i shërbimeve mbështetëse të specializuara për viktimat e dhunës seksuale është ende tepër i limituar. Për rrjedhojë, ***reagimi i ETN për menaxhimin e rasteve të sulmeve seksuale është domosdoshmëri***, paralelisht dhe me punën dhe përpjekjet për parandalimin e këtyre rasteve, fuqizimin e kapaciteteve të profesionisteve e profesionistëve, si dhe ndërgjegjësimin e komunitetit në tërësi mbi këtë formë dhune. Menaxhimi i rasteve të dhunës seksuale tek të rriturat/rriturit, deri në momentin e ngritjes së strukturave të posaçme si SART do të vijojë të bëhet nga **ETN bërthamë** (si dhe nga ETN në tërësi për adresimin e nevojave afatgjata), pra nga MKR në nivel vendor.

Anëtarët e ETN-së, sidomos të ETN bërthamë, në çdo MKR në vend, duhet të mbajnë në konsideratë:

Trajtimi i rasteve të dhunës seksuale në marrëdhëniet familjare të viktimave të rritura (dhunë seksuale ndërmjet partnerëve, incest, përdhunim martesor), si dhe i rasteve të dhunës seksuale jashtë marrëdhënieve familjare (përdhunim martesor të trafikimit të qenieve njerëzore siç u sqarua më sipër), duhet të bëhet me të njëjtin prioritet, qasje e filozofi, në mënyrë gjithëpërfshirëse e të koordinuar, sikurse dhe trajtimi i të gjitha rasteve të formave të tjera të dhunës në marrëdhëniet familjare. ETN bërthamë, e koordinuar nga

Koordinatorja/Koordinatori Vendor kundër Dhunës në Familje mban përgjegjësi që nga identifikimi dhe vënia në kontakt me rastin e deri në riintegrimin afatgjatë të viktimës, ku angazhohen të gjithë antarët e ETN-së.

Trajtimi i rasteve të dhunës seksuale në marrëdhëniet familjare të viktimave të mitura, duhet të bëhet me të njëjtin prioritet, qasje e filozofi, në mënyrë gjithëpërfshirëse e të koordinuar, sikurse dhe trajtimi i të gjitha rasteve të formave të tjera të dhunës në marrëdhëniet familjare, **POR** në koordinim të plotë, si dhe kur është rasti, **duke i lënë udhëheqjen Grupit Teknik Ndërsektorial (GTN)** që ngrihet për rastet e fëmijëve të abuzuar në përputhje me nenin 52 të Ligjit 18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”, i koordinuar nga Specialistja/Specialisti i Mbrojtjes së Fëmijëve. ETN dhe GTN në këtë rast organizojnë takime të përbashkëta ndërkohë që Koordinatorja/Koordinatori Vendor kundër dhunës në familje dhe Specialistja/Specialisti i Mbrojtjes së Fëmijëve ndjekin bashkërisht referimin dhe menaxhimin e rastit, duke u paraqitur së bashku në polici për të ndjekur procedurën e vlerësimit të riskut apo edhe në gjykatë për paraqitjen e provave, nëse është rasti. Përpilimi i të gjitha raporteve të vlerësimit të kryer nga ana e tyre, si dhe vizitat në ambjentet e shtëpisë apo në institucionet përkatëse, gjithashtu rekomandohet të kryhen bashkërisht.

Trajtimi i rasteve të dhunës seksuale tek viktimat e rritura të cilat nuk janë abuzuar në marrëdhëniet familjare (përdhunim jo-martesor, jo nga partneri/ish-partneri, dhunë seksuale në ambjentet e punës, etj.) në mungesë të një ekipi të specializuar për t’iu përgjigjur rasteve të sulmeve seksuale në njësinë e vetëqeverisjes vendore ku është ngritur dhe funksionon MKR, do të trajtohet nga anëtarët e ETN-së bërthamë të MKR përkatëse, bazuar në këtë protokoll.

Trajtimi i rasteve të dhunës seksuale për viktimat/viktimat e mundshme të trafikimit të qenieve njerëzore për qëllime të shfrytëzimit seksual, sugjerohet që të bëhet përmes tryezave teknike anti-trafik të ngritura për këtë qëllim, në përputhje me protokollet, procedurat standarde të veprimit dhe tërësinë e dokumentave ligjorë, të politikave e shërbimeve ekzistuese, siç parashikohet në kuadrin ligjor të posaçëm në fuqi, që qartësisht ndan trajtimin e kësaj forme të dhunës nga forma të tjera të dhunës ndaj grave e vajzave apo dhunës në familje.

Shërbimet që ofron *ETN gjatë trajtimit të rasteve të dhunës seksuale duhet të jenë profesionale, me në qendër viktimën, të ndjeshme e miqësore ndaj moshës e gjinisë, me një gjuhë e komunikim të përshtatshëm* në përputhje me dhe në varësi të grupit të cenueshëm të cilit i përket viktimat (persona me aftësi të kufizuara, minoritetet, komuniteti LGBTI+, azilkërkues, etj.).

1.2. PËRKUFIZIME⁴

Dhunë përkufizohet “Çdo veprim ose mosveprim i një personi ndaj një personi tjetër, që sjell si pasojë cënim të integritetit fizik, moral, psikologjik, **seksual**, social, ekonomik”.

⁴Në mënyrë të veçantë i referohemi Ligjit nr. 9669, datë 18.12.2006 “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, i ndryshuar; Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë, VKM 334/2011 “Për mekanizmin e bashkërendimit të punës për referimin e rasteve të dhunës në familje dhe mënyrën e procedimit të tij, etj.

“Dhunues” është çdo person i dyshuar dhe/ose i paditur për ushtrimin e dhunës në marrëdhëniet familjare përpara organeve kompetente.

Viktimë përkufizohet “Personi mbi të cilin është ushtruar çdo veprim ose mosveprim i një personi tjetër, që sjell si pasojë cenim të integritetit fizik, moral, psikologjik, **seksual**, social, ekonomik”. Përgjatë gjithë protokollit, do t’i referohemi këtij përkufizimi ligjor (pra “viktimë”) pavarësisht se një sërë profesionistësh apo qendrash që ofrojnë shërbime mbështetëse të specializuara për rastet e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje, më së shumti përdorin termin “i/e mbijetuar” apo edhe “viktimë/i/e mbijetuar”.

Dhunë në familje përkufizohet “Çdo veprim ose mosveprim i një personi ndaj një personi tjetër, që sjell si pasojë cenim të integritetit fizik, moral, psikologjik, **seksual**, social, ekonomik, që ndodh brenda familjes ose njësisë shtëpiake, e ushtruar ndërmjet pjesëtarëve të familjes, që janë ose kanë qenë në marrëdhënie familjare, pavarësisht nga fakti nëse dhunuesi ndan ose ka ndarë të njëjtën banesë me viktimën.

Fëmijë është çdo person nën moshën 18 vjeç. Termi “i mitur/e mitura”, i përdorur në këtë protokoll, ka të njëjtin kuptim.

Pjesëtarë të familjes janë: a) bashkëshorti/ja ose bashkëjetuesi/bashkëjetuesja apo ish-bashkëshorti/bashkëshortja apo ish-partneri/partnerja bashkëjetues; b) vëllezërit, motrat, përfshirë, sipas rastit, edhe bashkëshortin/bashkëshorten ose bashkëjetuesin/bashkëjetuesen e tyre, si dhe nipin e mbesën, nëse këta të fundit janë anëtarë të njësisë shtëpiake; c) paraardhësit dhe pasardhësit në vijë të drejtë, pa kufizime, përfshirë edhe rastet kur kjo marrëdhënie krijohet nëpërmjet birësimit; ç) prindërit e bashkëshortit/bashkëshortes ose të bashkëjetuesit/bashkëjetueses, përfshirë dhe thjeshtrin/thjeshtrën, edhe sikur kjo lidhje të burojë nga birësimi; d) gjinia në vijë të drejtë, përfshirë edhe prindërit, edhe fëmijët e birësuar të bashkëshortit/bashkëshortes ose bashkëjetuesit/bashkëjetueses; dh) vëllezërit dhe motrat e bashkëshortit/bashkëshortes, bashkëjetuesit/bashkëjetueses; e) fëmijët e bashkëshortëve ose partnerëve bashkëjetues; ë) personat, të cilët janë ose kanë qenë në marrëdhënie intime, jo domosdoshmërisht të shoqëruar me bashkëjetesë, gëzojnë të njëjtën mbrojtje; f) kujdestari dhe personi që ndodhet në kujdesin e tij gjatë kohës që vazhdon kujdestaria, sipas përcaktimeve të kujdestarisë mbi të miturit dhe kujdestarisë për personat me aftësi të kufizuar dhe personit që i është hequr ose kufizuar zotësia për të vepruar sipas dispozitave të Kodit të Familjes”.

Dhuna në familje është gjithashtu vepër penale e parashikuar në Nenin 130/a të Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë, (ndryshuar në vitin 2020: “Rrahja, si dhe çdo vepër tjetër dhune fizike, **psikologjike**, ndaj personit që është bashkëshort, ish-bashkëshort, bashkëjetues apo ish-bashkëjetues, gjini e afërt (të paralindur, të paslindur, vëllezër, motra, ungjër, emta, nipër, mbesa, fëmijë të vëllezërve dhe të motrave), ose krushqi e afërt (vjuhërr, vjuhërrë, dhëndër, nuse, kunat/ë, thjeshtri, thjeshtra, njerku e njerka), ose në lidhje apo ish-lidhje intime me autorin e veprës penale, me pasojë cenimin e integritetit fizik, psiko-social dhe ekonomik të tij, dënohet me burgim deri në tre vjet. Kanosja serioze për vrasje ose plagosje të rëndë, ndaj personit që është bashkëshort, ish bashkëshort, bashkëjetues apo ish-bashkëjetues, gjini e afërt (të paralindur, të paslindur, vëllezër, motra, ungjër, emta, nipër, mbesa, fëmijë të vëllezërve dhe të motrave), ose krushqi e afërt (vjuhërr, vjuhërrë, dhëndër, nuse, kunat/ë, thjeshtri, thjeshtra, njerku e njerka), ose në lidhje apo ish-lidhje intime me autorin e veprës penale, me pasojë cenimin e integritetit psikik të tij, dënohet me burgim deri në katër vjet. Plagosja e kryer me dashje, ndaj personit që është bashkëshort, ish-bashkëshort, bashkëjetues

apo ish-bashkëjetues, gjini e afërt (të paralindur, të paslindur, vëllezër, motra, ungjër, emta, nipër, mbesa, fëmijë të vëllezërve dhe të motrave), ose krushqi e afërt (vjuhërr, vjehrrë, dhëndër, nuse, kunat/ë, thjeshtri, thjeshtra, njerku e njerka), ose në lidhje apo ishlidhje intime me autorin e veprës penale, që ka shkaktuar paaftësi të përkohshme në punë më tepër se nëntë ditë, dënohet me burgim deri në pesë vjet. Po këto vepra, të kryera në mënyrë të përsëritur, ose në praninë e fëmijëve, dënohen nga një deri në pesë vjet burgim”.

Dhunë fizike përkufizohet “Përdorimi i forcës fizike kundër dikujt në një mënyrë që lëndon, dëmton, ose e rrezikon atë person. Dhuna fizike përfshin një gamë të gjerë sjelljesh si gërvishtjet, shtyrjet, hedhjet, kapjet me forcë, kafshimet, vënien e duarve në fytyrë, pickimet, shpimet, shkuljet e flokëve, përdredhjet e krahut, shuplakat, shtrëngimin me forcë, goditjet, rrahjet, goditjet me shkelma, djegiet, goditjet me thikë, shtrëngimi i fytyrës/mbytjet. Dhuna fizike mund të përfshijë edhe përdorimin e madhësisë trupore dhe të forcës, mjeteve të kufizimit të lirisë dhe/ose armëve nga ana e një personi (p.sh., armë zjarri, thikë apo ndonjë objekt tjetër) për të fituar dhe mbajtur kontrollin mbi një person tjetër”

Dhunë psikologjike përfshin “Një gamë sjelljesh që kanë për qëllim të kritikojnë, poshtërojnë, mbajnë nën kontroll, izolojnë, trembin shkaktojnë frikë dhe të sulmojnë karakterin e një individi duke shkatërruar kështu ndjenjën e tij të vetë-vlerësimit, vetë-besimit, dhe sigurisë. Fyerjet, poshtërimet, të folurit në një mënyrë që sulmon karakterin e individit, të shkaktuarit e ndjenjës së frikës nëpërmjet kërcënimeve për ta lënduar fizikisht një individ dhe/ose persona të tjerë të afërt me të dhe/ose për të shkatërruar diçka të rëndësishme për të, janë disa prej formave të dhunës verbale, sulmit psikologjik e dhunës emocionale që përfshihen si pjesë e dhunës psikologjike (siç u citua më sipër dhuna psikologjike gjithashtu është vepër penale, me ndryshimet që iu bënë Kodit Penal në prill 2020).

Dhunë ekonomike përkufizohet “Mbajtja nën kontroll e parave nga një individ, pavarësisht nëse janë të fituara apo jo prej tij, ushtrimi i kontrollit dhe monitorimi i veprimit të një individi kundrejt një individi tjetër mbi përdorimin dhe shpërndarjen e parave, përfshirë dhe ato të fituara prej punës së këtij të fundit, shpërdorimi për qëllime të kënaqësive vetjake nga ana e një individi, i parave të domosdoshme për sigurimin e kushteve bazë të jetesës së familjarëve, kërcënimi konstant për ndërprerjen e burimeve ekonomike, detyrimi i një individi për të plotësuar të gjitha nevojat bazë të familjarëve për një periudhë të caktuar (p.sh. mujore), me një kuotë nën minimalen e parave që të nevojiteshin për këtë qëllim, etj.”

Dhunë seksuale përkufizohet “Çdo akt seksual, përpjekje për të kryer një akt seksual, komente ose prekje seksuale të padëshiruara, ose çdo veprim tjetër kundrejt seksualitetit të një personi duke përdorur shtrëngim, nga cilido person pavarësisht nga marrëdhënia e tyre me viktimën, në çdo mjedis, duke përfshirë por pa u kufizuar në shtëpi dhe punë. Shtrëngimi mund të mbulojë një spektër të tërë të shkallëve të forcës. Përveç forcës fizike, mund të përfshijë kërcënime psikologjike, presion ose kërcënime të tjera - për shembull kërcënimi i dëmit fizik, largimi nga puna ose mos marrja e një pune që kërkohet. Mund të ndodhë edhe kur personi i sulmuar nuk është në gjendje të japë pëlqimin - për shembull, kur është i dehur, droguar, në gjumë ose mendërisht i paaftë për të kuptuar situatën. Dhuna seksuale përfshin **përdhunimin**, të përkufizuar si shtrëngim fizik ose penetrim duke përdorur shtrëngimin – edhe nëse në masë të vogël - të vulvës ose anusit, duke përdorur një penis, pjesë të tjera të trupit ose një objekt. Përpjekja për ta bërë këtë njihet si **tentativë për përdhunim**. Përdhunimi i një personi nga dy ose më shumë autorë është i njohur si **përdhunim në grup**. Dhuna seksuale mund të përfshijë forma të tjera të sulmit mbi një organ seksual, duke përfshirë

kontaktet e detyruara midis gojës dhe penisit, vulvës ose anusit. Termat sulm seksual, përdhunim, abuzim seksual dhe dhunë seksuale përdoren shpesh në mënyrë të ndërsjellë”.

Dhuna seksuale është gjithashtu e parashikuar si veprë penale. Në nenin 107/a të Kodit Penal theksohet se: “Ushtimi i dhunës seksuale, nëpërmjet kryerjes së veprimeve me natyrë seksuale në trupin e një personi tjetër me objekte, përbën veprë penale dhe dënohet me burgim nga tre deri në shtatë vjet. Kur kjo veprë kryhet në bashkëpunim, kundër disa personave, më shumë se një herë, ose kundër fëmijëve të moshës katërbëdhjetë deri në tetëmbëdhjetë vjeç dënohet me burgim nga pesë deri në pesëmbëdhjetë vjet. Kur kjo veprë kryhet ndaj një të mituri që nuk ka arritur moshën katërbëdhjetë vjeç apo një të mituri që nuk ka arritur pjekurinë seksuale, pavarësisht nëse kryhet me dhunë apo jo, dënohet me burgim jo më pak se njëzet vjet. Kur kjo veprë ka sjellë si pasojë vdekjen ose vetëvrasjen e të dëmtuarit dënohet me burgim jo më pak se njëzet e pesë vjet”. Po kështu, në Kodin Penal bëhen edhe një sërë parashikimesh të tjera lidhur me marrëdhëniet seksuale me dhunë. Konkretisht, në nenin 102 **“Marrëdhënie seksuale me dhunë me të rritura”** parashikohet se “Kryerja e marrëdhënieve seksuale me dhunë, me të rritura ose midis bashkëshortëve apo bashkëjetuesve, pa pëlqimin e njërit prej tyre, dënohet me burgim nga tre gjer në dhjetë vjet. Kur marrëdhënia seksuale me dhunë kryhet në bashkëpunim ose më shumë se një herë, ose kur të dëmtuarës i shkaktohen pasoja të rënda për shëndetin, dënohet me burgim nga pesë gjer në pesëmbëdhjetë vjet. Kur vepra ka sjellë si pasojë vdekjen ose vetëvrasjen e të dëmtuarës, dënohet me burgim nga dhjetë gjer në njëzet vjet”. Neni 102/a **“Marrëdhënie homoseksuale me dhunë me të rritur”** parashikon se “Kryerja e marrëdhënieve homoseksuale me dhunë me të rritur dënohet me burgim nga tre gjer në shtatë vjet. Kur marrëdhënia homoseksuale me dhunë kryhet në bashkëpunim ose më shumë se një herë, ose kur të dëmtuarit i shkaktohen pasoja të rënda për shëndetin, dënohet me burgim nga pesë gjer në dhjetë vjet. Kur vepra ka sjellë si pasojë vdekjen ose vetëvrasjen e të dëmtuarit dënohet me burgim nga dhjetë gjer në njëzet vjet”. Neni 103 **“Marrëdhënie seksuale ose homoseksuale me persona të pazotë për t’u mbrojtur”** parashikon se “Kryerja e marrëdhënieve seksuale ose homoseksuale, duke përfutur nga pazotësia fizike ose mendore e personit të dëmtuar ose, nga vendosja në gjendje të pandërgjegjshme, dënohet me burgim nga pesë gjer në dhjetë vjet. Kur marrëdhënia seksuale ose homoseksuale kryhet në bashkëpunim ose më shumë se një herë, ose kur personit të dëmtuar i shkaktohen pasoja të rënda për shëndetin, dënohet me burgim nga shtatë gjer në pesëmbëdhjetë vjet. Kur vepra ka sjellë si pasojë vdekjen ose vetëvrasjen e personit të dëmtuar dënohet me burgim nga dhjetë gjer në njëzet vjet”. Neni 104 **“Marrëdhënie seksuale ose homoseksuale me kërcënim me përdorimin e armës”**, parashikon se: “Kryerja e marrëdhënieve seksuale ose homoseksuale, duke kërcënuar personin e dëmtuar për përdorim aty për aty të armës, dënohet me burgim nga pesë gjer në pesëmbëdhjetë vjet”. Neni 105 **“Marrëdhënie seksuale ose homoseksuale duke shpërdoruar detyrën”** parashikon se: “Kryerja e marrëdhënieve seksuale ose homoseksuale duke shpërdoruar marrëdhëniet e varësisë ose të detyrës, dënohet me burgim gjer në tre vjet”. Neni 106 **“Marrëdhënie seksuale ose homoseksuale me persona në gjini ose nën kujdestari”** parashikon se: “Kryerja e marrëdhënieve seksuale ose homoseksuale ndërmjet prindit dhe fëmijës, vëllait dhe motrës, ndërmjet vëllezërve, motrave, ndërmjet personave të tjerë që janë gjini në vijë të drejtë ose me persona që ndodhen në raporte kujdestarie ose të birësisimit, dënohet me burgim gjer në shtatë vjet”. Parashikime në Kodin Penal bëhen edhe për vepra të tjera si kryerja e marrëdhënieve seksuale apo homoseksuale në vendet publike si dhe për kryerjen e veprave të turpshme me të mitur, apo përfshirjen e qëllimshme si dëshmitar të një të mituri në veprime me natyrë seksuale, pornografia, etj. Neni 50 i Kodit Penal, **“Rrethanat rënduese”** në pikën g parashikon se: “kur vepra është kryer

duke përfituar nga marrëdhëniet familjare, të bashkëjetesës, të miqësisë, të mikpritjes” rëndon dënimin.

Dhunë ndaj grave përkufizohet si “Shkelje e të drejtave të njeriut dhe një formë diskriminimi kundër grave dhe nënkupton të gjitha aktet e dhunës gjinore që çojnë ose mund të çojnë në dëmtim ose vuajtje fizike, seksuale, psikologjike ose ekonomike për gratë, duke përfshirë kërcënime për kryerjen e këtyre akteve, shtrëngim ose heqje arbitrare të lirisë, qoftë nëse ndodh në jetën publike ose private. Dhuna ndaj grave përfshin lloje të ndryshme të dhunës që pësojnë gratë, të rejat dhe vajzat, si dhunën në familje, dhunën nga partneri intim, dhunën seksuale nga një person jo-partner intim, ngacmimin seksual, martesën e detyruar, abortin dhe sterilizimin e detyruar, përndjekjen, krimet në emër të nderit, trafikimin dhe praktika të dëmshme si gjymtimi i organeve gjenitale femërore”.

Dhunë me bazë gjinore përkufizohet “Çdo akt dhune që drejtohet ndaj një gruaje për shkak se është grua ose qëndikon tek gratë në mënyrë disproporcionale”. Një formë diskriminimi që pengon seriozisht aftësinë e gruas për të gëzuar të drejta dhe liri të barabarta me burrat. Ajo përbën një shkelje të së drejtës themelore për jetesë, liri, siguri, dinjitet, barazi ndërmjet grave dhe burrave, mosdiskriminim dhe integritet fizik dhe mendor.

Ngacmim seksual përkufizohet si: “Çdo formë sjelljeje e padëshiruar verbale, jo-verbale ose fizike e një natyre seksuale, me qëllimin ose efektin e shkeljes së dinjitetit të një personi, veçanërisht kur krijohet një mjedis kërcënues, armiqësor, degradues, poshtërues ose fyes” Ngacmimi seksual është gjithashtu vepër penale dhe parashikohet në nenin 108/a të Kodit Penal të RSH sipas të cilit: "Kryerja e sjelljeve me natyrë seksuale, që cenonë dinjitetin e një personi, me çdo mjet ose formë, duke krijuar një mjedis kërcënues, armiqësor, degradues, poshtërues ose ofendues, përbën vepër penale dhe dënohet me burgim nga një deri në pesë vjet. Kur kjo vepër kryhet në bashkëpunim, kundër disa personave, më shumë se një herë, ose kundër fëmijëve, dënohet me burgim nga tre deri në shtatë vjet".

Përndjekja si vepër penale, parashikohet në nenin 121/a të Kodit Penal sipas të cilit: “Kërcënimi ose ngacmimi i personit me anën e veprimeve të përsëritura, me qëllimin për t’i shkaktuar një gjendje të vazhdueshme dhe të rëndë ankthi apo frike për sigurinë vetjake, të një të afërmi ose të një personi, me të cilin ka lidhje shpirtërore, apo për ta detyruar të ndryshojë mënyrën e tij të jetesës, dënohet me burgim nga gjashtë muaj gjer në katër vjet. Kur kjo vepër kryhet nga ish-bashkëshorti, ish-bashkëjetuesi apo personi që ka pasur lidhje shpirtërore me të dëmtuarin, dënimi rritet me një të tretat e dënimit të dhënë. Kur kjo vepër kryhet ndaj të miturit, gruas shtatzënë ose një personi të pazotë për t’u mbrojtur, si dhe kur kryhet nga një person i maskuar ose shoqërohet me mbajtjen ose me përdorimin e armëve, dënimi rritet deri në një të dytën e dënimit të dhënë”.

Marrëdhënia intime përkufizohet si “Marrëdhënia ndërpersonale që përfshin, intimitet fizik ose emocional”

Dhunë nga partneri intim cilësohet si forma më e përhapur e dhunës e përjetuar nga gratë, të rejat apo adoleshentet në të gjithë botën dhe përfshin “një sërë veprimesh shtrënguese seksuale, psikologjike dhe fizike nga një partner intim aktual ose i mëparshëm, pa pëlqimin e tyre”.

Dhuna nga partneri intim dhe dhuna seksuale. Sulmi seksual nuk ekziston në izolim, por brenda një problemi më të madh shoqëror të dhunës ndaj grave. Një numër i madh i grave që

vuajnë nga dhuna nga partneri intim gjithashtu përjetojnë sulme seksuale, por ato e raportojnë rrallë dhunën seksuale. Disa gra mund të mos i konceptojnë sulmet seksuale brenda një marrëdhënieje intime si një krim. Përveç kësaj, sulmet seksuale janë shumë më të stigmatizuara se dhuna nga partneri intim, kështu që gratë mund të ndiehen të paaftha për ta adresuar edhe këtë formë dhune kur kërkojnë ndihmë. Megjithatë, termi “dhuna nga partneri intim” dhe “dhuna seksuale” **nuk janë sinonime**. Gratë që vuajnë nga dhuna nga partneri intim nuk janë domosdoshmërisht viktima të dhunës seksuale si pjesë e asaj përvoje. Përveç kësaj, shumë gra vuajnë nga dhuna seksuale jashtë një marrëdhënieje me një partner intim.

Dhuna në takime/lidhje dashurie cilësohet si “Model i sjelljeve abuzive, përfshirë abuzimin emocional, fizik, seksual dhe financiar të përdorura për të ushtruar pushtet dhe kontroll tek partneri në një takim apo lidhje dashurie”. Në mënyrë të ngjashme, Instituti Evropian për Barazinë Gjinore (EIGE) e përkufizon dhunën në një takim/lidhje dashurie si “Iloji i dhunës nga partneri intim që ndodh midis dy personave në një marrëdhënie të ngushtë”.

Sulm Seksual përkufizohet si “Akt seksual me apo pa kontakt fizik, i kryer nga një individ pa pëlqimin e viktimës ose, në disa raste, dhe veçanërisht kur janë të përfshirë fëmijët, përmes manipulimeve emocionale ose shantazhit. Është një veprim që e detyron një person t'u nënshtrohet dëshirave të një personi tjetër përmes shpërdorimit të pushtetit, përdorimit të forcës, detyrimit, ose kërcënimeve”. Sulmi seksual shkel të drejtat themelore të viktimës, përfshirë të drejtën për integritet fizik dhe psikologjik dhe sigurinë e personit. *“Akt seksual me kontakt fizik”* përfshin: përdhunimin/marrëdhënien seksuale me penetrim, përpjekjet për të kryer marrëdhënie seksuale me penetrim/tentativë për përdhunim, prekjen/kontaktin seksual. *“Akt seksual pa kontakt fizik”*, përfshin: ngacmimin seksual, ekspozimin e detyruar ndaj akteve seksuale (pornografi apo një akt seksual që po kryhet), ekspozimin apo zbulimin e organeve gjinitale, nxitjen e një fëmije të prekë trupin e tij/saj apo të masturbohet, bërja e një regjistrimi vizual të një natyre seksuale të një fëmije.

Abuzim seksual i fëmijëve cilësohet si “Çdo aktivitet seksual midis një fëmije dhe anëtari të ngushtë të familjes (incesti); ose midis një fëmije dhe një të rrituri; apo një fëmije dhe një fëmije më të rritur, jo anëtar familjeje. Ai përfshin si rastet e përdorimit të forcës ose detyrimit, ashtu edhe rastet kur nuk mund të jepet pëlqimi nga viktima për shkak të moshës së tij ose të saj”.

Shfrytëzim seksual cilësohet si “Çdo abuzim aktual ose përpjekje për abuzim, për qëllime seksuale, nga një pozicion i pafavorshëm, ndryshimi në pushtet, ose besimi, përfshirë por pa u kufizuar tek përfitimi monetar, në mënyrë shoqërore, ose politike, nga shfrytëzimi seksual i tjetrit”.

Koordinatorë/Koordinator i viktimave ose “**Koordinator**” është punonjësi/punonjësi i sektorit të asistencës ndaj subjekteve me status të posaçëm, i ngarkuar me detyrën për t'u ofruar shërbime dhe mundësuar ushtrimin e të drejtave nga ana e viktimave dhe dëshmitarëve të veprave penale.

Përfaqësuese/Përfaqësues ligjor është prindi, i afërmi ose kujdestari i të miturit/miturës, i cili merr pjesë në procedurën e drejtësisë penale për të mitur për të mbrojtur interesat e të miturit/miturës.

“Mekanizmi i Koordinuar i Referimit të rasteve të dhunës në familje” (MKR) është rrjeti i organizuar i institucioneve përgjegjëse në nivel vendor për parandalimin, mbrojtjen, mbështetjen dhe rehabilitimin e viktimave të dhunës në familje.

MKR përbëhet nga:

a) **Komitetet drejtuese** për bashkërendimin e veprimtarisë së institucioneve të autoriteteve përgjegjëse, në nivel vendor, dhe referimin e rasteve të dhunës në familje;

b) **Ekipet teknike ndërdisiplinore**;

c) **Koordinatorët vendorë** për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare.

Komitetet drejtuese kryesohen nga kryetari i bashkisë dhe **në përbërje kanë**: a) Përfaqësuesin e strukturës së policisë; b) Përfaqësuesin e gjykatës së rrethit gjyqësor; c) Përfaqësuesin e prokurorisë së rrethit; ç) Përfaqësuesin e drejtorisë arsimore; d) Përfaqësuesin e Drejtorisë së Shëndetit Publik; dh) Drejtuesin e strukturës për shërbimet sociale, pranë bashkisë; e) Përfaqësuesin e zyrës së përmbarrimit; f) Përfaqësuesin e prefekturës; g) Përfaqësuesin e zyrës përkatëse të punësimit; h) Drejtuesit e organizatave jofitimprurëse që në veprimtarinë e tyre merren me çështje të dhunës në familje; i) Drejtuesit e qendrave/strehëzave të ngritura për viktimat e dhunës në marrëdhëniet familjare në atë njësi të qeverisjes vendore ose në qarkun në juridiksionin e të cilit këto njësi janë; j) Përfaqësues të institucioneve fetare, që mund të ofrojnë shërbime për viktimat e dhunës në marrëdhëniet familjare; k) Drejtuesin e Dhomës së Avokatisë së rrethit.

ETN - Ekipi Teknik Ndërdisiplinor anëtarët e të cilit emërohen nga Komiteti Drejtues dhe janë përfaqësues teknikë të institucioneve anëtare të Komitetit Drejtues si dhe ofrojnë shërbime dhe mbështetje për të mbijetuarat e dhunës në familje në përputhje me mandatin e tyre përkatës. ETN është përgjegjës për a) ndjekjen e rastit dhe plotësimin e nevojave të viktimave, duke siguruar edhe lidhjen e tyre me shërbimet e përshtatshme; b) koordinimin dhe mbikëqyrjen e ofrimit të shërbimeve; c) menaxhimin e rasteve; ç) përcjelljen e të dhënave për rastet konkrete tek drejtuesit të ekipit teknik ndërdisiplinor; d) monitorimin dhe raportimin në komitetin drejtues, për bashkërendimin e veprimtarisë së institucioneve të autoriteteve përgjegjëse, në nivel vendor, dhe referimin e rasteve të dhunës në familje, duke u kujdesur që të ruhet fshehtësia e të dhënave personale të viktimave. Në mënyrën se si e organizon punën ETN, për menaxhimin e rasteve, ndodh shpesh që në momentin e parë të fillimit të punës me një rast të sapodenoncuar, të mblidhen vetëm disa prej anëtarëve të tij, konkretisht: policia, Koordinatorja/Koordinatori Vendor, shëndetësia, mjeku ligjor dhe OSHC që ofron shërbim mbështetës të specializuar strehimi apo ligjor. Këta anëtarë ndërmarrin veprimet e para dhe më pas njoftojnë e angazhojnë anëtarët e tjerë, në varësi të nevojave të rastit. Këta anëtarë përbëjnë atë që quhet **Ekipi Bërthamë i ETN-së**. Ky Ekip është i ngjashëm me Ekipet e Trajtimit të Sulmeve Seksuale në botë (SART) dhe për këtë arsye, deri në ngritjen e ekipeve të tilla të specializuara në Shqipëri, sugjerohet që ETN bërthamë të trajtojë rastet e dhunës seksuale, kuptohet duke u mbështetur dhe me aktivitete të fuqizimit të kapaciteteve të tyre në këtë drejtim.

Grupi Teknik Ndërsektorial (GTN) ka në përbërje përfaqësues të strukturave të policisë, strukturave të shërbimeve sociale, përfaqësues të strukturave arsimore, shëndetësore, të drejtësisë, të organizatave jofitimprurëse, si dhe çdo specialist tjetër që ka njohuri për situatën e fëmijës ose që mund të kontribuojë në marrjen apo zbatimin e masave për mbrojtjen e fëmijës. Në çdo bashki dhe në çdo njësi administrative bashkiake, e cila ka mbi 3000 fëmijë, krijohet ad-hoc, grupi teknik ndërsektorial i trajtimit të rasteve të fëmijës në nevojë për mbrojtje⁵

⁵Ligji 18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”, neni 52

Shërbime të kujdesit shoqëror është një sistem i integruar dhe i organizuar përfitimesh dhe lehtësish, të cilat ofrohen nga profesionistë të fushave përkatëse të subjekteve publike ose jopublike, me qëllim sigurimin e mirëqenies, pavarësisë dhe përfshirjes shoqërore të individëve e të familjeve që kanë nevojë për kujdes shoqëror⁶.

Menaxhim i rastit është sigurimi dhe bashkërendimi i referimit të individëve në nevojë për kujdes shoqëror në të gjithë procesin e ofrimit të shërbimit, sa herë që të jetë e nevojshme, deri në integrimin e plotë të tyre⁷. Ndërsa në literaturën bashkëkohore⁸, gjejmë këtë përkufizim për „menaxhimin e rastit“: një proces bashkëpunues, shumë disiplinuar përmes të cilit vlerësohen, planifikohen, zbatohen, koordinohen, monitorohen dhe rivlerësohen mundësitë dhe shërbimet për të përmbushur nevojat e një individi në nevojë për ndihmë, përmes komunikimit dhe burimeve të disponueshme, duke nxitur cilësinë dhe rezultatet efektive". Katër parimet e menaxhimit të rastit janë: a) Ofrimi i shërbimeve të individualizuara bazuar në zgjedhjet e viktimës së dhunës; b) Vlerësim gjithëpërfshirës që përdoret për të identifikuar nevojat e viktimës së dhunës; c) Zhvillimi me pjesëmarrje i një plani shërbimesh që plotëson nevojat e viktimës së dhunës dhe që hartohet në bashkëpunim me të; d) Koordinimi i mirë i ofrimit të shërbimeve. Menaxhimi i rasteve dhe mbështetja psikosociale ndryshojnë në atë që fokusi kryesor i menaxhimit të rasteve është në spektrin e nevojave të menjëhershme në lidhje me incidentin e dhunës, ndërsa mbështetja psikosociale përqendrohet më gjerë në kujdesin për mirëqenien e përgjithshme të individit. Pavarësisht nga ndryshimet, ekzistojnë lidhje të rëndësishme dhe kur zbatohen programet e përgjigjes, menaxhimi i rasteve dhe mbështetja psikosociale mund të plotësojnë njëra-tjetrën. Për shembull, mbështetja psikosociale mund të sigurohet si pjesë e procesit të menaxhimit të rasteve dhe duke përdorur një qasje të menaxhimit të rasteve, ofruesit e shërbimeve mund të ndihmojnë viktimën të marrë në konsideratë dhe të menaxhojë pasojat psikosociale të dhunës ndaj grave dhe vajzave.

Menaxher rasti është personi që bën të mundur fillimin dhe ndjekjen e menaxhimit të rastit, pra procesit të përshkruar më sipër. Ai/ajo ndihmon në identifikimin e ofruesve të shërbimeve dhe lehtësirave të përshtatshme gjatë gjithë kohës së ofrimit të shërbimeve, ndërsa siguron që burimet e disponueshme të përdoren në kohën e duhur dhe me kosto-efektivitet, në mënyrë që të marrin vlerën optimale si për viktimën e dhunës ashtu edhe për burimin e rimbursimit.

Urdhër i menjëhershëm mbrojtjeje është urdhri i lëshuar përkohësisht me vendim gjykate, i vlefshëm deri në lëshimin e urdhrit të mbrojtjes me vendim gjykate.

Urdhër mbrojtjeje është urdhri i lëshuar me vendim gjykate, ku parashikohen masat mbrojtëse për viktimën.

Urdhri për masat paraprake të mbrojtjes së menjëhershme është urdhri i arsyetuar dhe i lëshuar sipas parashikimeve të ligjit, që përmban masat e menjëhershme për ndalimin e dhunës, që merren nga organet përgjegjëse për trajtimin e rasteve të dhunës në familje pranë Policisë së Shtetit, deri në marrjen e vendimit nga gjykata.”

⁶Ligji 121/2016 “Për shërbimet e përkujdesit shoqëror në RSH”, neni 3

⁷Po aty

⁸<https://www.endvawnow.org/en/articles/1570-case-management.html>

1.3. PARIME TË PËRGJITHSHME DHE ELEMENTËT THELBËSORË

Ky protokoll sigurisht që karakterizohet nga të njëjtat parime të përgjithshme të cilësuar të rëndësishme për t'u ndjekur nga anëtarët e Ekipit Teknik Ndërdisciplinor gjatë punës së tyre, siç cilësohen në Protokollin bazë të menaxhimit të rasteve të dhunës në familje në nivel vendor përmes Mekanizmit të Koordinuar të Referimit (MKR). Megjithatë, për shkak të formës së dhunës së ushtruar në vijim do të paraqiten qasja kryesore, parimet udhëheqëse dhe elementët thelbësorë gjatë punës me viktimat e dhunës seksuale.

Menaxhimi i rasteve të dhunës me bazë gjinore, e sidomos i rasteve të dhunës seksuale, ka një karakteristikë unike që e dallon nga qasjet e tjera që mund të karakterizojnë menaxhimin e rasteve në tërësi dhe kjo është pikërisht **qasja “me në qendër viktimën”**. Një qasje “me viktimën në qendër” ose e thënë ndryshe e përqendruar tek viktima, synon të krijojë një mjedis mbështetës në të cilin respektohen të drejtat e viktimës dhe ku personi trajtohet me dinjitet dhe respekt. Kjo qasje nënkupton që secila/secili person viktimë e dhunës: a) ka të njëjtat të drejta për mbështetje dhe kujdes; b) është i ndryshëm dhe unik; c) do të reagojë ndryshe në varësi të eksperiencës së dhunës së pësuar; d) ka fuqi, kapacitet, burime dhe nevoja të ndryshme; e) ka të drejtën e saj/tij, në varësi të moshës dhe rrethanave që të vendosë se kush do të ketë dijeni për çfarë i ka ndodhur dhe se cilat do të jenë hapat që ndërmerren në vijim; f) duhet të besohet dhe trajtohet me respekt, mirësi dhe empati. Gjatë aplikimit të kësaj qasjeje, personi i dhunuar vendoset në qendër të ndihmës e cila ofrohet në përputhje me karakteristikat, situatën dhe nevojat e tij. Kjo fillon me vlerësimin e eksperiencës nëpër të cilën ka kaluar ky person, por edhe duke mbajtur në konsideratë faktin që është vetë personi më mirë se kushdo tjetër që njeh dhe vlerëson detaje të situatës së tij, ndaj dhe planifikimi i ndihmës bëhet bashkërisht me të. Kjo qasje gjithashtu synon fuqizimin e personit të dhunuar.

Qasja me në qendër viktimën shoqërohet dhe me një sërë parimesh udhëheqëse që mbështesin punën ndihmuese:

- **Parimi i ndjeshmërisë ndaj traumës së viktimës.** Sipas këtij parimi, ofruesit e shërbimeve mbështetëse të specializuara për viktimat e dhunës seksuale njohin dhe pranojnë ndikimin e gjerë dhe të shtrirë në kohë të traumës dhe kuptojnë rrugët e mundshme për rimëkëmbje. Gjithashtu ofruesit e shërbimeve njohin shenjat dhe simptomat e traumës tek klientët, familjet, stafi dhe të gjithë individët e tjerë të përfshirë dhe përgjigjen duke i integruar plotësisht njohuritë rreth traumës në politikat, procedurat dhe praktikën e tyre, duke u përpjekur maksimalisht të shmangin ritraumatizimin. Sipas këtij parimi, theksohet siguria fizike, psikologjike dhe emocionale si për viktimat ashtu edhe për ofruesit e shërbimeve, gjë që lejon viktimat për të rindërtuar një ndjenjë sigurie, kontrolli dhe fuqizimi. Përdorimi i parimit të ndjeshmërisë ndaj traumës së viktimës shmang praktikën dhe proceset institucionale që ka të ngjarë të çojnë në ri-traumatizim të individëve me historitë traumës dhe lejon që shërbimet të ofrohen në atë mënyrë që lehtëson pjesëmarrjen e vetë viktimave. Ky parim i shikon viktimat si ekspertë të nevojave të tyre.
- **E drejta për siguri.** 'Siguria' i referohet si aspektit të sigurisë fizike ashtu dhe ndjenjës së sigurisë psikologjike dhe emocionale për viktimën. Është e rëndësishme të merren parasysh nevojat e sigurisë jo vetëm të viktimës, por dhe të anëtarëve të familjes së saj apo edhe të personave që ofrojnë kujdes dhe mbështetje. Në rastin e dhunës seksuale të lidhur me situatat e konflikteve dhe të motivuar politikisht, apo dhunës seksuale nga partneri intim, rreziqet që çënojnë sigurinë mund të jenë edhe më të mëdha se zakonisht. Po kështu, çdo plan veprimi që diskutohet si zgjidhje e situatës

së viktimave të dhunës seksuale, duhet patjetër të ketë si faktor kryesor sigurinë e tyre. Për shembull, burimet dhe mbështetja e krijuar për viktimat nuk duhet të paraqesin barriera, qoftë edhe të paqëllimshme, dhe nga ana tjetër, nuk duhet të komprometojnë sigurinë e tyre. Planet e sigurisë së viktimave duhet të përgatiten paralelisht me kryerjen e procesit të vlerësimit të riskut. Gjithashtu duhet të ndërmerren edhe masa për të shmangur cënimin e sigurisë së viktimave të dhunës seksuale përmes zbulimit të identitetit apo vendndodhjes së tyre, nga ana e medias.

- **E drejta për konfidencialitet.** Konfidencialiteti i referohet të drejtës së një personi për të trajtuar me respekt çdo lloj informacioni në lidhje me të. Ai promovon sigurinë, besimin dhe fuqizimin. Konfidencialiteti pasqyron besimin se njerëzit kanë të drejtë të zgjedhin se kujt do t'ia tregojnë ose nuk do t'ia tregojnë historinë e tyre. Ruajtja e konfidencialitetit do të thotë të mos zbulosh asnjë informacion në çdo kohë për çdo palë pa marrë më parë pëlqimin e informuar (pra miratimin me shkrim nga ana e viktimës, pasi t'i jetë shpjeguar se çfarë lloj informacioni dotë ndahet, me kë dhe përse është e rëndësishme kjo gjë në lidhje me zgjidhjen e rastit). Mosrespektimi i konfidencialitetit mund ta vendosë viktimën dhe persona të tjerë afër saj në rrezik dëmtimi të mëtejshëm. Nëse personat të cilët ofrojnë ndihmë nuk e respektojnë konfidencialitetin, viktimat do të dekurajohen nga fakti që kërkuan ndihmë. Konfidencialiteti i shërbimeve duhet të ruhet patjetër. Jeta private dhe konfidencialiteti i viktimave duhet të ruhet patjetër ashtu sikurse edhe adresat e shërbimeve të cilat kanë në fokus sigurinë e viktimës (strehëzat e emergjencës dhe strehëzat afatgjata për dhunën në familje, përfshirë dhe adresat e qendrave të shërbimeve mbështetëse të specializuara për viktimat e sulmit seksual, siç është qendra LILIUM). Shumë nga ofruesit e shërbimeve përdorin formularët e dhënies së pëlqimit të informuar me viktimat. Për shkak të asaj se si trauma ndikon në kujtesën dhe funksionin e trurit, shumë viktima të dhunës seksuale kanë vështirësi për të kuptuar ose mbajtur mend informacionin, veçanërisht informacionin kompleks nëse jepet gjatë ditëve të para pas një sulmi. Si rezultat, është e nevojshme që *të gjithë ofruesit e shërbimeve të zhvillojnë modele që praktikojnë dhënien e pëlqimit të informuar vetëm kur një viktimë ka aftësinë të kuptojë plotësisht pasojat e nënshkrimit në një formular të dhënies së pëlqimit të informuar, qoftë ky dhe verbal*. Për më tepër, ofruesit e shërbimeve duhet të krijojnë procedura të sakta të dhënies së informacionit tek të tretët, ku të përcaktohet saktësisht lloji i informacionit që do të ndahet dhe me cilat institucione/aktorë. Kjo sigurisht që duhet të jetë në përputhje me parashikimet ligjore për detyrimin institucional dhe profesional për të raportuar një formë të dhunës, siç është dhuna seksuale (*për më shumë, shiko nenet e cituara në kutinë në vijim dhe si footnote*). Konfidencialiteti - mbrojtja e informacionit identifikues ose detajeve të çështjeve në lidhje me një viktimë të dhunës seksuale - ka qenë një sfidë e vazhdueshme për bashkëpunimet shumë-sektoriale të koordinuara. Për shembull ka raste që informacioni mund të rrjedhë nëpërmjet medias, duke shpalosur detaje të cilat thyejnë konfidencialitetin dhe privatësinë e viktimës dhe familjes së saj. Është thelbësore që anëtarët e ETN-së të kuptojnë kufijtë e shkëmbimit të informacionit rast pas rasti dhe të mësojnë të respektojnë parimin e ruajtjes së konfidencialitetit.

Gjithashtu është e nevojshme të rritet niveli I informacionit të institucioneve anëtare të ETN në lidhje me ligjin Nr.9887, datë 10.3.2008 “PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE”, i ndryshuar. Ky ligj përcakton kuptimin e të dhënave personale, të dhënave sensitive duke konsideruar sitë tilla çdo informacion

për personin fizik, që ka të bëjë me origjinën e tij, racore ose etnike, mendimet politike, anëtarësimin në sindikata, besimin, fetar apo filozofik, dënimin penal, si dhe të dhëna për shëndetin dhe jetën seksuale. “Pëlqim i subjekteve të të dhënave” sipas këtij ligji është çdo deklaratë me shkrim, e dhënë shprehimisht me vullnet të plotë e të lirë dhe duke qenë në dijeni të plotë për arsyen pse të dhënat do të përpunohen, çka nënkupton që subjekti i të dhënave pranon që të përpunohen të dhënat e tij. Ruajtja e konfidencialitetit të të dhënave është një detyrim ligjor i cili duhet të përmbushet edhe pas përfundimit të funksionit nga personat që vihen në dijeni me të dhënat e përpunuara, gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre. Çdo person, të cilit i është shkaktuar një dëm, si rezultat i përpunimit të paligjshëm të të dhënave personale, ka të drejtë të kërkojë kompensim, sipas rregullave të Kodit Civil.

KUJDES!

Çdo person, që pretendon se i janë shkelur të drejtat, liritë dhe interesat e ligjshëm për të dhënat personale, ka të drejtë të ankohet ose të njoftojë komisionerin për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe të kërkojë ndërhyrjen e tij për vënien në vend të së drejtës së shkelur. Pas këtij ankimi, në përputhje me Kodin e Procedurës Civile, subjekti i të dhënave mund të ankohet në gjykatë.

KUJDES!

Ndjekja penale mund të fillojë vetëm me ankimimin e viktimës vetëm për veprat penale të lidhura me dhunën seksuale, neni 102 (Marrëdhënie seksuale me dhunë me të rritura) paragrafi i parë⁹, neni 105 (Marrëdhënie seksuale ose homoseksuale duke shpërdoruar detyrën) dhe neni 106 (Marrëdhënie seksuale ose homoseksuale me persona në gjini ose nën kujdestari)¹⁰.

Ndiqen kryesisht të gjitha veprat e tjera të parashikuara në:

- nenin 100 (Marrëdhënie seksuale ose homoseksuale me të mitur),
- nenin 101 (Marrëdhënie seksuale ose homoseksuale me dhunë me të mitur të moshës 14-18 vjeç),
- nenin 102 (Marrëdhënie seksuale me dhunë me të rritura) paragrafët e tjerë¹¹ (përveç të parit)
- nenin 102/a (Marrëdhëniet homoseksuale me dhunë me të rritur)
- nenin 103 (Marrëdhënie seksuale ose homoseksuale me persona të pazotë për t'u mbrojtur)
- nenin 104 (Marrëdhënie seksuale ose homoseksuale me kërcënim me përdorimin e armës),
- nenin 107/a (Dhuna seksuale),
- nenin 108 (Vepra të turpshme)
- nenin 108/a (Ngacmimi seksual)
- nenin 110/a (Trafikimi i personave të rritur)
- nenin 110/b (Përfitimi apo përdorimi i shërbimeve të ofruar nga personat e trafikuar)
- nenin 114 (Shfrytëzimi i prostitucionit) dhe

⁹Kryerja e marrëdhënieve seksuale me dhunë, me të rritura ose midis bashkëshortëve apo bashkëjetuesve, pa pëlqimin e njërit prej tyre, dënohet me burgim nga tre gjer në dhjetë vjet.

¹⁰Kodi i Procedurës Penale, neni 284, “Ankimi”.

¹¹ Kur marrëdhënia seksuale me dhunë kryhet në bashkëpunim ose më shumë se një herë, ose kur të dëmtuarës i shkaktohen pasoja të rënda për shëndetin, dënohet me burgim nga pesë gjer në pesëmbëdhjetë vjet. Kur vepra ka sjellë si pasojë vdekjen ose vetëvrasjen e të dëmtuarës, dënohet me burgim nga dhjetë gjer në njëzet vjet.

- nenin 130/a (Dhuna në familje)

Bazuar në nenin 281 të Kodit Procedurës Penale “Nëpunësit publikë, të cilët gjatë ushtrimit të detyrës ose për shkak të funksioneve a të shërbimit të tyre, marrin dënim për një veprë penale që ndiqet kryesisht, detyrohen të bëjnë kallëzim me shkrim..”, pra për veprat penale të sipërcituara si vepra penale që ndiqen kryesisht.

“Personeli mjekësor që është i detyruar ligjërisht të bëjë kallëzim duhet ta paraqesë atë brenda dyzet e tetë orëve dhe t’ia dërgojë prokurorit ose çdo oficeri të policisë gjyqësore të vendit ku ka kryer ndërhyrjen ose ka dhënë ndihmën dhe kur ka rrezik nga vonesa, oficerit të policisë gjyqësore më të afërt.”¹²

Po kështu, në bazë të nenit 67 “Detyrimi për raportim” të Ligjit 18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës” rithekskohet detyrimi i çdo punonjësi të institucioneve publike e private për të raportuar rastin e abuzimit të fëmijës në organet përkatëse në Policinë e Shtetit ose strukturat për mbrojtjen e fëmijës në nivel vendor.

Pra kallëzimi apo raportimi i një rasti të dhunës seksuale të ushtruar ndaj një fëmije, si në marrëdhënie familjare ashtu edhe jashtë saj, është detyrim ligjor për të gjitha institucionet anëtare të MKR-së!

- **E drejta për dinjitet dhe për të vendosur vetë.** Dhuna e ushtruar ndaj një personi është një sulm ndaj dinjitetit dhe të drejtave të tij. Të gjithë ofruesit e shërbimeve të cilët kontaktojnë me viktimën luajnë rol në rivendosjen e dinjitetit dhe respektimin e të drejtës së viktimës për të vendosur vetë. Për shembull, viktimat kanë të drejtë të mos bien dakord me shërbimet që u propozohen në kuadër të menaxhimit të rastit, ose zgjedhin nëse duan të përdorin apo jo shërbimet ligjore. Mosrespektimi i dinjitetit, dëshirave dhe të drejtave të viktimave mund të rrisë ndjenjat e tyre të pafuqisë, turpit, vetëfajësimit, duke çuar në zvogëlim të efektivitetit të ndërhyrjeve dhe shkakton riviktimizimin dhe dëmtimin e mëtejshëm. Krijimi i besimit për të folur rreth dhunës seksuale të pësuar tek një viktimë, është tepër i vështirë, sidomos nëse ndeshet edhe me institucione ku politikat e ofrimit të mbrojtjes e trajtimit janë të ndryshme dhe konfuzë. Frika nga paragjykimi dhe mosbesimi i shtyn shumë viktimat të mos flasin hapur dhe të mos e denoncojnë dhunën e pësuar, ose të konfuzohen në mënyrën e paraqitjes së fakteve. Për shumë viktimat të dhunës seksuale, mundësia për të marrë vetë vendime, apo për të qenë aktivisht të përfshira në vendimet që do të merren për trajtimin në vazhdimësi të rastit të tyre, është një pikënisje shumë e mirë dhe e domosdoshme për rikuperimin e traumës së pësuar për shkak të dhunës. Ofruesit e shërbimeve mund të ndiejnë zhgënjim ose konfuzion me vendimet që merr një viktimë në lidhje me procesin e tyre. Sidoqoftë, ky është një komponent thelbësor për ndërtimin e besimit që një viktimë të respektojë zgjedhjet e saj në të gjitha rastet e mundshme. Në rast se një zgjedhje nuk mund të përkrahët, ofruesi i shërbimit duhet të shpjegojë se përse kjo është e pamundur dhe duhet të rishqyrtojë bashkërisht me viktimën mundësitë e tjera për trajtimin e situatës.
- **Mos-diskriminimi.** Të gjithë njerëzit kanë të drejtë të marrin ndihmën më të mirë të mundshme pa diskriminim të padrejtë në bazë të gjinisë, moshës, aftësisë së kufizuar, racës, ngjyrës, gjuhës, besimit fetar ose politik, orientimit seksual ose identitetit gjinor, etj. Përgjigjet duhet të jenë të bazuara në parimin e respektimit të së drejtës.

¹²Kodi i Procedurës Penale, neni 282, “Kallëzim nga personeli mjekësor”

- **Ndëshkimi i dhunuesit.** Dhunuesi duhet të mbajë përgjegjësi për veprimet e tij dhe duhet të ndëshkohet sipas parashikimeve ligjore në fuqi për veprën penale të kryer. Anëtarët e MKR duhet ta vënë theksin te kjo përgjegjësi dhe ndërhyrjet duhen bërë me synimin që dhunuesi të mbajë përgjegjësi të plotë dhe të ndëshkohet sipas legjislacionit në fuqi, duke mposhtur edhe ndikimin e stereotipeve gjinore dhe mentalitetit patriakal që synon fajësimin e viktimës për dhunën seksuale të pësuar.
- **Qëndrueshmëria.** Në vijim të respektimit të parimit të qëndrueshmërisë, përfshirja e detyrës për të menaxhuar edhe rastet e dhunës seksuale siç parashikohen në këtë protokoll, duhet të bëhet pjesë e përshkrimeve të punës së anëtarëve të ETN-së dhe koha e shpenzuar për menaxhimin e rasteve, pjesëmarrjen në mbledhjet përkatëse mujore, apo edhe për çdo aktivitet tjetër në funksion të ETN-së dhe sidomos të trajtimit të kësaj forme dhune e menaxhimit të rasteve specifike, duhet t’u njihet dhe vlerësohet si kohë pune.
- **Zgjerimi i reagimit.** Për shkak të vështirësive me të cilat ndeshet menaxhimi i rasteve dhe në përgjithësi trajtimi i kësaj forme dhune, anëtarët e ETN-së siç udhëzohet edhe në këtë protokoll, do të duhet ta zgjerojnë reagimin e tyre duke përfshirë edhe institucione apo organizata të tjera përgjegjëse, në varësi të specifikave të rastit.

Në tërësinë e hapave që do të hedhin dhe veprimeve që do të ndërmarin anëtarët e ETN-së gjatë trajtimit të rasteve të dhunës seksuale, duhet të mbajnë në konsideratë dhe respektojnë gjithashtu edhe parime të tilla si “Mos lëndo!” dhe “Detyrimi për t’u përgjigjur dhe për të vepruar”, të cilat zbërthehen si në vijim:

- **Parimi i interesit më të lartë:** Interesi më i lartë i viktimës (qoftë e/i rritur apo fëmijë) është konsiderata kryesore në të gjithë vendimet e marra në lidhje me menaxhimin e një rasti të dhunës seksuale.
- **Ndjeshmëria ndaj moshës:** Përgjigjet nga anëtarët e MKR-së duhet të sigurojnë që referimet, shërbimet, proceset dhe strategjitë të jenë të ndjeshme dhe të përshtatura për viktimat e të gjitha moshave.
- **Ndjeshmëria ndaj gjinisë:** Shërbimet, proceset dhe strategjitë për t’iu përgjigjur rasteve të dhunës seksuale duhet të sigurojnë që të adresojnë nevojat specifike të grave dhe vajzave si dhe që të kenë fleksibilitetin për t’iu përgjigjur viktimave burra dhe djem.
- **Aftësisht ndryshe/(pa)aftësitë:** Të gjitha viktimat të cilat kanë aftësi ndryshe apo bëjnë pjesë në grupin e personave me aftësi të kufizuara, kanë të drejtën e të gjithë mbështetjes së nevojshme për të mundur ndihmën e tyre dhe një qasje të barabartë në të gjitha shërbimet përkatëse (mjekësore, ligjore, psikosociale, etj.).
- **Pjesëmarrja/gjithëpërfshirja:** Viktimat duhet të mbështeten për të marrë pjesë në mënyrë aktive dhe kuptimplotë përgjatë gjithë procesit të përgjigjes (përmes drejtësisë, shëndetësisë, arsimit, shërbimeve të përkujdesit shoqëror, etj.) dhe pikëpamjet e tyre duhet të konsiderohen në përputhje me moshën dhe pjekurinë e tyre. Të gjithë anëtarët e MKR-së janë përgjegjës për të siguruar që viktimat dhe kur është

e nevojshme familjet e tyre, janë të mirë-informuar dhe kanë të gjithë informacionin përkatës të nevojshëm për të marrë një vendim bazuar mbi dhënien e pëlqimit të informuar, në lidhje me shërbimet mbështetëse të specializuara të përfshira në menaxhimin e rastit.

- **Individualiteti:** Ndërsa pranohet që shumë viktimat të dhunës me bazë gjinore ndajnë përvoja dhe rrethana të përbashkëta, kur flitet për këtë formë të dhunës, siç është dhuna seksuale, duhet të pranojmë secila viktima do të reagojë ndryshe, edhe pse mund të jetë në rrethana të ngjashme të eksperiencës së dhunës së pësuar. Këtu ndikojnë shumë edhe nevojat individuale të viktimave, të cilat duhet të merren parasysh dhe të mbështeten e adresohen në mënyrën e duhur.
- **Shërbime cilësore e të qendrueshme:** Mbështetja dhe shërbimet e ofruara duhet të jenë cilësore dhe të kenë qendrueshmëri financiare, infrastrukturore, me burimet e duhura njerëzore, etj. Të gjitha shërbimet që u ofrohen viktimave të dhunës seksuale duhet të rregullohen nga standardet e miratuara nga shteti shqiptar, të cilat duhet të jenë të harmonizuara edhe me standardet ndërkombëtare të shërbimeve. Shërbimet duhet të jenë të plota, gjithëpërfshirëse, të disponueshme, të aksesueshme e falas për të gjitha grupet e viktimave të dhunës seksuale, në përputhje me nevojat e veçanta të tyre, të vendosura në qendër të përgjigjes shumë-sektoriale të koordinuar. Të gjithë ofruesit e shërbimeve janë përgjegjës për respektimin e standardeve të miratuara për ofrimin e shërbimeve nga ana e tyre. Ndërkohë që vetë MKR është përgjegjës dhe duhet të sigurohet që në asnjë rast, shërbimet dhe menaxhimi i rastit nuk ofrohen pa qenë të plotësuara standardet minimale të kujdesit për viktimat e dhunës seksuale. Për këtë qëllim, MKR duhet që në takimet mujore të bëjë dhe vlerësimin e këtyre standardeve minimale dhe nëse vërehen boshllëqe, të kërkojë përmes Komitetit Drejtues dhe Kryetares/Kryetarit të bashkisë që të bëjë adresimin e këtyre boshllëqeve deri në plotësimin e tyre.

Gjithashtu, meqenëse dhuna seksuale është një formë dhune më pak e eksploruar dhe e diskutuar në publik apo edhe ndërmjet profesionisteve/profesionistëve, në këtë Protokoll është i domosdoshëm edhe cilësimi i disa **elementëve thelbësorë** të përgjigjes shumë-sektoriale të koordinuar:

- **Akses i barabartë në shërbime.** Aksesin në shërbime pas dhunës seksuale të pësuar është çështja më e ngutshme me të cilën përballen shumë viktimat, shërbime këto që shpesh janë të kufizuara apo mungojnë, për shkak të pamundësisë së institucioneve përgjegjëse për të planifikuar dhe alokuar burimet e nevojshme për ngritjen, menaxhimin dhe qendrueshmërinë e tyre. Përgjigja ndaj dhunës seksuale duke përdorur një qasje të vetme për të gjitha viktimat e kësaj forme dhune, është e dëmshme dhe nuk jep rezultatet e duhura. Krijimi i një aksesin të barabartë në shërbime, nënkupton ngritjen e shërbimeve të tilla të përshtatura për t'iu përgjigjur nevojave të të gjithë individëve duke marrë në konsideratë moshën, gjininë, etninë, (pa)aftësinë, identitetin gjinor e orientimin seksual, si dhe një tërësi karakteristikash individuale të viktimave. Kjo nënkupton që shërbimet duhet të jenë lehtësisht të aksesueshme, të përshtatura, të ofruara në disa gjuhë (përfshirë dhe gjuhën e shenjave apo alfabetin Braille, gjuhën Romisht, etj), nga një tërësi profesionistësh e profesionistësh të specializuar, etj.

- **Njohja e konteksteve të dhunës seksuale.** Në zhvillimin e një përgjigjeje kuptimplote ndaj dhunës seksuale, është thelbësore që profesionistët dhe profesionistët të jenë të mirë-trajnuar mbi kontekstet e dhunës seksuale. Sigurimi i shërbimeve për viktimat e dhunës seksuale kërkon së pari të njohësh dhe të dish të adresosh nevojën për të qenë në gjendje t'u përshtatesh dinamikave të ndryshme dhe ndonjëherë komplekse midis një viktime dhe dhunuesit. Disa nga kontekstet e dhunës seksuale për të cilat profesionistët dhe profesionistët duhet të kenë njohuri bazë si dhe një njohje të mirë të politikave e praktikave në trajtimin e tyre, janë por nuk kufizohen në:
 - Sulmet seksuale të nxitura nga përdorimi i alkoolit ose substancave narkotike
 - Sulmet seksuale gjatë takimeve apo njohjeve për periudha të shkurtëra kohore
 - Sulmet seksuale mes kolegëve/kolegeve, bashkëpunëtorëve / bashkëpunëtoreve
 - Sulmet seksuale ndaj personave të cilët trafikohen për qëllime të shfrytëzimit seksual
 - Sulmet seksuale ndërmjet personave të së njëjtës gjini
 - Sulmet seksuale në marrëdhëniet familjare, etj.

Veç sa më sipër ekzistojnë dhe një tërësi kontekstesh në të cilat mund të vendoset viktima dhe dhunuesi, ndaj dhe është shumë e rëndësishme që profesionistët dhe profesionistët të jenë të mirë informuar dhe të përgatitur profesionalisht me trajnime dhe aktivitete të tjera të fuqizimit të kapaciteteve, me qëllim që të menaxhojnë sa më mirë e me sa më shumë efektivitet të gjitha rastet që u paraqiten.
- **Përfshirja në përgjigjen e koordinuar të organizatave me bazë komunitare, të cilat kanë në fokus të punës së tyre edhe trajtimin e rasteve të dhunës seksuale.** Kjo nënkupton që MKR-të të jenë vigjilente dhe herë pas here të rinovojnë marrëveshjet e bashkëpunimit ku mund të shtojnë si anëtare edhe organizatat që kanë këtë qëllim si pjesë të punës së tyre dhe që janë të lokalizuara në njësinë administrative ku vepron MKR-ja. Gjithashtu, në pamundësi të pasjes pranë të organizatave të tilla, Koordinatorët/Koordinatorët Vendorë kundër dhunës në familje duhet të përditësojnë vazhdimisht listën e ofruesve të shërbimeve mbështetëse për viktimat e dhunës seksuale dhe t'ua venë atë në dispozicion anëtarëve të ETN-së.
- **Ndërtimi i një sistemi bashkëpunues referimi të rasteve të dhunës seksuale.** Referimi është një nga elementët thelbësorë mbi të cilin funksionon vetë Mekanizmi i Koordinuar i Referimit, siç reflektohet që në emërtimin e tij. Por ky referim duhet të jetë një proces i ndërtuar mbi baza shumë të forta bashkëpunimi dhe i përbërë nga një tërësi veprimesh, të cilat nuk mundet të kufizohen thjesht në “përcjelljen e rastit nga një institucion tek tjetri”. Nëse referimi kryhet në mënyrën e duhur dhe shoqërohet me dokumentacionin përkatës, e monitorohet deri në dhënien e rezultateve të dëshiruara, atëherë viktima ka mundësi të përfitojë një tërësi shërbimesh shumë më komplekse e profesionale.
- **Dhënie e informacionit të vazhdueshëm dhe ndjekja e rastit në vazhdimësi.** Pavarësisht nga rezultatet e proceseve ose procedurave, ofruesit e shërbimeve duhet të vijojnë të ofrojnë kujdes dhe mbështetje më të mirë për viktimat, duke siguruar ndjekjen e rastit, dhënien e informacionit, shpjegimet e statusit të çështjes - edhe nëse nuk ka pasur ndonjë zhvillim të qenësishëm kur flitet për ndjekjen ligjore të rastit,

adresimin e nevojave afatmesme e afatgjata të identifikuar, të lidhura me shëndetin, edukimin, punësimin, strehimin afatgjatë, e të tjera. Një nga aspektet më të rëndësishme të ndjekjes së vazhdueshme dhe dhënies së informacionit që çon në rezultate pozitive është pikërisht sigurimi i një informacioni të qartë e të përmbledhur, sidomos në lidhje me trajtimin ligjor të rastit. Shumë viktime shprehen se nuk e dinë se çfarë po ndodh me statusin e çështjeve ligjore të tyre (nëse është nën hetim, nëse është përcjellë informacioni mjeko-ligjor, nëse do fillojë procesi i gjykimit...etj.). Kjo ndikon shumë në frikën dhe pasigurinë e tyre dhe nga ana tjetër deri diku edhe në vijimin e trajtimit të nevojave afatmesme e afatgjata, pasi në varësi të statusit ligjor të çështjes së tyre viktimat mund të duhet të kufizojnë edhe lëvizjet e tyre. Kontributi i ofruesve të shërbimeve me dhënien e informacionit të duhur përmes ndjekjes së rastit në vazhdimësi, rrit gjasat që viktimat të krijojnë një besim më të madh tek institucionet të cilat sigurojnë mbrojtjen e tyre dhe ndëshkimin e dhunuesit. Po kështu, ofruesit e shërbimeve duhet të vijojnë ndjekjen në vazhdimësi të adresimit të nevojave të tjera të rastit, siç janë identifikuar dhe planifikuar për t'u adresuar në bashkëpunim me viktimën dhe anëtarë të tjerë të MKR-së.

1.4. KUADRI LIGJOR DHE TË DREJTAT E VIKTIMAVE TË DHUNËS SEKSUALE

Të drejtat e viktimave të dhunës seksuale mbështeten në një bazë ligjore të konsoliduar që përbëhet nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, instrumenta ndërkombëtarë të ratifikuar, Kode, ligje dhe aktet e tyre nënligjore, ndër të cilat më të rëndësishmet renditen në vijim:

1. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
2. Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut, 1948;
3. Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike, aderuar në 4 Tetor 1991.
4. Konventa Ndërkombëtare mbi të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore, aderuar në 4 Tetor 1991.
5. Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut¹³ dhe protokollat shtesë të saj;
6. Konventa e Këshillit të Evropës për parandalimin dhe luftimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje (Konventa e Stambollit)¹⁴;
7. Konventa e Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Fëmijëve nga Shfrytëzimi dhe Abuzimi Seksual, Lanzarote, 25.10.2007¹⁵;
8. Konventa e OKB-së për të Drejtat e Fëmijëve, Nju Jork, 20.11.1989¹⁶;
9. Konventa e Këshillit të Evropës për Kompensimin e Viktimave të Krimeve të Dhunshme, Strasburg, 24.11.1983¹⁷;
10. Konventa “Për Eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj gruas”, ratifikuar me ligjin nr.7767, datë 9.11.1993 dhe Protokollit shtesë i Konventës “Për Eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj gruas”
11. Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër Torturës dhe Trajtimit Mizor, Çnjerëzor ose Poshtëruar dhe ndëshkimit (CAT), hyrë në fuqi më 11 Maj 1994;
12. Konventa Evropiane “Për parandalimin e torturës dhe të trajtimeve çnjerëzore apo poshtëruese”, nënshkruar në 2 Tetor 1996;
13. Konventa e Këshillit të Evropës mbi kompensimin e viktimave të krimeve të dhunshme, ratifikuar me ligjin nr.9265, datë 29.07.2004.

¹³ Romë, 4.11.1950

¹⁴ Ratifikuar me ligjin nr. 104/2012

¹⁵ Ratifikuar me ligjin nr. 10 071, datë 9.2.2009

¹⁶ Ratifikuar me ligjin nr. 7531 date 11.12.1991.

¹⁷ Ratifikuar me ligjin nr. 9265, date 29.7.2004.

14. Rekomandimi i Përgjithshëm i Komiteti CEDAW, nr.35-sesioni i 67-të mbi dhunën me bazë gjinore kundër grave, i cili përditëson rekomandimin e përgjithshëm nr.19;
15. Direktiva e Këshillit të BE-së, “Për kompensimin e viktimave të krimit”;
16. Ligji nr. 7850, datë 29.7.1994, “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”
17. Ligji nr. 35/2017, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7905, datë 21.3.1995, “Kodi i procedurës penale i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar;
18. LIGJ Nr. 7895, datë 27.1.1995 “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, ndryshuar deri në prill 2020
19. Ligji nr. 37/2017, “Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur”;
20. Ligji nr. 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”;
21. Ligji nr. 9669, datë 18.12.2006, “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare” (i ndryshuar, maj 2018, tetor 2020);
22. Ligji nr. 18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”;
23. Ligji nr. 97/2016, “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”;
24. Ligji nr. 10 221, datë 4.2.2010, “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, i ndryshuar tetor 2020;
25. Ligji nr. 111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”;
26. Ligji nr. 9887, datë 10.3.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar. (me Ligjin Nr. 48/2012, F.Z. 53 dhe ndryshuar me LigjinNr.120/2014, F.Z 160);
27. Ligji nr. 22/2018 “Për strehimin social”;
28. Ligji nr. 8503, datë 30.06.1999, “Për të drejtën e informimit”;
29. Ligji nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit,” i ndryshuar

Dhe aktet e tyre nënligjore, nga të cilat veçojmë:

- 30.Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 334, datë 17.2.2011 “Për mekanizmin e bashkërendimit të punës për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare dhe mënyrën e procedimit të tij”;
- 31.Udhëzim i përbashkët nr. 866, datë 20.12.2018, Për procedurat dhe modelin e vlerësimit të riskut për rastet e dhunës në familje;
- 32.Udhëzim i përbashkët, nr. 912, datë 27.12.2018, “Për procedurat dhe modelin e urdhrit për masat paraprake të mbrojtjes së menjëhershme”;
- 33.Udhëzim nr. 816, datë 27.11.2018, Për miratimin e standardeve të ofrimit të shërbimeve dhe të funksionimit të qendrave të menaxhimit të krizës, për rastet e dhunës seksuale
- 34.Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 839, datë 3.12.2014, Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 425, datë 27.6.2012, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kritereve dhe të dokumentacionit të nevojshëm për pranimin e personave në institucionet rezidenciale, publike dhe jopublike, të përkujdesjes shoqërore”.
- 35.Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.505, datë 13.07.2011 për “Standartet e Shërbimeve të Përkujdesit Shoqëror për Viktimat e Dhunës në Familje”, në qendrat rezidenciale publike dhe jo publike;
36. Udhëzim i Përgjithshëm i Prokurorit të Përgjithshëm, nr.05, datë 26.10.2018, për“Garantimin e asistencës ndaj viktimave dhe dëshmitarëve të veprave penale”.

Seksioni VI i Kodit Penal përfshin krimet seksuale, disa nga të cilat mund të ndodhin në marrëdhënie familjare ose të tjera si: “Marrëdhënie seksuale ose homoseksuale me të mitur”-neni 100, “Marrëdhënie seksuale ose homoseksuale me dhunë me të mitur të moshës 14-18 vjeç”-neni 101, Marrëdhënie seksuale me dhunë me të rritura-neni 102, Marrëdhënie homoseksuale me dhunë me të rritur-neni 102/a, Marrëdhënie seksuale ose homoseksuale me persona të pazotë për t’u mbrojtur-Neni 103, Marrëdhënie seksuale ose homoseksuale me kërcënim me përdorimin e armës, Marrëdhënie seksuale ose homoseksuale me persona në

gjini ose nën kujdestari- Neni 104, Marrëdhënie seksuale ose homoseksuale duke shpërdoruar detyrën-neni 105, Dhuna seksuale-neni 107/a, Vepra të turpshme-Neni 108 dhe Ngacmimi seksual-neni 108/a.

Gratë dhe vajzat por jo vetëm mund të përballen me krime seksuale. Legjislacioni procedural penal por edhe ai administrative civil parashikojnë një set të drejtash që duhet të garantohen për viktimat e dhunës seksuale.

LEGJISLACIONI PROCEDURAL PENAL

Respektimi i të drejtave të viktimave të veprave penale është një ndër parimet e përgjithshme të Kodit të Procedurës Penale¹⁸.

Neni 58 i Kodit të Procedurës Penale parashikon **Të drejtat e viktimës së veprës penale** (Shtuar pika 3 me ligjin nr.8813, datë 13.6.2002 dhe ndryshuar me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017)

1. Viktima e veprës penale ka të drejtë:

- a) të kërkojë ndjekjen penale të fajtorit;
- b) të përfitojë kujdes mjekësor, ndihmë psikologjike, këshillim dhe shërbime të tjera të ofruara nga autoritetet, organizatat ose institucionet përgjegjëse për ndihmën ndaj viktimave të veprës penale;
- c) të komunikojë në gjuhën e saj dhe të ndihmohet nga një përkthyes, interpretues i gjuhës së shenjave ose lehtësues i komunikimit për personat me aftësi të kufizuara në të folur dhe në të dëgjuar;
- ç) të zgjedhë mbrojtës dhe, kur është rasti, të përfitojë ndihmë juridike falas, sipas legjislacionit në fuqi;
- d) të kërkojë në çdo kohë informacion për gjendjen e procedimit, si dhe të njihet me aktet e provat, pa cenuar parimin e sekretit hetimor;
- dh) të kërkojë marrjen e provave, si dhe të parashtojë kërkesa të tjera përpara organit procedues;
- e) të informohet për arrestimin e të akuzuarit dhe lirin e tij, në kushtet e caktuara në këtë Kod;
- ë) të njoftohet për mosfillimin e procedimit, pushimin e çështjes, fillimin dhe përfundimin e gjykimit;
- f) të bëjë ankim në gjykatë kundër vendimit të prokurorit për të mos filluar procedimin dhe vendimit të prokurorit ose gjyqtarit të seancës paraprake për të pushuar akuzën ose çështjen;
- g) të kërkojë shpërblimin e dëmit dhe të pranohet si paditës civil në procesin penal;
- gj) të përjashtohet, në kushte të caktuara me ligj, nga pagimi i çdo shpenzimi për marrjen e akteve dhe tarife gjyqësore për paraqitjen e kërkesë-padisë që lidhen me statusin e viktimës së veprës penale;
- h) të thirret në seancën paraprake dhe në seancën e parë gjyqësore;
- i) të dëgjohet nga gjykata, edhe kur asnjëra nga palët nuk ka kërkuar thirrjen e saj si dëshmitar;
- j) të ushtrojë të drejta të tjera të parashikuara nga ky Kod.

2. Organi procedues njofton menjëherë viktimën për të drejtat e përmendura në paragrafin 1, të këtij neni, dhe mban procesverbal për njoftimin e tyre.

3. Viktima që nuk ka zotësi për të vepruar i ushtron të drejtat e saj nëpërmjet përfaqësuesit ligjor ose kujdestarit të tij, përveçse kur kjo nuk është në interesin e viktimës.

¹⁸ Neni 9/a i KPP-së.

Kur vëren papajtueshmëri mes interesave të viktimës dhe atyre të përfaqësuesit ligjor ose kujdestarit, gjykata cakton një kujdestar të posaçëm, në përputhje me dispozitat e Kodit të Familjes.

Neni 58/a përcakton Të drejtat e viktimës së mitur (Shtuar me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017)

Përveç të drejtave të parashikuara në nenin 58 dhe parashikimeve të tjera të këtij Kodi, si dhe legjislacionin e posaçëm për të miturit, viktima e mitur ka të drejtë:

- a) të shoqërohet nga një person i besuar prej tij;
- b) të ruajtjes së konfidencialitetit të të dhënave personale;
- c) të kërkojë, nëpërmjet përfaqësuesit ligjor ose kujdestarit, që gjykimi të zhvillohet pa praninë e publikut.

2. Organi procedues duhet të trajtojë viktimën e mitur të veprës penale duke mbajtur parasysh moshën, personalitetin dhe rrethana të tjera, me qëllim shmangien e pasojave të dëmshme për zhvillimin dhe edukimin e saj të ardhshëm.

3. Nëse ekziston mundësia që viktima është e mitur dhe moshë e viktimës nuk dihet, prezumohet se ajo është e mitur.

4. Viktima e mitur pyetet pa vonesë nga persona të specializuar për këtë qëllim. Kur është e mundur dhe e përshtatshme, biseda regjistrohet me mjete audiovizive, sipas parashikimeve të këtij Kodi. Ky regjistrim mund të përdoret si provë në procedimin penal dhe vlerësohet së bashku me provat e tjera, sipas kritereve që parashikohen nga paragrafi 4, i nenit 361/a, të këtij Kodi. Kur viktima e mitur është nën 14 vjeç, biseda zhvillohet në mjedise të përshtatura për të.

Viktima e abuzuar seksualisht përveç të drejtave të parashikuara në nenin 58 dhe 58/a të Kodit të Procedurës Penale gëzon edhe të drejtat e parashikuara në nenin 58/b të Kodit të Procedurës Penale.

Neni 58/b ka parashikuar **Të drejtat e viktimës së abuzuar seksualisht dhe viktimës së trafikimit të qenieve njerëzore (Shtuar me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017)**

viktima e abuzuar seksualisht ka gjithashtu të drejtë:

- a) të pyetet pa vonesë nga një oficer i policisë gjyqësore ose prokuror i të njëjtës gjini;
- b) të refuzojnë t'u përgjigjen pyetjeve në lidhje me jetën private, e cila qartësisht nuk ka lidhje me veprën penale;
- c) të kërkojnë të dëgjohen nëpërmjet mjeteve audiovizive, sipas parashikimeve të këtij Kodi.

Edhe legjislacioni administrativ e civil ka përcaktuar një tërësi të drejtash për viktimat e dhunës seksuale për të cilat viktima informohet nga policia dhe/ose KVDHF, apo anëtarë të tjerë të MKR, ku raportohet dhuna.

Kujdes!

Subjektet që mbrohen nga dhuna në familje në të gjitha format e saj janë të gjitha subjektet e përcaktuara në ligj në pjestarët e familjes, që janë shtetas shqiptarë me vendbanim ose vendqëndrim në territorin e Republikës së Shqipërisë. Mbrojtje gëzojnë edhe shtetasit e huaj ose personat pa shtetësi që kanë kërkuar mbrojtje ndërkombëtare, sipas legjislacionit në fuqi për azilin në Republikën e Shqipërisë, dhe të huajt me qëndrim të rregullt për motive të ndryshme, sipas legjislacionit në fuqi për të huajt.

II. MENAXHIMI I RASTEVE TË DHUNËS SEKSUALE NË NIVEL VENDOR PËRMES QASJES SHUMË-SEKTORIALE TË KOORDINUAR

2.1. RËNDËSIA E MENAXHIMIT TË RASTEVE TË DHUNËS SEKSUALE PËRMES QASJES SHUMË-SEKTORIALE TË KOORDINUAR.

Dhuna seksuale është një formë veçanërisht e urryer e dhunës, që përfshin përdhunimin si dhe çfarëdo sulmi tjetër të natyrës seksuale të kryer kundër grave dhe vajzave, burrave dhe djemve. Pasoja të saj mund të jenë brutale, dhe përfshijnë pasoja fizike, psikologjike, shëndetësore e të shëndetit mendor si të menjëhershme, ashtu dhe në terma të rikuperimit afatgjatë.

Është e rëndësishme të pranohet se gratë, burrat, vajzat dhe djemtë që të gjithë mund të jenë viktimat e dhunës seksuale. Megjithatë, pabarazitë historike dhe strukturore që ekzistojnë mes burrave dhe grave, si dhe format e ndryshme të diskriminimit me bazë gjinore që i mbajnë gratë të nënshtruara në mbarë botën, kontribuojnë që gratë dhe vajzat të ndikohen në mënyrë disproporcionale nga dhuna seksuale. Për më tej, përhapja e dhunës seksuale ndaj fëmijëve në veçanti është e lartë, dhe shoqërohet me pasoja e dëmtime afatgjata shëndetësore, psikologjike e sociale.

Kuptimi i ndikimit të shkakuar nga dhuna seksuale është çelësi si për referimin e viktimave tek shërbimet e duhura, ashtu edhe për dokumentimin e saktë të dëmit që dhuna seksuale u shkakton individëve, familjeve dhe komuniteteve të tyre. Dhuna seksuale mund të ketë pasoja fizike dhe psikologjike afat-gjata dhe të rrezikshme për jetën, si dhe pasoja sociale, ekonomike dhe ligjore që rezultojnë në rritjen e rrezikut dhe cenueshmërisë për viktimat.

Gratë, burrat, vajzat dhe djemtë mund të preken në mënyra të ndryshme nga dhuna seksuale. Reagimi ndaj dhunës seksuale kërkon një qasje të fuqishme shumë-sektoriale që përfshin ofrimin e bashkërenduar të të paktën shërbimeve shëndetësore, mbrojtjes, mbështetjes psiko-sociale dhe qasjes në drejtësi për viktimat. Vënia në funksion dhe efikasiteti të plotë e këtyre shërbimeve është një ndër faktorët kryesorë që ndikon në rritjen e besimit të viktimave për të denoncuar dhunën seksuale të ushtruar ndaj tyre. Megjithatë, edhe kur shërbimet mbështetëse ekzistojnë dhe janë në numër të mjaftueshëm, viktimat e dhunës seksuale e kanë tepër të vështirë të kërkojnë të kenë akses dhe mbështetje në këto shërbime, për një sërë arsyesh. Disa viktimat nuk i qasen drejtësisë për shkak të stigmës, turpësorisë, poshtërimit dhe traumës së përjetuar. Të tjerët kanë frikë nga izolimi prej anëtarëve të tjerë të familjes dhe komunitetit të tyre, kanë frikë nga dhuna që mund të pësojnë sërish dhe nuk besojnë tek institucionet e drejtësisë dhe policimit. Frika nga paragjykimi dhe fajësimi që u bëhet pikërisht viktimave për dhunën seksuale të pësuar, është një tjetër aspekt që ndikon në pasjen e një numri denoncimesh shumë më të ulët sesa numri i rasteve të dhunës seksuale të ndodhura në të vërtetë. Akoma më e vështirë bëhet situata kur flitet për dhunë seksuale ndaj personave LGBTI+, niveli i paragjykit tek të cilët është edhe më i lartë. Po kështu, përdhunimi martesor ende nuk arrihet të perceptohet tej kornizës së “përmbushjes së detyrimeve bashkëshortore” për një pjesë të grave e të rejave, të cilat as e mendojnë denoncimin e këtij akti si formë të dhunës nga partneri intim, të ushtruar ndaj tyre në familje. Të gjithë profesionistët dhe profesionistët duhet të përpiqen bashkërisht që të mundësojnë një mjedis të sigurt dhe mbështetës, ku viktimat dhe dëshmitarët e dhunës seksuale të ndjehen të sigurt dhe të kenë besim për t'u paraqitur dhe për të denoncuar dhunën e ushtruar ndaj tyre.

Menaxhimi i rasteve përmes qasjes shumë-sektoriale të koordinuar është domosdoshmëri. Kjo pasi një qasje gjithëpërfshirëse dhe e koordinuar analizon dhe adreson shkaqet,

manifestimet dhe pasojat e dhunës së ushtruar. Përdorimi i qasjes gjithëpërfshirëse dhe të koordinuar ndaj dhunës ndaj grave është edhe një nga kërkesat kryesore të Konventës së Stambollit, që buron nga parimi i kujdesit të duhur, i cili përcakton detyrimin pozitiv për shtetet për t'iu përgjigjur në mënyrë efektive të gjitha akteve të dhunës (neni 5). Konventa e Stambollit i organizon masat dhe politikat rreth tre shtyllave kryesore: a) parandalimi i akteve të dhunës ndaj grave, b) mbrojtja ndaj akteve të tilla dhe c) ndjekja penale/ndëshkimi i dhunuesve. Duke qenë se këto shtylla janë të ndërthurura duhet të vendoset një sistem ndërhyrjeje i integruar dhe mirë-funksional duke marrë parasysh se si secila prej tyre kontribuon në strukturën e përgjithshme. Prandaj Konventa kërkon shprehimisht të miratohen politika gjithëpërfshirëse dhe të bashkërenduara, të cilat të zbatohen duke mundësuar një përgjigje të plotë për të gjitha format e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje, të tilla si: dhuna në familje, dhuna psikologjike, seksuale, ngacmimi seksual, përndjekja, martesë e detyruar, aborti dhe sterilizimi i detyruar apo gjymtimi i organeve gjentile femërore (neni 7, paragrafi 1).

Një përgjigje gjithëpërfshirëse e koordinuar, nënkupton gjithashtu shikimin e "figurës së plotë" dhe krijimin e një sistemi mirë-funksional të ndërhyrjes që lejon viktimat të kenë qasje në mbrojtje dhe mbështetje, pa marrë parasysh se ku banojnë. Një element tjetër kryesor karakterizues i qasjes shumë-sektoriale të koordinuar ka të bëjë me sigurimin e pjesëmarrjes të të gjithë institucioneve dhe profesionistëve në parandalimin, trajtimin dhe riintegrimin e rasteve. Kjo pasi, për shkak të kompleksitetit të kësaj forme të dhunës, asnjë institucion, agjensi, organizatë ofruese shërbimesh apo profesioniste/profesionist i vetëm nuk mundet ta trajtojë viktimën bazuar në të gjitha parimet e sipërcituara, si dhe të mund të adresojë të gjitha nevojat e saj emergjente, afatmesme apo afatgjata. Për më tepër rezultatet pozitive në trajtimin e rasteve rriten nëse ka bashkëpunim dhe koordinim veprimesh, masash, e burimesh.

Dhuna seksuale është një problem shumëplanësh i ndikuar nga ndërveprimi i personave, situatës, si dhe nga faktorët socio-kulturorë. Normat thelbësore kulturore, sociale dhe gjinore të një komuniteti shpesh e bëjnë të vështirë për një viktimë marrjen e mbështetjes apo dëmshpërblimit për dhunën e pësuar. Për të adresuar dhunën seksuale dhe për të siguruar mbështetjen e duhur për viktimat, konteksti socio-kulturor në të cilin kryhen krime të tilla duhet të merren parasysh, së bashku me efektin e thellë që dhuna seksuale ka mbi individin dhe komunitetin në tërësi. Në të vërtetë, shëndeti dhe mirëqenia e një individi nuk mund të mendohen të ndara nga konteksti i komunitetit në të cilin ai jeton. Prandaj dhe është e rëndësishme të pranohet rëndësia e marrëdhënieve midis individëve dhe grupeve brenda një komuniteti, si dhe të gjenden mënyra për të përfshirë vetë viktimat dhe perspektivën e komunitetit në orientimin drejt zgjidhjeve të situatave. Parandalimi dhe përgjigja ndaj dhunës seksuale kërkon zbatimin e qasjes shumë-sektoriale të koordinuar, një përpjekje gjithëpërfshirëse kjo për trajtimin e plotë të rastit, si rjedhojë e të cilës viktimat marrin mbështetje dhe autorët e krimit sillen para drejtësisë e marrin ndëshikimin e duhur, si rezultati aktiviteteve të koordinuara nga shumë sektorë. Kjo qasje përfshin zhvillimin e një kuptimi të përbashkët të dhunës seksuale dhe legjislacionit në fuqi, identifikimin e roleve e përgjegjësisë të secilit partner në proces, si dhe të punuarit me procedura e protokolle të përbashkëta, siç është dhe rasti i këtij protokollit.

Dhuna seksuale ka pasojat serioze afatgjata tek gratë mbi shëndetin fizik, seksual dhe riprodhues, si dhe shëndetin mendor të tyre. Ajo është një përvojë thellësisht e dhimbshme. Në varësi të formës së dhunës seksuale të përjetuar, gratë dhe vajzat adoleshente viktimat të dhunës kanë nevojë për mbështetje që adreson kërcënimet për jetën, pasojat shëndetësore, si

dhe për një sërë veprimesh të tjera për t'i ndihmuar ato të mund të rehabilitohen e riintegrohen.

E rëndësishme për anëtarët e MKR-së

Viktimat e dhunës seksuale përballen me shumë pengesa për të pasur akses në kujdesin dhe mbështetjen në dispozicion të tyre. Së pari nuk duhet harruar se viktimat mund të mos i tregojnë askujt çfarë ndodhi sepse:

- Ndihen në turp dhe siklet
- Fajësojnë veten ose kanë frikë nga se të tjerët do i fajësojnë ato për çfarë u ndodhi
- Mund të duan të mbrojnë autorin e krimit (e diktuar kjo nga rrethana të caktuara)
- Mund të mendojnë se çfarë u ka ndodhur është normale (e diktuar kjo nga mungesa e informacionit)
- Frikësohen nga dëmtimi i mëtejshëm që mund t'u bëjnë dhunuesit apo familjet e tyre
- Mendojnë se ekziston mundësia që reagimi nga familja, komuniteti dhe autoritetet të jetë aq negativ sa ato mund të fajësohen, stigmatizohen, dëbohen, apo ndëshkohen rëndë
- Kanë frikë se nuk do të besohen ose nuk do të trajtohen mirë
- U mungojnë provat për ngjarjen e ndodhur
- Nuk mendojnë se ajo që ka ndodhur është një krim dhe duhet denoncuar në polici
- Nuk dinë ku të denoncojnë
- Dyshojnë se sistemi i drejtësisë nuk do të arrijë ta zgjidhë situatën e tyre.

Këto janë disa prej shkaqeve që i pengojnë viktimat e dhunës seksuale të denoncojnë dhunën që në momentin që e përjetojnë atë. Prandaj dhe disave prej tyre mund t'u duhen vite të binden e të ndërmarrin hapin e denoncimit të rastit edhe nëse dhuna seksuale e përjetuar nuk është e përsëritur (për shembull është një ngjarje e ndodhur në fëmijëri apo adoleshencë, për të cilën personi nuk ka arritur të flasë për shumë vite, derisa krijon besimin e duhur dhe sfidon shumë prej shkaqeve të mësipërme). Në praktikën e punës suaj si antarë të MKR ju do të ndesheni edhe me raste të tilla të dhunës seksuale.

Pavarësisht kohës se kur ka ndodhur ngjarja, pra nëse është një ngjarje e ndodhur rishtazi, apo shumë vite më parë, nëse është një ngjarje e vetme apo është dhunë seksuale e përsëritur, ju si anëtarë të MKR do të duhet të trajtoni çdo rast të denoncuar apo raportuar pranë jush me përgjegjësi, profesionalizëm dhe efektivitet maksimal.

2.2. HAPAT E PPROCESIT TË MENAXHIMIT TË RASTIT

Menaxhimi i rastit është një proces që mund të ndahet në hapa, secili me detyra të përcaktuara qartë. Pavarësisht se hapat ndiqen me rregull njëri pas tjetrit, ka disa hapa dhe më saktë disa detyra brenda tyre, të cilat përsëriten vazhdimisht, në varësi të specifikave të rastit. Këto paraqiten të përmbledhura në tabelën në vijim:

MENAXHIMI I RASTIT	
HAPAT E MENAXHIMIT TË RASTIT	DETYRAT PËR SECILIN HAP
Hapi 1: Identifikimi dhe angazhimi <i>(Pavarësisht nëse viktima e denoncon vetë rastin, apo rasti raportohet nga një institucion i caktuar, krijohet një mjedis lehtësues për zhvillimin e të gjithë hapave të</i>	<ul style="list-style-type: none"> - Krijimi i kushteve të përshtatshme / rehatshme për të mirëpritur dhe trajtuar viktimën - Ndërtimi i besimit. - Vlerësimi i menjëhershëm i sigurisë.

<i>tjerë të menaxhimit të rastit)</i>	<ul style="list-style-type: none"> - Shpjegimi i parimit të ruajtjes së konfidencialitetit dhe kufijtë e tij. - Marrja e pëlqimit të informuar për të referuar personin tek shërbimet e duhura
<p>Hapi 2: Vlerësimi <i>(Vlerësimi i situatës dhe nevojave të viktimës, duke pasur parasysh që ka nevoja që duhet të adresohen menjëherë, siç ka edhe nevoja që kërkojnë ndërhyrje në një plan më afatgjatë)</i></p>	<ul style="list-style-type: none"> - Të kuptuarit e situatës, problemeve si dhe vlerësimi i nevojave të menjëhershme të viktimës - Sigurimi i mbështetjes emocionale të menjëhershme - Dhënia e informacionit - Përcaktimi nëse do të vijohet me menaxhimin e mëtejshëm të rastit - Vlerësimi i tërësisë së nevojave të viktimës (përfshirë nevojat afatmesme dhe afatgjata)
<p>Hapi 3: Planifikimi i ndihmës <i>(Këtu përcaktohet “kush” do të bëjë “çfarë” dhe “deri kur”)</i></p>	<ul style="list-style-type: none"> - Hartimi i planit individual të ndihmës - Marrja e pëlqimit të informuar për të bërë referime. - Dokumentimi i planit individual të ndihmës
<p>Hapi 4: Zbatimi i ndihmës së planifikuar <i>(Lidhja e viktimës me burimet psh nëpërmjet referimit, si dhe ofrimi i shërbimeve direkte, psh shërbimet psikosociale)</i></p>	<ul style="list-style-type: none"> - Asistenca ligjore/hetimi/mbledhja e provave - Ndihma dhe avokimi për viktimën për të marrë shërbime cilësore. - Sigurimi i mbështetjes së drejtpërdrejtë (nëse nevojitet). - Koordinimi i çështjeve kryesore - Dokumentimi dhe referimi
<p>Hapi 5: Ndjekja e rastit në vazhdimësi <i>(A janë përmbushur qëllimet e vendosura? Nëse Jo, bëhet rivlerësimi dhe rishikimi i planit individual të ndihmës. Nëse Po, ngrihet pyetja nëse ka nevojë viktimë për më shumë mbështetje. Nëse edhe përgjigja e kësaj pyetjeje është Po, atëherë sërish rishikohet dhe përshtatet plani individual i ndihmës. Nëse Jo, atëherë kalohet tek mbyllja e rastit.)</i></p>	<ul style="list-style-type: none"> - Ndjekja e rastit dhe monitorimi i progresit. - Rivlerësimi i sigurisë dhe nevojave të tjera të rëndësishme. - Zbatimi një plani individual të ndihmës të rishikuar (nëse është e nevojshme). - Monitorimi i vazhdueshëm i ecurisë së zbatimit të planit, pas rishikimit sipas nevojës
<p>Hapi 6: Mbyllja e rastit <i>(Viktima “del jashtë” sistemit të shërbimeve)</i></p>	<ul style="list-style-type: none"> - Vlerësimi dhe planifikimi për mbylljen e rastit

KVDHF në pozicionin e një menaxheri rasti ka këto përgjegjësi:

- Të zbatojë njohuritë mbi dhunën seksuale në punën e tij dhe të sigurojë informacionin e duhur e për viktimat/ në lidhje me dhunën që kanë pësuar, informacion ky që ndikon në rimëkëmbjen e tyre

- Të komunikojë me viktimat në një mënyrë që krijon besim dhe nxit shërimin dhe rimëkëmbjen e tyre
- Të kryejë hapat dhe procedurat përkatëse të menaxhimit të rastit. Kjo përfshin:
 - Ndjekjen e procedurave të marrjes së pëlqimit të informuar
 - Ruajtjen e konfidencialitetit, duke mbajtur në konsideratë situatat në të cilat rasti duhet të raportohet për shkak të detyrimit ligjor sipas legjislacionit në fuqi (siç u shpjegua në seksionet më sipër në këtë protokoll)
 - Bashkëpunimin me viktimën për të vlerësuar shëndetin, sigurinë, situatën psikosociale dhe nevoja të tjera përkatëse, si dhe për të përcaktuar një mënyrë veprimi për t'i adresuar ato
 - Kryerjen e vlerësimeve të vazhdueshme të sigurisë dhe planifikimin e mëtejshëm të ruajtjes së sigurisë së viktimës
 - Referimin dhe koordinimin e hapave të tjerë të kujdesit për viktimën
 - Organizimin e takimeve dhe mbledhjeve specifike për menaxhimin e rasteve.
- Të identifikojë pikat e forta dhe aftësitë që ka viktimat për t'u përballur me pasojat e dhunës dhe t'i mbështesë viktimat në këtë fazë
- Të ofrojë mbështetje emocionale për viktimat gjatë gjithë procesit të menaxhimit të rastit.

2.3. MENAXHIMI I RASTEVE TË DHUNËS SEKSUALE TEK TË RRRITURAT / RRRITURIT.

Siç u theksua në hyrje të këtij kapitulli, gjatë punës për menaxhimin e rasteve të dhunës seksuale mund të ndesheni me:

a) raste të saponodhura, pra kur dhuna seksuale është ushtruar së fundmi dhe personi është ende brenda afateve mjekësore për mbledhjen e të gjitha provave mjeko-ligjore, si dhe për denoncimin e rastit, marrjen e tërësisë së shërbimeve në dispozicion, si dhe ndëshkimit të dhunuesit;

b) raste të ndodhura kohë më parë, kur kanë kaluar afatet e mbledhjes së provave nga ana e mjekësisë ligjore, por që sërish ekziston mundësia e denoncimit të rastit dhe marrjes së tërësisë së shërbimeve në dispozicion, si dhe e përpjekjeve për ndëshkimin e dhunuesit.

Të gjithë personat e rritur të dhunuar seksualisht, të cilët në një moment të jetës së tyre vendosin të flasin e të kërkojnë ndihmë rreth situatës së kaluar, kanë të drejtë të trajtohen me përparësi e profesionalizëm nga të gjithë anëtarët e ETN-së, pavarësisht nëse dhuna seksuale e ushtruar ndaj tyre ka ndodhur së fundmi apo kohë (ndoshta dhe vite) më parë.

Në vijim paraqiten hapat që duhet të ndiqen nga anëtarët e MKR-së gjatë menaxhimit të rastit të dhunës seksuale tek të rriturat/rriturit, pavarësisht nëse është një rast i saponodhur, apo një rast i ndodhur kohë më parë.

HAPI I PARË: IDENTIFIKIMI DHE ANGAZHIMI

Identifikimi i një rasti të dhunës seksuale të ushtruar tek një person i rritur, mund të kryhet si përmes denoncimit të vetë personit në organet përkatëse të policisë ashtu edhe nëpërmjet marrjes dijeni nga ana e vetë personit, apo nga familjarët / të afërmit / miqtë me të cilët personi mund të ketë arritur të flasë rreth situatës, apo të cilët mund të kenë qenë dëshmitarë të dhunës seksuale të ushtruar. Pavarësisht mënyrës se si identifikohet një rast i dhunës

seksuale tek një person i rritur, cilido institucion anëtar i ETN-së që është pika e parë e kontaktit (pra që merr dijëni fillimisht për rastin) duhet të veprojë me profesionalizëm, përparësi e kujdes maksimal, për të mundësuar ofrimin e gjithë mbështetjes dhe ndihmës së nevojshme.

Pasi bëhet identifikimi i rastit (me vetë-identifikim apo me raportim) personi që është pika e parë e kontaktit (që merr kontaktin e parë me viktimën) prezanton veten dhe institucionin, si dhe fillon përcaktimin nëse viktima duhet të marrë shërbimet nëpërmjet menaxhimit të rastit. Ky përcaktim bëhet përmes marrjes së pëlqimit të informuar, pasi të shpjegohet se çfarë do të ndodhë gjatë punës së përbashkët, sa dhe si do të ruhet konfidencialiteti, cilat janë detyrimet ligjore për raportimin e rastit, si do të mblidhet dhe ruhet informacioni i dhënë nga viktima, cilat janë të drejtat që ka ajo, sa e rëndësishme është mbledhja sa më parë e provave mjekoligjore nëse flitet për një ngjarje të saponodhur, për të kaluar më pas tek nënshkrimi i formularit të pëlqimit të informuar.

KUJDES!

Pëlqimi i informuar merret përpara fillimit të hapit të vlerësimit të rastit, përpara bërjes së referimit në një instiucion tjetër, apo përpara marrjes së çfarëdolloj veprimi në emër të viktimës. ***POR ka disa situata për të cilat duhet të veprohet menjëherë, pa marrë pëlqimin e informuar.*** Për shembull, nëse një person ka nevojë për ndihmë të menjëhershme për të shpëtuar jetën (sepse është në rrezik të pashmangshëm pasi dhunuesi e ka ndjekur), ose kërkon kujdes urgjent mjekësor, apo konstatohet nga profesionistët se është nën stres post-traumatik, atëhere nuk mund të kalohet në të gjithë procesin e pëlqimit të informuar. Në raste të tilla, mund të bëhet thjesht një përpjekje për të marrë pëlqimin verbal të personit, nëse është e mundur.

Është e rëndësishme të mbahet në konsideratë që dallimi ndërmjet një ngjarjeje të saponodhur dhe një ngjarjeje të ndodhur kohë më parë lidhet me mundësinë për të mbledhur ose jo provat nga ana e mjekësisë ligjore. Prandaj, pas marrjes së pëlqimit të informuar, nëse policia është pika e parë e kontaktit në identifikimin e rastit dhe personi i dhunuar është i gatshëm të bëjë denoncimin mbi dhunën seksuale të pësuar, kur kemi të bëjmë me një ngjarje të saponodhur, paralelisht me marrjen e masave për ofrimin e shërbimeve të menjëhershme shëndetësore e psikologjike duke ndjekur hapat e mëtejshëm të menaxhimit të rastit, merren masat për të siguruar dhe mbledhjen e provave mjeko-ligjore. Nëse në zonën (apo pranë zonës) ku ka ndodhur ngjarja ekziston një qendër e specializuar për trajtimin e rasteve të dhunës seksuale (siç është qendra “Lilium”) policia duhet të veprojë menjëherë me njoftimin e qendrës, referimin dhe sistemimin e personit të dhunuar në këtë qendër për të ofruar mbështetjen e menjëhershme shëndetësore e psikologjike bazuar në vlerësimin e menjëhershëm të nevojave dhe marrjen e pëlqimit të informuar nga viktima, për të vijuar më pas me të gjitha procedurat që lidhen me vlerësimin e nevojave afatmesme e afatgjata, mbledhjen e provave, plotësimin e dokumentacionit të denoncimit, etj. Kjo pasi mënyra e funksionimit të qendrës “Lilium” dhe përbërja e stafit me profesioniste e profesionistë të specializuar për trajtimin e dhunës seksuale, lehtëson situatën e viktimës dhe mundëson zhvillimin e disa hapave të menaxhimit të rastit, pa qenë e nevojshme të kryhen zhvendosje të njëpasnjëshme të saj nga një institucion tek tjetri. Paralelisht me transportimin e sigurt të personit në këtë qendër të specializuar, policia duhet të bëjë edhe njoftimin e Koordinatorës/Koordinatorit Vendor kundër dhunës në familje për të qenë në gadishmëri për të mbledhur menjëherë ekipin bërthamë të ETN-së (përbërja e të cilit u sqarua në seksionet më sipër) për trajtimin në vazhdimësi të rastit.

Nëse në territorin ku ka ndodhur ngjarja nuk ekziston një qendër e tillë e specializuar (si qendra “Lilium” apo qendra të tjera të specializuara për trajtimin e viktimave të dhunës seksuale që menaxhohen nga OJF-të), **policia duhet të marrë masa dhe të sigurojë transportin e të rriturës/rriturit të dhunuar seksualisht, në qendrën më të afërt të specializuar për këtë qëllim.**

Nëse pavarësisht gadishmërisë së policisë të bërë transportin e viktimës në një qendër të specializuar, nuk ka kapacitete pritëse në këto qendra, atëhere policia në bashkëpunim me Koordinatorin/Koordinatorin Vendor sigurohen që ta vendosin personin e dhunuar në një ambient të sigurt dhe marrin masa që të ofrohet sa më parë mbështetja e nevojshme shëndetësore dhe psikologjike duke bërë vlerësimin e nevojave të menjëhershme dhe më pas të atyre afatmesme e afatgjata, si dhe të kryhet sa më parë marrja e dëshmisë dhe mbledhja e provave nëpërmjet ekzaminimit mjeko-ligjor (nëse bëhet fjalë për ngjarje të saponodhur të dhunës seksuale), gjithmonë bazuar në marrjen e pëlqimit të informuar të viktimës.

Nëse institucioni që merr kontaktin e parë dhe identifikon rastin e dhunës seksuale tek një person i rritur nuk është policia, por një anëtar tjetër i ETN-së, atëhere personit të dhunuar i jepet informacioni i nevojshëm dhe me të ndiqen hapat për marrjen e pëlqimit të informuar. Paralelisht bëhet me dije rëndësia e mbledhjes sa më parë të provave nga ana mjeko-ligjore, nëse flitet për një ngjarje të saponodhur, pavarësisht nëse personi dëshiron apo jo të vijojë me denoncimin e rastit dhe ndëshkimin e dhunuesit. Pas marrjes së pëlqimit të informuar (kur është rasti), anëtari i ETN-së njofton menjëherë policinë dhe Koordinatorin/Koordinatorin Vendor kundër dhunës në familje për të vijuar me hapat e tjerë të menaxhimit të rastit. Nëse personi i dhunuar nuk dëshiron të kryejë denoncimin e rastit dhe institucioni nuk ka detyrim ligjor për të bërë raportimin e tij në polici, atëhere anëtari i ETN-së që ka bërë fillimisht identifikimin e rastit, së bashku me Koordinatorin/Koordinatorin Vendor marrin të gjitha masat për sistemimin e personit në një ambient të sigurt, i ofrojnë të gjithë informacionin e nevojshëm dhe fillojnë trajtimin shëndetësor dhe psiko-emocional të personit, duke bërë paraprakisht vlerësimin e nevojave të menjëhershme të këtij personi dhe adresimit të tyre nëpërmjet bashkëpunimit me anëtarët përkatës të ETN-së.

Hapi i parë i menaxhimit të rastit mbetet i njëjtë edhe nëse flitet për menaxhimin e ngjarjeve të dhunës seksuale të ndodhura kohë më parë, pra jepet informacion dhe merret pëlqimi i informuar, e më pas vijohet me hapat e tjerë të ofrimit të shërbimeve shëndetësore e psiko-sociale në bazë të vlerësimit të nevojave, siç paraqitet në vijim.

HAPI I DYTË: VLERËSIMI

Një proces i mirë i vlerësimit të rastit është përcaktues për menaxhimin e tij në mënyrën e duhur dhe me efektivitet. Vlerësimi i një rasti të dhunës seksuale tek një person i rritur nënkupton si kryerjen e vlerësimit të riskut (një proces që ligjërisht duhet të kryhet nga punonjësit e policisë në praninë dhe në bashkëpunim me Koordinatorin / Koordinatorin Vendor), ashtu edhe vlerësimin e nevojave të mëtejshme emergjente dhe afatgjata të rastit, me qëllim orientimin e punës dhe mbështetjes për hapat në vijim. Këto hapa duhet të ndërmerren në bashkëpunim dhe me praninë e anëtarëve të ekipit bërthamë të ETN-së pra: policia, Koordinatorja/Koordinatori Vendor, shëndetësia dhe shërbimi social (për vendosjen e personit në një qendër të specializuar shërbimesh).

Vlerësimi si hap përfshin dëgjimin e viktimës për të kuptuar se çfarë ka ndodhur dhe cila është situata aktuale, dhënien e informacionit të duhur, si dhe ndihmën e të rriturës/rriturit të dhunuar seksualisht që tëidentifikojë, së bashku me ETN, nevojat dhe problemet e saj/tij. Pra

informacioni që mblidhet nga viktimat, përdoret së bashku me të për të përcaktuar shërbimet e kujdesit që duhet të ofrohen për të.

Është e rëndësishme të mbahet në konsideratë fakti që, pa ndërtuar një marrëdhënie besimi në hapin e parë, është thuajse e pamundur të kalohet tek ky hap i dytë, pasi një person që nuk na beson, nuk do të dëshironte të fliste me ne dhe të shpjegonte se çfarë i ka ndodhur, sidomos kur bëhet fjalë për dhunën seksuale dhe përjetimet e saj. Pasi ka filluar ndërtimi i besimit që në hapin e parë, do të duhet të vijohet më tej me forcimin e këtij besimi, duke krijuar një ambient që është miqësor dhe i kuptueshëm e jo gjykues për viktimën.

Në fillim të vlerësimit, në varësi të mënyrës se si reagon viktimat, pra nëse është apo jo gati të fillojë të flasë rreth ngjarjes, nëse KVDHF ndien hezitim, mund të fillojë komunikimin duke pyetur rreth moshës, vendbanimit, situatës familjare, arsimit/edukimit e punësimit. Ndërsa nëse nuk ndien hezitimin e saj/tij për të folur, këto të dhëna mund të merren edhe më vonë gjatë vlerësimit.

Gjatë vlerësimit është shumë e rëndësishme për KVDHF që të kuptojë sa më mirë situatën në të cilën ndodhet personi i dhunuar, cili është dhunuesi, ku ka ndodhur dhuna dhe cila ka qenë frekuenca e saj (nëse është një dhunë e ripërsëritur). Kështu, që në fillim të diskutimit KVDHF duhet të dijë nëse gjatë ngjarjes është përdorur ndonjë armë apo mjet i fortë goditës, ku është goditur personi (sidomos nëse ka goditje në kokë), a ka gjakrrjedhje, çfarë lloj penetrimi është kryer, pasi të gjitha këto shërbejnë për të kuptuar se cilat janë ndërhyrjet e menjëhershme të domosdoshme në aspektin shëndetësor.

Informimi mbi dhunuesin (dhe numrin e dhunuesve) është gjithashtu domosdoshmëri për të planifikuar masat e sigurisë dhe mbrojtjes së jetës së të rriturës/rriturit të dhunuar, pasi ndihmon në vlerësimin e rreziqeve për të ardhmen për mundësinë e dëmtimit të mëtejshëm nga dhunuesi dhe / ose miqtë dhe të afërmit e tij. Për shembull, nëse e rritura/i rrituri është dhunuar seksualisht nga një anëtar i familjes apo nga një fqinj shumë i afërt, mund të mos jetë i sigurt kthimi i saj/tij në shtëpi. Ose nëse flitet për përdhunim martesor duhet të mendohet me kujdes mundësitë për sigurinë e saj/tij duke analizuar situatën në tërësi.

Të dish kur ka ndodhur ngjarja e fundit është thelbësore për të analizuar urgjencën e një referimi mjekësor dhe për informimin e saktë të personit në lidhje me mundësitë mjekësore, pasi këto trajtime varen pikërisht nga koha se kur ka ndodhur ngjarja. Nëse personi ka një histori abuzimi seksual të përsëritur, vlerësimi duhet të përqendrohet tek ngjarja e fundit, jo se të tjerat nuk kanë rëndësi, por sepse informacioni mbi nevojën për kujdes të menjëhershëm shëndetësor është më ngushtësisht i lidhur me ngjarjen e fundit. Pasi merret ky informacion i parë është shumë e rëndësishme që të theksohet se KVDHF e kupton viktimën dhe se ajo çfarë i ka ndodhur nuk është për fajin e saj.

Gjatë hapit të vlerësimit, KVDHF nuk duhet të harrojë që fillimisht duhet të përqendrohet tek vlerësimi i nevojave të menjëhershme, të lidhura me shëndetin dhe sigurinë e personit të dhunuar. Vlerësimi i nevojave të menjëhershme kryhet sa më shpejt të jetë e mundur, mundësisht brenda 24 orëve nga momenti i identifikimit. Më pas kalohet tek mbështetja psiko-emocionale, e në varësi të dhënies së pëlqimit nga ana e personit të dhunuar, vijohet më tej me referimin për mbledhjen e provave mjeko-ligjore (kur është rasti), shërbimet ligjore, vlerësimin e situatës dhe nevojave në tërësi e proceset që vijnë në bazë të tyre.

Vlerësimi i nevojave për kujdes dhe shërbime shëndetësore.

Për një viktimë të dhunës seksuale është e domosdoshme që në fillim të procesit të vlerësimit të përcaktohet nëse ka nevojë urgjente për shërbim shëndetësor. Kjo varet shumë edhe nga forma e dhunës seksuale të ushtruar si dhe nga kohëzgjatja nga ngjarja e fundit.

Nëse ngjarja e fundit ka ndodhur brenda 72 orëve (3 ditëve) dhe viktimja ka dhimbje fizike, duhet të trajtohen këto dhimbje dhe plagë (nëse ka), duhet të ekzaminohet për dëmtime të brendshme, duhet të trajtohet me profilaksinë kundër infektimit me HIV, SST, si dhe me profilaksinë e parandalimit të shtatzanisë së padëshiruar. Të gjitha këto veprime ndërmerren vetëm, pas marrjes së pëlqimit të informuar si dhe duke u bazuar në protokollin klinik të trajtimit të situatave të tilla nga punonjësit e shëndetësisë. Më pas kalohet edhe në mbledhjen e provave mjeko-ligjore, për të cilat sigurisht i shpjegohet personit të dhunuar jo vetëm rëndësia e mbledhjes së tyre, por edhe rëndësia e respektimit të afateve kohore gjatë të cilave ato janë të vlefshme. Nëse paraprakisht personi i dhunuar është dakordësuar të trajtohet në qendrën “Lilium” këto procedura mund të kryhen aty. Gjatë vlerësimit të nevojave për kujdes të menjëhershëm mjekësor, gjithashtu duhet të informohet viktimja në lidhje me pasojat shëndetësore të dhunës seksuale dhe nevojën për trajtimin me profilaksitë e sipërcituara.

Nëse nga ngjarja e ndodhur kanë kaluar më shumë sesa 5 ditë, atëhere nevojat për shërbim shëndetësor nuk janë më urgjente, megjithatë duhet të vijohet me kujdesin dhe ekzaminimin nëkëtë drejtim, pasi sërish ka afate kohore për të respektuar (psh nëse jemi përpara një shtatzanie të padëshiruar dhe e rritura e dhunuar seksualisht kërkon të ushtrojë të drejtën e saj për abort, atëhere kjo mund të realizohet vetëm brenda afatit kohor dhe në përputhje me procedurat e përcaktuara në ligj).

Vlerësi i nevojave për mbështetje psiko-emocionale.

Nevoja për mbështetje të menjëhershme psiko-emocionale të personit të dhunuar seksualisht kuptohet që takimin e parë me të. Situata emocionale e personit, shprehja e fytyrës, gjuha e trupit, komunikimi jo-verbal, janë të gjitha shenja që na orientojnë mbi këtë nevojë. Megjithatë është e rëndësishme që KVDHF të mbajë mend që nuk mund të bëhet një vlerësim i plotë psiko-emocional që në takimin e parë. Në takimin e parë ka rëndësi edhe të jepet informacioni i duhur, por edhe të kuptohet situata në tërësi në lidhje me sistemet e mbështetjes familjare e sociale që mund të ketë viktimja, mënyrën e përballimit të stresit, frikës, nëse ka mendime vetëdëmtuese/vetëvrasëse, interesat që ka, gjërat që i nxitin shpresë dhe reagime pozitive, sepse të gjitha këto do të shërbejnë edhe për vlerësimin e nevojave tërësore më pas, por edhe për përgatitjen e planit individual të ndihmës.

Vlerësimi i riskut dhe nevojës për siguri e mbrojtje

Policia zbaton Procedurat Standarde të Veprimit për “Trajtimin e viktimave të krimeve seksuale/hetimin e krimeve seksuale, të miratuara me Urdhërin nr. 762 dt. 18.06.2019 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit¹⁹, të cilat sillen në rikujtesë më poshtë:

Për kryerjen e vlerësimit të riskut të rastit të një viktime madhore njoftohet Koordinatorja/Koordinatori Vendor kundër dhunës në familje. Në procesin e vlerësimit të riskut me mbështetjen e KVDHF mund të sigurohet informacion nga KVDHF dhe anëtarët e ETN edhe në lidhje me të shkuarën e rastit. Gjithashtu informacion sigurohet edhe nga intervista me dhunuesin apo të afërt e miq të viktimës dhe dhunuesit.

¹⁹Dokument i brendshëm vënë në dispozicion nga PSHSH.

Policia dhe KVDHF bëjnë një vlerësim të nevojave të viktimës së dhunës seksuale, ofrojnë dhe aplikojnë ndihmë e mbrojtje të mundshme, të përshtatshme dhe të pranuar vullnetarisht nga viktima.

Vlerësimi i nevojave për siguri dhe mbrojtje është i lidhur ngushtë me nevojat ligjore të viktimës së dhunës seksuale. Kështu nëse nga vlerësimi i riskut rezulton risk për jetën e viktimës atëherë policia lëshon Urdhrin për Masat Paraprake të Mbrojtjes së Menjëhershme, i cili brenda 48 orëve do t'i paraqitet gjykatës për konfirmim dhe lëshimin e UMM. Gjithashtu, paralel me përdorimin e legjislacionit civil përdoret edhe legjislacioni penal për mbrojtje nga dhuna seksuale. Ofrimi i ndihmës juridike parësore që në momentin e parë është i një rëndësie të veçantë për të vlerësuar nevojat ligjore të viktimës.

Disa nga informacionet që punonjësi i policisë ndan me rastin janë:

Informimi mbi të drejtat

- Informim mbi të drejtat e parashikuara në Kodin e Procedurës Penale;
- Informacion mbi të drejtat që burojnë si viktimë e dhunës në familje (kur është rasti) nga ligji administrativo civil nr.9669, datë 18.12.2006, “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare” i ndryshuar;
- Policia dhe KVDHF informojnë viktimën se ka të drejtë të përfitojë nga shërbimi emergjent, me një ndalesë, në mënyrë të integruar, 24/7 dhe afatshkurtër (24 orë deri në 72 orë), për viktimat e dhunës seksuale, si dhe për anëtarët e tjerë të familjeve të tyre;
- Viktimat e dhunës seksuale informohen se do të marrin shërbime multidisiplinare pranë Qendrës LILIUM. Ato informohen se në ofrimin e shërbimit do të angazhohet një ekip multidisiplinar i përbërë nga mjekë gjinekologë, pediatër, mjekë ligjorë, psikiatër, psikologë, punonjës të policisë dhe të ligjit, punonjës socialë dhe infermierë. Gjithashtu viktimat e dhunës seksuale informohen mbi llojet e shërbimeve që ofrohen në mjediset e qendrave, të cilat janë kryesisht ato mjekësore, mjeko-ligjore, të këshillimit dhe referimit në shërbime të tjera afatgjata.
- Viktimat informohen se të dhënat personale të viktimave që trajtohen me shërbime të emergjencës pranë Qendrës së menaxhimit të krizës për rastet e dhunës seksuale janë konfidenciale dhe mbrohen e përpunohen sipas ligjit në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.
- Viktimat e dhunës seksuale informohen se mbështetur në nevojat e tyre pas trajtimit emergjent që do të marrin në Qendrën LILIUM, do të referohen për trajtime afatgjatë pranë qendrave të specializuara.
- Viktimat informohen se do t’u garantohet pranë Qendrës LILUM ofrimi i një shërbimi cilësor të trajtimit emergjent të viktimave të dhunës seksuale, pavarësisht gjinisë, moshës, etnisë, nevojave të veçanta apo aftësive të kufizuara, përkatësisë fetare, identitetit gjinor apo orientimit seksual të tyre, si dhe për individët e tjerë, pjesëtarë të familjeve të tyre. Viktimat përfitojnë shërbime të kujdesit shoqëror sipas ligjit nr. 121/2016, “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”.
- Viktimat informohen se ofrimi i shërbimeve nuk do të varet nga gatishmëria e tyre për të ngritur padi apo për të dëshmuar kundër çdo dhunuesi;
 - Informohen se kanë të drejtën e marrjes së vendimit për ta përfituar shërbimin, bazuar në dhënien e një informacioni të plotë e të përditësuar. Janë viktimat e dhunës seksuale, përfaqësuesit e tyre ligjorë dhe Punonjësi/Punonjësja për Mbrojtjen e Fëmijëve (në rastin e fëmijës apo personave me aftësi të kufizuara) që do të vendosin dhe është e rëndësishme që viktimave t’u jepet i gjithë informacioni i nevojshëm për të marrë vendime të drejta për mbështetjen afat

shkurtër dhe afat gjatë²⁰. Në raste të fëmijëve viktime të dhunës seksuale vendimet lidhur me shërbimet afatshkurtra dhe afatgjata merren nga Punonjësi/Punonjësja për Mbrojtjen e Fëmijëve në bashkëpunim me Grupin Teknik Ndërsektorial dhe prindin apo kujdestarin ligjor, nëse këta të fundit nuk janë dhunuesit.

- Viktimat e dhunës seksuale nuk fajësohen, dhe informohen në lidhje me të drejtën për të mos u viktimizuar apo “fajësuar” për situatën në të cilën ndodhen.
- Nëse pas dhënies së informacionit viktimat pranojnë të trajtohen pranë Qendrës LILIUM, viktimat informohen se shërbimet mjekësore, mjeko-ligjore dhe psikosociale do të ofrohen në Qendrën LILIUM në mënyrë të tillë që të minimizohet numri i ekzaminimeve fizike dhe intervistave që viktimat duhet t’iu nënshtrohen²¹.
- E drejta për siguri është prioritet dhe policia dhe KVDHF marrin masa për transportimin e sigurtë të viktimave pranë Qendrës LILIUM, apo qendrave të tjera të shërbimeve mbështetëse të specializuara për raste të tilla.
- Për viktimën që vendos të shkojë në familjen e saj/tij: i jep personit informacion se si mund të aksesojë ndihmën e nevojshme.
- Koordinatorja/Koordinatori Vendor kundër dhunës në familje në bashkëpunim me policinë informojnë viktimën e dhunës seksuale mbi shërbimet ekzistuese dhe shpërndarjen e tyre me qëllim që viktime të mund të përfitojë nga shërbimet sa më pranë vendbanimit.

Pas vlerësimit të nevojave të menjëhershme, dhënies së informacionit të duhur, marrjes së pëlqimit të informuar dhe adresimit të nevojave të menjëhershme për shëndetin, jetën dhe sigurinë e viktimës, kalohet në procesin e vlerësimit të nevojave në tërësi. Ky proces kryhet brenda 7 ditëve nga momenti i vlerësimit të menjëhershëm, me qëllim që edhe vetë personit të dhunuar t’i lihet kohë të qetësohet. Megjithatë, periudha kohore e kryerjes së vlerësimit të plotë varion edhe nga vendimi i marrë për strehimin e personit të dhunuar në një qendër të specializuar dhe kohëzgjatja apo afatet që aplikon kjo qendër për vijimin e punës referuese e koordinuese me aktorët e tjerë.

Dokumenti i vlerësimit është gjithashtu i rëndësishëm dhe duhet të bëhet me formularë standard. Për këtë qëllim nga anëtarët e MKR-së, me përjashtim të policisë, mund të përdoret “Formulari për vlerësimin e nevojave të rastit” i paraqitur më aneksin 5 të “Protokollit të menaxhimit të rasteve të dhunës në familje e dhunës me bazë gjinore nga anëtarët e MKR-së”. Policia meqenëse përgjithësisht fokusohet në vlerësimin e riskut duhet të përdorë formularin përkatës tip të miratuar për këtë qëllim. Pavarësisht rëndësisë së dokumentimit të vlerësimit, profesionistët duhet të dinë të mbajnë balancën mes të dëgjuarit të viktimës dhe plotësimit të formularit, pasi dëgjimi është parësor dhe sigurisht më i rëndësishëm, për të kuptuar dhe vlerësuar nevojat e personit të dhunuar.

Vlerësimi i plotë i nevojave

Vlerësimi i plotë i nevojave të viktimës së rritur të dhunës seksuale realizohet nga KVDHF brenda 7 ditëve nga momenti i vlerësimit të menjëhershëm dhe ka për qëllim përcaktimin në mënyrë të plotë të situatës në të cilën ndodhet viktime si dhe mbledhjen e informacionit të nevojshëm për hartimin e planit përkatës të ndihmës.

²⁰<http://80.78.70.231/pls/kuv/f?p=201:Udh%EBzim:816:27.11.2018> p.7

²¹<http://80.78.70.231/pls/kuv/f?p=201:Udh%EBzim:816:27.11.2018> Standardi 2.3.

Vlerësimi i nevojave ligjore

Vlerësimi i plotë i nevojave përfshin edhe vlerësimin e nevojave ligjore të viktimës. Këtu përfshihet adresimi i tyre si nëpërmjet legjislacionit civil, penal, familjar, etj.

Nevojat ligjore të viktimës së dhunës seksuale do të jenë të individualizuara por disa prej tyre mund të jenë:

- Ndihma juridike në çështjen me objekt: konfirmimi i UMPMM nga gjykata e rrethit gjyqësor dhe lëshimi i UMM;
- Lëshimi i UMM;
- Lëshimi i UM;
- Përgatitja e kërkesës për ndihmë ekonomike si viktimë e dhunës në familje e pajisur me urdhër mbrojtje;
- Përgatitja e kërkesës për përfitim nga programet e strehimit social;
- Përfaqësimi i rastit në gjykatën penale;
- Kërkimi i dëmshpërblimit për dëmin e shkaktuar në gjykatën penale ose në gjykatën civile;
- Ndjekja e çështjeve familjare në gjykatë si çështje me objekt zgjidhjen e martesës dhe rregullimin e pasojave të saj, etj.

Në këtë moment viktimat e dhunës seksuale mund të ketë nevojë si për ofrimin e ndihmës juridike parësore, që mund të ofrohet nga qendrat e ndihmës juridike falas, organizatat e shoqërisë civile të autorizuara për ofrimin e ndihmës juridike si dhe Klinikat e Ligjit në Universitet, ashtu edhe ndihmës juridike dytësore si dhe përjashtimin nga pagimi i tarifave gjyqësore dhe shpenzimeve gjyqësore, sipas ligjit, dhe përjashtimin nga detyrimi për të parapaguar tarifën e vënies në ekzekutim të urdhrave të ekzekutimit.

KVDHF duhet të sigurohet që ka përditësuar të dhënat në lidhje me qendrat e shërbimit të ndihmës juridike parësore që ofrojnë shërbim falas për subjektet e veçanta të parashikuara në ligjin nr.111/2017, “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”, ku përfshihen edhe viktimat e dhunës në familje dhe viktimat e abuzuara seksualisht.

Vlerësimi i nevojave psiko-sociale

Vlerësimi i nevojave psiko-sociale synon të evidentojë se cilat janë fushat shqetësuese, cilat janë mendimet dhe shqetësimet e viktimës, çfarë mendimi ka krijuar dhe bluan aktualisht për veten, etj. Pyetjet që dejtohen gjatë vlerësimit të situatës psiko-sociale të viktimës prekin fusha të tilla si:

- shqetësimet e gjumit (a vuan viktimat nga pagjumësia, ankthet e shpeshta, a zgjohet shpesh natën, etj.)
- manifestime të simptomave psiko-somatike (dhimbje të shpeshta koke, stomaku të përzier, gjendje të fikëti, shenja të tjera në aspektin shëndetësor...)
- vështirësitë emocionale (gjendje impulsiviteti apo ndjeshmërie e lartë, gjendje e lartë, e ulët apo e alternuar emocionale, mungesë reagimi, kontrolli, stabiliteti emocional, shenja depresioni, kërcënim apo rrezik për vetë-dëmtim apo vetë-vrasje, etj.)
- vështirësitë konjitive (shkëputje mendimi, paaftësia për t’u përqëndruar, vështirësi kujtese, konfuzion i shpeshtë, reagim i vonuar, etj)
- vështirësi motivimi (mungesë iniciative për të kryer diçka, varësi e tepruar nga të tjerët, pesimizëm i shpeshtë, etj.)
- shqetësimet të sjelljes, performancës dhe funksionimit (neglizhim i higjienës dhe paraqitjes personale, përdorim i gjuhës fyese apo dhunës, etj)

- marrëdhëniet sociale (qëndrim veçmas grupit, sjellje e pahijshme, afekcion i papërshtatshëm ndaj të tjerëve, armiqësi ndaj normave sociale, shfaqja e problemeve gjatë të biseduarit, etj)
- vetë-konceptimi (perceptimi negative për veten, fajësimi, nuk merr vendime për veten, i mungon ndjenja e kuptimit të jetës, etj.)

Në varësi të gjetjeve nga ky vlerësim planifikohet dhe ndërhyrja për të ndihmuar viktimën, duke pasur parasysh referimin e saj në qendra të specializuara që ofrojnë këshillim dhe terapi mbështetjeje psiko-sociale. Referimi i viktimës për trajtim të mëtejshëm në qendra të tilla të specializuara si: Linja e Këshillimit 116 117, “Të Ndryshëm e të Barabartë”, Qendra “Vatra”, etj do të ishte shumë ndihmues në këtë drejtim, sidomos nëse kombinohej dhe me adresimin në këto qendra edhe të shërbimeve të tjera mbështetëse (psh shërbimi për strehim afatgjatë, etj)

Vlerësimi i situatës familjare

Është thelbësore që të realizohet një vlerësim i saktë i situatës familjare për të planifikuar saktë mbështetjen afatgjatë që do t’i ofrohet viktimës.

Vlerësimi i situatës familjare bazohet në:

- lidhjet mes viktimës, familjes dhe kontakteve të tjera sociale,
- çështjet me të cilat po përballlet familja si p.sh. papunësia, problemet e strehimit dhe sfidat e arsimimit dhe për të cilat ata kanë nevojë për mbështetje;
- natyrën dhe nivelin e shqetësimeve.

Një vlerësim i saktë dhe i plotë i situatës familjare është i nevojshëm për të kuptuar kontekstin, statusin e viktimës, marrëdhëniet familjare, rrjetin mbështetës që ndikojnë në përballimin e situatës.

Vlerësimi i nevojave për akomodim afatgjatë

Në vlerësimin e nevojave për akomodim afatgjatë është e rëndësishme të mblidhet informacioni i duhur në lidhje me mundësitë që ka viktimja për t’u strehuar në terma afatgjatë (psh nëse për situatën emergjente është strehuar në një strehëz, a ka mundësi më pas që të strehohet diku tjetër, a përbën rrezik mundësia që zgjedh (psh familjarët, të afërmit), a ka persona të tjerë në varësi viktimja, për të cilët gjithashtu duhet të mendohet strehimi afatgjatë, a ka mundësi viktimja që të strehohet në një apartament më vehte, çfarë lloj mbështetjeje i duhet dhënë në këtë rast (pra mbështetje për të paguar qeranë, ndërmjetësim për punësim...etj). Ndërkohë për adresimin e kësaj nevoje, në planin e ndihmës, ndër të tjera duhet të parashikohet dhe fuqizimi i bashkëpunimit dhe kërkimi i mbështetjes nga bashkitë përmes programeve të strehimit social, bonusit të qerasë, etj.

Vlerësimi i nevojave të fëmijëve

Në rastin kur viktimat e dhunës seksuale kanë fëmijë në varësi të tyre, është e domosdoshme që të mund të vlerësohet dhe situata e tyre sidomos nga momenti i largimit dhe i fillimit të trajtimit emergjent të rastit të viktimës së rritur. Është shumë e rëndësishme që të mblidhet informacion mbi personat me të cilët po qëndrojnë fëmijët, sa siguri ka qëndrimi me ta, çfarë nevojash emergjente kanë fëmijët, si do të adresohen nevojat e tyre në terma afatgjatë dhe sa ndikon kjo në mënyrën se si do të adresohet më tej edhe trajtimi i viktimës së rritur në terma afatgjatë, etj.

Vlerësimi i nevojave për arsim

Ky vlerësim evidenton shkallën e arsimimit të viktimës si dhe nëse ekziton mundësia për vijimin e arsimit (nëse ka pasur ndërprerje). Në varësi të moshës dhe viteve të arsimit të

përmbushura nga viktimja, merret më pas edhe vendimi se si mund të adresohet nevoja për arsimim të mëtejshëm të viktimës

Vlerësimi i nevojave për formim profesional dhe punësim

Gjatë kryerjes së këtij vlerësimi evidentohet se cila është situata në lidhje me punësimin e viktimës dhe nevojën që mund të ketë ajo për një formim profesional, për ndërmjetësim për punësim etj. Analizohen vitet e punës dhe profesioni që ka ushtruar, sa ekziston mundësia të vijojë të punojë aty ku ka punuar më parë (nëse ka punuar), nëse ka pasur shikëputje nga punësimi, çfarë nevojash duhet të adresohen me qëllim që të mund të riafrohet dhe të ri-integrohet në tregun e punës, sa mund të plotësohen këto përmes kurseve profesionale që ofrojnë qendrat e formimit profesional, etj.

HAPI I TRETË: PLANIFIKIMI I NDIHMËS

Pasi është përfunduar vlerësimi, dhe janë adresuar nevojat e menjëhershme të viktimës për siguri, shëndet, ushqim, veshmbathje e strehim emergjent, kalohet tek hapi i tretë i planifikimit të ndihmës, që realizohet përmes përgatitjes së planit individual të ndihmës. Ky plan përmban hapat që duhet të ndërmerren nga aktorët e ndryshëm, për të përmbushur nevojat afatshkurtra dhe afatgjata të viktimës. Ky plan adreson nevojat e viktimës dhe familjes, përcakton shërbimet e nevojshme, ofruesit e këtyre shërbimeve si dhe afatet kohore se kur do të ofrohen shërbimet. Ky plan individual i ndihmës²² përgatitet nga ETN në bashkëpunim me vetë viktimën dhe përditësohet sa herë plotësohet një nga hapat e përshkruar në të, ose në rast se lind nevoja e rivlerësimit të rrishtit për shkak të kërcënimeve që mund të marrë viktimja gjatë kohës së trajtimit. Plani individual i ndihmës duhet të hartohet brenda 5 ditëve pasi ka përfunduar vlerësimi i plotë i nevojave të viktimës.

Ndihma ndaj viktimës së dhunës seksuale mundësohet nga bashkëpunimi i shumë aktorëve, specialistë të fushës. Qendra e menaxhimit të krizës në rastet e dhunës seksuale siguron ofrimin e shërbimeve të menjëhershme, të specializuara, shumë dimensionale dhe afatshkurtër. Përmes kësaj ndërhyrjeje mundësohen shërbimet më emergjente dhe sigurimi i provave të nevojshme për ndjekjen penale të rastit. Kur hartohet plani është e rëndësishme të vlerësohen mirë alternativat e ndryshme pasi një përzgjedhje e cila mund të përmbushë një nevojë ose që mund të reduktojë një rrezik mund të ketë si pasojë shkaktimin e dëmit të mëtejshëm/krijimin e problemeve të reja.

Gjatë përgatitjes së planit individual të ndihmës, është e rëndësishme të jepet informacion dhe të dakordësohet me viktimën nëse dëshiron të referohet tek shërbimet e caktuara. Nëse po, vijohet me marrjen e pëlqimit të informuar. Më pas diskutohet dhe përcaktohet se kush do të jetë përgjegjës për ndjekjen e referimit në shërbimet e caktuara, kush do ta bëjë shoqërimin e personit të dhunuar në këto shërbime, cilat do të jenë përfitimet nga referimi në këto shërbime dhe cilat do të jenë objektivat që do të vendosen, së bashku me afatet përkatëse të realizimit të tyre. Dokumentimi i planit individual të ndërhyrjes është shumë i rëndësishëm (për këtë mund të përdoret formati i sugjeruar si aneks 6 tek Protokollin e menaxhimit të rasteve të DHF dhe DHBGJ), pasi jo vetëm që bën të mundur monitorimin e zbatimit të tij, por edhe lejon rishikimin dhe përditësimin në varësi të ndryshimit të kushteve apo plotësimit të qëllimeve primare të vendosura për menaxhimin e rastit në tërësi.

²²Formati për përgatitjen e këtij plani individual të ndihmës mund të përdoret i njëjti me atë që kemi të përcaktuar në protokollin bazë të menaxhimit të rasteve, aneks 8

E rëndësishme për anëtarët e MKR-së:

Gjatë planifikimit të ndihmës për të rriturën/riturin e dhunuar seksualisht, duhet të mbani në konsideratë tërësinë e shërbimeve të nevojshme për të cilat ato/ata kanë nevojë, të tilla si:

- Strehim i përshtatshëm dhe i sigurt
- Mbështetje e menjëhershme psiko-emocionale dhe këshillim
- Ndihmë e menjëhershme dhe e vazhdueshme shëndetësore (në përputhje me nevojat e veçanta të personit – aftësitë e kufizuara, shtatëzani e padëshiruar, varësi nga substancat, probleme të shëndetit mendor, etj)
- Mbështetje dhe ndihmë ligjore
- Informim mbi shërbimet ekzistuese dhe ndërmjetësim për referimin tek to
- Ndihmë për t'u ripërfshirë në sistemin arsimor
- Mbështetje dhe trajnim profesional e aftësim për punë
- Këshillim dhe ndërmjetësim për punësim
- Programe mbështetjeje e punësimi që u krijojnë të ardhura
- Zhvillim të aftësive për jetën
- Mbështetje dhe ndërmjetësim me familjen
- Ri-integrim në familje dhe komunitet
- Monitorimi dhe vlerësim i vazhdueshëm i shërbimeve të ofruara

KUJDES:

Për trajtimin e dhunës seksuale *në situata të emergjencave civile* ekziston një Paketë e Shërbimeve Minimale Fillestare (MISP – Minimum Initial Service Package) që mundëson ofrimin e shërbimeve të menjëhershme shëndetësore dhe për këshillim, parandalimin e rrezikut të infektimit me HIV apo SST, si dhe planifikimin e ofrimit të shërbimeve të domosdoshme të shëndetit seksual e riprodhues, në fazën akute të emergjencës civile. MISP mund të jepet pa bërë vlerësimin e nevojave të menjëhershme, pasi është e ndërtuar nga përvojat e kaluara në situata të emergjencave civile dhe mund të jepet vetëm nga persona të trajnuar për ofrimin e shërbimeve që kjo paketë përmban. Me kalimin e fazës akute të emergjencës civile, rifillon trajtimi i personit të dhunuar seksualisht në situatë të emergjencës civile, duke ndjekur hapat e menaxhimit të rastit²³

HAPI I KATËRT: ZBATIMI I NDIHMËS SË PLANIFIKUAR

Në këtë hap, koordinimi mbetet element kryesor. KVDHF së bashku me menaxheren e qendrës dhe të rastit (nëse viktima është sistemuar ndërkohë në një qendër shërbimesh mbështetëse të specializuara) marrin të gjitha masat për koordinimin e veprimeve me të gjithë aktorët, i ndjekin ato sipas rradhës së vendosur në planin individual të ndihmës dhe mundësojnë dhënien e të gjithë informacionit mbështetës të domosdoshëm.

Sikurse u theksua vazhdimisht në këtë dokument, zbatimi i planit individual të ndihmës fillon pas adresimit të nevojave të menjëhershme të viktimës për siguri, ushqim dhe veshmbathje, strehim emergjent dhe trajtim të nevojave të menjëhershme shëndetësore, të identifikuara që në hapin e dytë dhe pasi kryhet vlerësimi i plotë i nevojave të viktimës.

a) ASISTENCA LIGJORE/HETIMI/ MBLEDHJA E PROVAVE

Asistenca ligjore

²³Më shumë informacion për MISP mund të gjeni në: <https://www.endvawnow.org/en/articles/1559-minimum-initial-service-package-misp.html>

Viktimat e dhunës seksuale përfshihen tek kategoritë e veçanta të përfituesëve të ndihmës juridike që përfitojnë ndihmë juridike parësore dhe dytësore falas, pavarësisht nga të ardhurat dhe pasuria e tyre. Nëse rasti është paraqitur në polici, njoftohet menjëherë KVDHF. Një ndër nevojat e rastit është edhe ndihma juridike.

Policia në bashkëpunim me KVDHF bazuar në listën e ofruesve të ndihmës juridike parësore, (siç paraqitet në aneksin 4 të “Protokollit të menaxhimit të rasteve të DHF dhe DHBGJ nga MKR) kanë informacion mbi qendrat e ndihmës juridike parësore, organizatat e shoqërisë civile të autorizuara nga Ministria e Drejtësisë dhe Klinikat e Ligjit pranë Universiteteve. Rasti referohet menjëherë për ndihmë juridike parësore. Viktima informohet se është subjekt përfitues i ndihmës juridike dytësore. Qendrat e ndihmës juridike parësore, ose Klinikat e Ligjit apo Organizatat jofitimprurëse të autorizuara përgatisin kërkesën për ndihmë dytësore për viktimën e dhunës seksuale.

Është shumë e rëndësishme që lista e ofruesve të ndihmës juridike parësore të përditësohet vazhdimisht me qëllim mbështetjen e viktimave të dhunës seksuale me këtë shërbim dhe të jetë e publikuar në mjediset e policisë dhe KVDHF.

Kur anëtarët e ekipit bërthamë të ETN-së pra: policia, Koordinatorja/Koordinatori Vendor, shëndetësia dhe shërbimi social marrin vendim për vendosjen e personit në një qendër të specializuar shërbimesh, viktimat e dhunës seksuale referohet për ndihmë juridike parësore nga Koordinatorja e Qendrës.

Është shumë e rëndësishme që lista e ofruesve të ndihmës juridike parësore të përditësohet vazhdimisht me qëllim mbështetjen e viktimave të dhunës seksuale me këtë shërbim dhe të jetë e publikuar në mjediset e Qendrës së menaxhimit të rasteve të dhunës seksuale LILIUM, apo dhe në mjediset e qendrave të tjera të shërbimeve mbështetëse të specializuara për këtë qëllim.

Ndihma nga Policia. Viktima e dhunës seksuale në marrëdhëniet familjare përfiton mbrojtje të menjëhershme në zbatim të ligjit nr.9669, datë 18.12.2006, “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, i ndryshuar. Një viktimitë e dhunës seksuale në familje në të njëjtën kohë me ndjekjen penale mund të kërkojë mbrojtje parashikuar në ligjin nr.9669, datë 18.12.2006, “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, i ndryshuar.

Punonjësi i policisë, pasi ka analizuar vlerësimin e riskut, harton raportin e vlerësimit të riskut. Disa faktorë specifikë në rastin e dhunës seksuale që duhet të konsiderojë policia e mbështetur nga KVDHF ose punonjësi social në mungesë të tij në rastin e një viktime madhore janë: ushtrimi i dhunës seksuale në mënyrë të përsëritur, ndjekja penale ndaj dhunuesit, dënime të mëparshme për kryerjen e veprave penale që lidhen me dhunën seksuale, ushtrimin e dhunës seksuale në prani të fëmijëve, historikun e abuzimeve seksuale ndaj dhunuesit në fëmijëri, ashpërsimin e dhunës, etj.

Raportin ia paraqet titullarit të strukturës vendore të policisë, duke sugjeruar ndër të tjera edhe vendosjen e viktimës pranë qendrave të menaxhimit të krizës, për rastet e dhunës seksuale.

Në të njëjtën kohë nëse rezulton risk i lartë lëshohet UMPMM dhe policia brenda 48 orëve dërgon në gjykatë kërkesën për konfirmimin e UMPMM dhe lëshimin e UMM. Mbledhja e provave i shërben jo vetëm ndjekjes penale por edhe mbrojtjes nëpërmjet një urdhri mbrojtje. Punonjësi i policisë informon personin mbi ndihmën që mund t’i jepet, ndihmon në komunikimin me punonjësin e qendrës rezidenciale nëse është paraqitur dhe në varësi të vendimit të personit. Për personin që vendos të shkojë në një qendër të menaxhimit të krizës: informon personin dhe komunikon me punonjësin e qendrës lidhur me hapat e nevojshëm të mbrojtjes.

Hetimi

Hetimi dhe grumbullimi i provave janë të domosdoshme në rastet e dhunës seksuale. Duke qenë se ngjarja ndodh zakonisht në kushte të izolimit të viktimës, ajo mbetet prova e vetme e sjelljes së dhunshme. Hetimi i saktë dhe i plotë mund të sigurojë prova shtesë për oficerët e policisë gjyqësore që të mbështesin dëshminë e viktimës. Policia siguron viktimën e cila mund të vijojë të jetë në rrezik për jetën. Oficeri i policisë fokusohet gjithashtu në grumbullimin e provave me qëllim që të identifikojë të dyshuarin në krim. Policia nuk mund të mbështetet tërësisht vetëm në deklaratën e viktimës.

Punonjësit e policisë duhet të ndërmarrin edhe veprimet e mëposhtme:

- a. T'i shpjegojnë viktimës të drejtat e saj dhe rrugët për t'i mbrojtur ato.
- b. Ta këshillojnë viktimën mbi mundësitë që ekzistojnë për mbrojtje dhe ndihmën e disponueshme, si dhe t'i japin të gjithë informacionin që mund të jetë i nevojshëm ose i dobishëm për t'i mundësuar asaj marrjen e një vendimi.
- c. Ta informojnë viktimën mbi mundësitë e saj për mbrojtjen nga ana ligjore si dhe për hapat që ndiqen dhe mbrojtjen që ofrohet në rastin e kallëzimit të veprës penale.
- d. Pas këshillimit të viktimës mbi mundësitë e disponueshme, t'i shpjegojnë qartë procesin e mëtejshëm, duke përfshirë procedurat ligjore dhe ato të këshillimit dhe strehimit.
- e. Kur është rasti, t'i shpjegojnë viktimës për ndihmën që mund të marrë nga shërbimet sociale pranë Bashkisë/ Njësisë Administrative apo nga anëtarë të tjerë të Mekanizmit të Koordinuar të Referimit, si dhe ta referojnë rastin në strukturat përkatëse.
- f. Gjatë shpjegimit të proceseve të shmangin terminologjinë ligjore sa më shumë që të jetë e mundur, pasi shumë viktima mund të mos i kuptojnë termat ligjore dhe mund të ngatërrohen prej tyre.
- g. Të shënojnë gjithçka që deklaroi viktima, duke përdorur fjalët e saj.
- h. Të shmangin përballjen e viktimës me dhunuesin.

Për sa i përket hetimit të ngjarjes, punonjësi i policisë duhet:

- a. Të kufizohet në bërjen e pyetjeve hetimore vetëm për ato çështje të nevojshme për të identifikuar viktimën dhe përshkrimin e gjetjen e të dyshuarit;
- b. Të përcaktojë gjendjen emocionale dhe aftësinë fizike të viktimës për t'iu përgjigjur pyetjeve lidhur me sulmin dhe të kufizojë marrjen në pyetje të viktimës në përputhje me rrethanat.

Mbledhja e provave

Intervistimi nga Policia. Punonjësi i policisë që trajton rastin e një krimi seksual, interviston viktimën. Është shumë e rëndësishme që viktima e dhunës seksuale të intervistohet nga një oficer i policisë gjyqësore i të njëjtës gjini. Intervistuesi zhvillon intervistën dhe bën vlerësimin e parë të nevojave përfshirë vlerësimin e rrezikut.

- Oficerët e policisë, për gjetjen dhe marrjen e provave gjatë krimeve seksuale, duhet **t'i drejtohen shërbimit të mjekësisë ligjore**, pas marrjes së pëlqimit të miratuar të viktimës që është dakord të kryejë këtë procedurë.
- Të sigurojnë vendin e ngjarjes dhe ruajtjen e provave, duke përfshirë shtratin e fjetjes, rrobat si dhe materialet tjera në vendin e ngjarjes dhe të udhëzojnë viktimën që të mos pastrohet, derisa të jetë kryer kontrolli mjekësor;

- Të kërkojnë pëlqimin e viktimës për ndërmarrjen e kontrollit mjekësor, duke theksuar rëndësinë e tij, për sa i përket hetimit, identifikimit dhe kapjes së të dyshuarit; si dhe mirëqenies së saj fizike;
- Ta shoqërojnë viktimën së bashku me koordinatoren vendore kundër dhunës në familje deri në spital për kontroll mjekësor, ose në një qendër për menaxhimin e rasteve të dhunës seksuale;
- Të qëndrojnë në spital (por të mos jenë të pranishëm gjatë kontrollit mjekësor) derisa të arrijnë anëtarët e familjes, personeli i shërbimit të përkrahjes apo të oficerit të policisë gjyqësore;
- Të informojnë viktimën mbi rëndësinë e ekzaminimit mjeko ligjor për dokumentimin dhe mbledhjen e provave;
- Punonjësit e policisë duhet të mbrojnë integritetin e provave dhe të ruajnë dokumentimin kronologjik duke shënuar, paketuar dhe etiketuar siç duhet të gjitha provat e mbledhura.
- Të inkurajojnë viktimën që ta paraqesë rastin në gjyq nëse ajo heziton për ta bërë një gjë të tillë, duke theksuar rëndësinë e procesit gjyqësor sa i përket sigurisë së saj në vazhdimësi;
- Të kërkojnë përkrahje të vazhdueshme për viktimën rreth hetimeve, duke e informuar viktimën mbi aktivitetet hetimore dhe gjyqësore që mund apo do të kërkojnë përfshirjen dhe bashkëpunimin e saj.

Ekzaminimi mjeko ligjor

- Ekzaminimi profesional mjeko-ligjor rrit gjasat për dokumentimin e plagëve dhe mbledhjen e provave për të ndihmuar në hetimin dhe ndjekjen penale të dhunuesit. Përveç personelit të mjekësisë ligjore, ku domosdoshmërisht duhet të jetë e pranishme edhe një grua profesioniste e mjekësisë ligjore ose e shëndetësisë, asnjë oficer/oficere policie apo ndonjë person tjetër nuk duhet të jetë i pranishëm në dhomën e ekzaminimit të provave.
- Ekzaminimi mjeko-ligjor duhet të kryhet dhe të dokumentohet në kohën e duhur dhe me ndjeshmëri gjinore duke marrë parasysh nevojat dhe perspektivën e viktimës dhe duke respektuar dinjitetin dhe integritetin e saj.

b) DOKUMENTIMI DHE REFERIMI

Çdo rast i dhunës/krimeve seksuale të dokumentohet, nëpërmjet përdorimit të të gjitha veprimeve hetimore të bazuara në legjislacionin në fuqi.

Punonjësi i policisë përgatit dosjen me të gjitha të dhënat/informacionet e grumbulluara dhe e dërgon atë pranë organit kompetent për ndjekjen penale.

Koordinatorja/Koordinatori Vendor mban dy lloj të dhënash për çdo rast viktimë të dhunës seksuale:

- Informacione të detajuara për rastin dhe menaxhimin e tij (dosja e plotë e rastit). Qëllimi i këtij informacioni është të ndihmojë punonjësit në zbatimin dhe monitorimin e planit individual të ndihmës. Në të njëjtën kohë dokumentimi i saktë dhe i vazhdueshëm lehtëson komunikimin me ofruesit e tjerë të shërbimeve duke promovuar dhe vazhdimësinë e shërbimeve.
- Të dhëna statistikore në lidhje me numrin dhe llojin e rasteve të dhunës seksuale të menaxhuara, të cilat pasqyrohen në sistemin REVALB.

Të gjitha të dhënat dhe informacioni i përfutur ruhen, përpunohen dhe administrohen në përputhje me ligjin “Për mbrojtjen e të dhënave personale” dhe akteve nënligjore përkatëse, duke zbatuar detyrat dhe procedurat e parashikuara në këtë vendim. Detyrimi për konfidencialitetin dhe ruajtjen e të dhënave personale shtrihet për të gjithë personat dhe institucionet e përfshira në procesin e menaxhimit të rastit të viktimave të dhunës seksuale. Nëse rasti pranon të akomodohet në Qendrën e Menaxhimit të rasteve të dhunës seksuale, ndiqen të gjitha hapat e parashikuara në standardet e kësaj qendre si në lidhje me mbledhjen e provave ashtu edhe në lidhje me dokumentimin.

Referimi

Punonjësi i policisë duhet të jetë i informuar për shërbime të tjera ndihmëse për viktimat e dhunës seksuale, në rastet kur kontaktohet policia drejtpërsëdrejti, apo në rastet kur viktimat e krimet seksual referohet në polici nga organizata/institucione të tjera.

- Punonjësi i policisë në bashkëpunim me KVDHF, bazuar në marrjen e pëlqimit të informuar nga viktimat, referon rastin për t’u trajtuar pranë **Qendrës së Menaxhimit të krizës për rastet e dhunës seksuale “LILIUM”, ose pranë qendrave të tjera që ofrojnë këtë shërbim mbështetës të specializuar, pranë të cilave viktimat merr shërbimet e sipërcituara.**
- KVDHF duhet të përditësojnë regjistrin me institucionet/organizatat që ofrojnë shërbime për viktimat e dhunës seksuale. Regjistri duhet të përfshijë emrin e institucionit, personin e kontaktit, adresën, të dhëna të tjera për kontakt, si dhe listën e shërbimeve që ofrohen. Këtë regjistër duhet t’ja verë në dispozicion policisë dhe anëtarëve të tjerë të MKR-së
- KVDHF duhet të ndihmojë viktimën, duke i ofruar kur është rasti, edhe mbështetje dhe këshillim, si dhe alternativa për strehim, kur viktimat nuk është e gatshme të trajtohet pranë Qendrës Liliu, apo qendrave të tjera të specializuara.
- KVDHF duhet të informojnë viktimën për mundësinë e referimit tek institucione të tjera shërbimesh, sipas kërkesës ose nevojës.
- KVDHF duhet të informojnë viktimën se çfarë informacioni do të ndahet me institucionet e tjera të shërbimeve dhe çfarë informacioni do të mbahet konfidencial (duke specifikuar kufizimet për ruajtjen e konfidencialitetit në bazë të kuadrit ligjor ekzistues).
- KVDHF në bashkëpunim me antarët e tjerë të MKR-së të cilët mund të kontribuojnë për shembull për transportimin e sigurt, duhet të bëjë referimin e viktimës në këto shërbime mbështetëse për trajtimin e nevojave afatgjata të saj, duke u bazuar edhe në marrjen e pëlqimit të informuar të viktimës.
- KVDHF duhet ta shoqërojë referimin me një raport të shkurtër me shkrim për të shmangur situatën kur viktimat duhet ta përsërisë historinë dhe t’u përgjigjet të njëjtave pyetjeve gjatë intervistave të shumëfishta, duke përjetuar përsëri traumë psikologjike.
- KVDHF duhet ta shoqërojë viktimën tek shërbimi ku është referuar, ose të sigurohet që referimi i saj do të bëhet nën shoqërimin e një specialisteje të shërbimit ku po referohet.

Prokurori dhe policia gjyqësore zhvillojnë, brenda kompetencave të caktuara, hetimet e nevojshme që lidhen me ushtrimin e ndjekjes penale.

Policia gjyqësore

- Policia gjyqësore, edhe me iniciativën e vet, duhet të marrë dijeni për veprat penale, të pengojë ardhjen e pasojave të mëtejshme, të kërkojë autorët e tyre, të kryejë hetime dhe të grumbullojë gjithçka që i shërben zbatimit të ligjit penal.
- Me marrjen e njoftimit për një vepër penale, policia gjyqësore, pa vonesë, por jo më vonë se 72 orë, i referon prokurorit, me shkrim, elementet thelbësore të faktit dhe elementet e tjera që janë mbledhur deri atëherë, duke treguar burimet e provës dhe veprimet e kryera, si dhe vë në dispozicion të prokurorit, për vlerësim, të gjitha aktet dhe provat e marra²⁴.
- Policia gjyqësore kryen çdo veprim hetimor që i është urdhëruar ose deleguar nga prokurori.
- Dokumenton veprimet duke mbajtur procesverbal për: a) kallëzimet dhe ankimet e paraqitura me gojë; b) të dhënat përmbledhëse dhe deklaratimet e marra nga personi ndaj të cilit zhvillohen hetimet; c) të dhënat e marra nga personat që mund të tregojnë rrethana të dobishme për qëllimet e hetimit; ç) kqyrjet, njohjet, kontrollimet dhe sekuestrimet; d) aktet për identifikimin dhe njohjen e personit ndaj të cilit zhvillohen hetimet, për marrjen e plikove ose të korrespondencës dhe për vënien e sekuestros; e) veprimet hetimore të deleguara nga prokurori.

Prokuroria

- Gjatë hetimeve paraprake provat merren nga organi i prokurorisë;
- Prokuroria ushtron ndjekjen penale, dhe përfaqëson akuzën në gjyq në emër të shtetit, drejton dhe kontrollon hetimet paraprake dhe veprimtarinë e policisë gjyqësore, si dhe kryen vetë çdo veprim hetimor që e çmon të nevojshëm, merr masa për ekzekutimin e vendimeve penale dhe mbikëqyr ekzekutimin e tyre;
- Merr në pyetje personin e marrë si i pandehur në një procedim;
- Merr të dhëna nga viktima dhe persona që mund të tregojnë rrethana të dobishme për qëllimet e hetimit;
- Prokurori dokumenton veprimet. Prokurori mban procesverbal: a) për kallëzimet dhe ankesat e paraqitura me gojë; b) për kqyrjet, kontrollimet dhe sekuestrimet; c) për marrjen në pyetje dhe ballafaqimet me të pandehurin; ç) për të dhënat e marra nga personat që tregojnë rrethana të dobishme për qëllimet e hetimit; d) për verifikimet që kanë të bëjnë me persona, sende ose vende, gjendja e të cilëve është ndryshuar.
- Zbaton detyrat e përcaktuara në Udhëzimin e Përgjithshëm të Prokurorit të Përgjithshëm, nr.05, datë 26.10.2018, për “Garantimin e asistencës ndaj viktimave dhe dëshmitarëve të veprave penale”, neni 8, “Roli i Prokurorit”.
- Koordinatori për asistencën ndaj subjekteve me status të posaçëm përmbush detyrimet e prokurorisë për informacion ndaj viktimave dhe dëshmitarëve, referimin e viktimave tek ofruesit e shërbimeve dhe garantimin e mundësive për ushtrimin efektiv të të drejtave të tyre. Koordinatori ndihmon çdo pjesëmarrës në procedim që ka një paaftësi fizike apo mendore për të ushtruar me efektivitet të drejtën për akses në sistemin e drejtësisë penale.
- Në rastet kur ndaj dhunuesit ka filluar procedimi penal, organi i prokurorisë informon viktimën e dhunës në lidhje me të drejtat bazuar në Kodin e Procedurës Penale.

Gjykata penale

Gjykata është organi që realizon dhënien e drejtësisë. Në gjykim provat merren me kërkesën e palëve. Gjykata, pas shqyrtimit të provave në tërësi, çmon vërtetësinë dhe fuqinë provuese

²⁴Kodi i Procedurës Penale, Neni 293 “Referimi i veprës penale te prokurori”

të tyre. Çështjet penale të dhunës seksuale janë në juridiksionin e gjykatës penale, të cilat gjykojnë çështjen dhe vendosin masën e dënimit.

Qendrat shëndetësore, Njësitë Vendore të Kujdesit Shëndetësor dhe Spitalet

Në rast se, punonjësit të stafit të shërbimeve të kujdesit shëndetësor i kërkohet ndihmë nga vetë viktima apo një entitet/strukturë/institucion shtetëror ose joshtetëror për trajtimin mjekësor të një viktime të dhunës seksuale, ai ofron ndihmën e menjëhershme sipas nevojës.

Viktimaka të drejtë të zgjedhë të mos e raportojë rastin e dhunës seksuale tek një ofruer tjetër shërbimi; kjo zgjedhje duhet të respektohet dhe viktimës duhet t'i ofrohet çdo mbështetje e mundshme. Përrjashtim nga rregulli përbëjnë rastet kur viktimanuk është person madhor, kur është me aftësi ndryshe, kur ka një rrezik të dukshëm dhe të menjëhershëm të sigurisë së viktimës **OSE kur raportimi është i detyrueshëm**. Raportimi i detyrueshëm zbatohet kryesisht për rastet e abuzimit ose keqtrajtimit të të miturve.

Pas trajtimit të nevojave shëndetsore të menjëhershme, vijohet dhe me trajtimin e nevojave të tjera shëndetësore të cilat mund të jenë në terma afatmesme apo afatgjata dhe që jo domosdoshmërisht mund të kërkojnë praninë e viktimës në ambjentet e shërbimit shëndetësor. Për të siguruar trajtimin në vazhdimësi dhe në mënyrën e duhur të këtyre nevojave, duhet të bëhet një koordinim i mirë i punonjësit të kujdesit shëndetësor në ambjentet shëndetësore ku u trajtua fillimisht, me mjekun e qendrës së shërbimeve mbështetëse të specializuara ku rasti do vijojë të qëndrojë, apo me mjekun e familjes, nëse viktima rikthehet në shtëpinë e saj apo të prindërve. KVDHF gjithashtu duhet të ketë dijeni dhe të nxitë, lehtësojë këtë koordinim.

Koordinatorja/Koordinatori Vendor siguron rrjetine bashkëpunimit me qëllim referimin e viktimave në shërbime afatshkurtra dhe afatgjata.

Referimi i viktimës së dhunës seksuale do të bëhet edhe në institucione të tjera antare të MKR-së të cilat ofrojnë shërbime në fushën e arsimit, formimit profesional, punësimit, shërbime ligjore për çështje të tjera veç ndjekjes së dhunës seksuale të pësuar, etj., në varësi të nevojave dhe dakordësisë me viktimën, të pasqyruara siç duhet edhe në planin individual të ndihmës. Referimi i viktimës në këto shërbime bëhet zakonisht pasi ka kaluar momenti i adresimit të nevojave të menjëhershme dhe pas kalimit të tronditjes/shokut të viktimës nga dhuna e pësuar. Detyrimet dhe përgjegjësitë e këtyre institucioneve antare të MKR-së janë të njëjta si në trajtimin e rasteve të dhunës në familje dhe janë të listuara në Marrëveshjen e Bashkëpunimit për formalizimin e MKR-së.

SHOQËRIMI I VIKTIMËS NË QENDRËN “LILIUM” DHE TRAJTIMI I RASTIT NGA KJO QENDËR

Shoqërimi i viktimës për te Qendra “Lilium” mund të bëhet nga punonjësi i policisë, kur viktima paraqitet pranë komisariatit të policisë, nga KVDHF kur rasti paraqitet pranë bashkisë ose nga çdo profesionist tjetër që është në kontakt me viktimën për arsye pune, gjithmonë bazuar mbi dhënien e pëlqimit të informuar nga ana e viktimës. Shoqërimi në qendër në këtë rast, bëhet pasi të jetë njoftuar dhe të jetë marrë edhe dakordësia nga menaxherja e qendrës (e cila konfirmon edhe nëse qendra ka kapacitet pritës për momentin). Viktima mund t'i drejtohet edhe vetë Qendrës së menaxhimit të krizës për rastet e dhunës seksuale kur ka marrë informacione për funksionimin e saj. Në çdo rast, stafi i qendrës, duke

marrë në konsideratë dhe raportin e shkruar mbi vlerësimin paraprak të nevojave emergjente të viktimës (kur viktima referohet nga një antar i ETN-së dhe ky raport është përgatitur) vijon hapat për vlerësimin e nevojave emergjente, afatmesme dhe afatgjata, në përputhje dhe me shërbimet e koordinuara që mund të ofrohen në këtë qendër.

Viktima merr pranë Qendrës “LILIUM” shërbime parësore si shërbim shëndetësor, shërbim mjeko-ligjor, mbështetje psikosociale, veshmbathje, ushqim, referim, marrje të dëshmisë, fillim të procedurave të drejtësisë penale, si dhe këshillim psikologjik për përballimin e krizës. Për nga mënyra se si është konceptuar, Qendra “Lilium” është një qendër emergjence, pra ku të gjitha këto shërbime ofrohen për një afat deri në 72 orë dhe ku më pas qëndrimi i viktimës nuk është i mundur dhe bëhet referimi në një qendër tjetër shërbimesh mbështetëse të specializuara.

Pas marrjes së pëlqimit të informuar nga viktima, qendra mbështet procesin e mbledhjes së provave, duke filluar nga kryerja e ekzaminimit fizik sa më shpejt që të jetë e mundur, si dhe duke vijuar me mbledhjen e provave nga eksperti mjeko-ligjor. Këto procese shoqërohen paralelisht edhe me ofrimin e shërbimeve të mbështetjes psikosociale si dhe akomodim për një periudhë maksimumi 72 orë.

Koordinatorja/Koordinatori i qendrës së menaxhimit të krizës për rastet e dhunës seksuale është profesionistja/profesionisti, në Qendër që bën²⁵;pritjen e viktimave, njoftimin e ekipit multidisiplinar, si dhe që është përgjegjëse për identifikimin e nevojave të menjëhershme, referimin, menaxhimin dhe ndjekjen e rastit përgjatë qëndrimit në qendër deri në 72 orë. Ajo/ai koordinohet edhe me KVDHF me qëllim që të mundësohet referimi dhe menaxhimi i mëtejshëm i rastit, pas kësaj periudhe të akomodimit dhe ofrimit të shërbimeve tek “Lilium”.

Koordinatori/Koordinatorja e Qendrës harton në bashkëpunim me viktimën planin individual të ndihmës për adresimin e nevojave emergjente përgjatë periudhës 72 orëshe të qëndrimit në qendër, bazuar mbi vlerësimin e këtyre nevojave dhe në përputhje me shërbimet e koordinuara që ofron qendra. Vlerësimi i nevojave të viktimës bëhet menjëherë pas raportimit, duke marrë në konsideratë edhe vlerësimet e bëra më herët, nga anëtarët e tjerë të ETN-së që ishin pika e parë e kontaktit me viktimën, nëse ka një raport të shkruar për këtë qëllim. Ky vlerësim bëhet në bashkëpunim me viktimën, duke u koordinuar edhe me KVDHF kur flitet për vijimin e shërbimeve pas daljes nga qenda “Lilium”. Në rastin e procesit të lëshimit të UM por edhe në rastin e kërimit për shpërblim dëmi në gjykatën penale ose civile, vlerësimi i rastit përbën një provë që i shtohet provave të tjera.

Shërbimi shëndetësor. Në Qendrën e menaxhimit të krizës për rastet e dhunës seksuale i jepet prioritet kujdesit shëndetësor ndaj viktimës, pasi siç u theksua edhe më sipër, në rastet e dhunës seksuale dëmtimet shëndetësore mund të jenë të rënda dhe mund të rrezikojnë edhe jetën e viktimës. Kështu që siguria, shëndeti dhe mirëqenia e viktimës janë parësore. Vendojsja e qendrës në mjediset spitalore lehtëson ofrimin e kujdesit shëndetësor urgjent edhe në rastet kur viktima mund të paraqitet me probleme shëndetësore akute si plagosje, goditje në kokë, etj., që kërkojnë ndërhyrje dhe trajtim mjekësor urgjent.

²⁵ Ligj nr. 121/2016, “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”, neni 3, “Përkufizime”, pika 24

Shërbimi mjeko-ligjor. Në kushtet e një sulmi/dhune seksuale/ përdhunimi të denoncuar deri brenda tre ditëve nga momenti që ngjarja ka ndodhur, shërbimet për ekzaminimin mjeko-ligjor, si: mbledhja e provave, marrja e dëshmisë, fillimi i procedurave të drejtësisë penale janë vendimtare për të gjithë procesin e mbështetjes së viktimës dhe penalizimin e dhunuesit. Vonesa në qasjen në këtë shërbim mund të rezultojë në: ndryshime në provat fizike (p.sh. shërimi i plagëve); humbje të materialit mjeko-ligjor (p.sh. dëshmi e kontaktit me sulmuesin përfshirë gjakun dhe spermën), etj.

Shërbimi psikologjik synon të rikthejë sigurinë, besimin, të kapërcejë traumën momentale dhe efektet e sulmit seksual, të vendosë ekuilibrin emocional dhe funksional të individit. Ky shërbim ofrohet përgjatë kohës së qëndrimit të viktimës në “Lilium” nga psikologu klinik që ka marrëveshje bashkëpunimi me Qendrën. Psikologu/psikologia klinik/klinike ka njohuri të punës me viktimat e dhunës seksuale, fëmijë, gra apo burra dhe njeh e respekton kodin e etik të fushës.

Shërbime ligjore. Viktimës së dhunës seksuale, gjatë qëndrimit në Qendër i ofrohet ndihmë ligjore nga personeli i kontraktuar nga qendra ose nga ndonjë institucion tjetër që ofron ndihmë juridike si OJF-të e specializuara në këtë fushë, klinikat ligjore pranë institucioneve të arsimit të lartë, avokatët që përfshihen në listën e miratuar nga Dhoma Kombëtare e Avokatisë etj. Shërbimi ligjor ofrohet në mënyrë profesionale, cilësore, efiçente dhe efektive. Ndihma juridike ofrohet, pavarësisht të ardhurave dhe pasurisë së viktimave/të mbijetuarve për shkak se viktimat e dhunës seksuale përfshihen te kategoritë e veçanta të përfituesve të ndihmës juridike²⁶.

Viktimat e dhunës seksuale informohen si në lidhje me të drejtat ligjore bazuar në legjislacionin administrativo-civil kundër të gjitha formave të dhunës me bazë gjinore ashtu edhe në legjislacionin procedural penal²⁷.

Është detyra e menaxherit/menaxheres së Qendrës të vendosë kontakte midis viktimës dhe avokates/avokatit.

Mbështetja me veshje, ushqime etj. Sipas rastit, viktimat/ e dhunës seksuale mbështeten me ushqim, veshmbathje dhe medikamente. Kjo bëhet e mundur përmes shërbimit të Qendrës si pjesë e institucionit të shërbimit shëndetësor ose të paketës së shërbimit që ofron qendra. Sigurimi i shërbimeve afatmesme dhe afatgjata, pas daljes së viktimës nga “Lilium” kryhet nga anëtarët e Mekanizmit të Koordinuar të Referimit.

Shërbime të tjera: Shërbimet e mësipërme janë të gjitha në kushte të emergjencës dhe ofrohen për periudhë afatshkurtër nga 24 orë deri në 72 orë. Largimi i viktimës nga qendra iu bëhet e ditur anëtarëve të MKR-së në nivel vendor dhe vendoset në bashkëpunim me KVDHF-në, me qëllim që rasti të vijojë të referohet dhe monitorohet në vazhdimësi prej tij. Përfituesi/përfituesja e shërbimit të Qendrës mund të zgjedhë të kthehet në familje. Në këtë rast Qendra LILIUM sërish bashkëpunon me MKR për sigurimin e ofrimit të shërbimeve në terma afatmesëm e afatgjatë.

Nëse nuk kthehet në familje, referimi për strehim në strehëzat e të mbijetuarave të dhunës, mbështetja psikosociale, trajnimi profesional, punësimi, kujdesi për fëmijët, kthimi i fëmijëve në shkollë etj., janë shërbime afatgjata që mund të realizohen vetëm nëpërmjet bashkëpunimit

²⁶ Ligji nr. 111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”, neni 11, “Kategoritë e veçanta të përfituesve të ndihmës juridike”

²⁷ Ligji nr. 35/2017 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7905, datë 21.3.1995, “Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar”.

të Qendrës me MKR-në për të siguruar mbështetjen afatgjatë përmes bashkëpunimit me institucionet e specializuara publike dhe jopublike.

Në çdo rast, duhet mbajtur parasysh se ndihma, mbështetja që i ofrohet viktimës nuk varet nga disponibiliteti i saj për të denoncuar dhunuesin dhe as nga fakti që viktima ka kërkuar apo jo UM apo UMM.

Qendra ruan dhe mbron të dhënat e viktimave në bazë të legjislacionit në fuqi.

Aksesueshmëria

Qendra LILIUM siguron se shërbimet janë të aksesueshme për të gjitha kategoritë e viktimave të dhunës seksuale që u përkasin grupeve të ndryshme të marginalizuara si përfaqësues nga komuniteti rom, egjiptian, personave dhe fëmijëve me aftësi të kufizuara, persona nga zonat rurale, emigrante, azil kërkues, persona të komunitetit LGBTI+ etj.

Nëlistën e profesionistëve “on call” të qendrës ka edhe disa përkthyes profesionistë, përfshirë edhe interpretë të gjuhës së shenjave, për personat që kanë nevojë për këtë lloj shërbimi.

Në rastin e viktimave që ndodhen në zona të thella, në distancë nga Qendra, këshillohet bashkëpunimi me MKR-në në atë zonë për të mundësuar transportin e viktimës drejt qendrës “Lilium”. Kur provohet se viktima e dhunës seksuale ka probleme të rënda të shëndetit mendor, është në varësi të alkoolit apo substancave të tjera, bashkëpunohet me shërbimet e specializuara në nivel vendor apo kombëtar.

Kur viktima është një person me nënshtetësi të huaj dhe ndodhet në Shqipëri si vizitor, azil kërkues apo për çdo arsye tjetër nevojitet një përkthyes dhe më pas mundësohet ofrimi i të gjitha shërbimeve të qendrës.

Qendra siguron shërbime për fëmijët në një mjedis fizik të përshtatshëm për ta dhe me pajisje të posaçme për intervistimin e fëmijës (p.sh. dhoma me xham ose kamera regjistruese).

Qendra mundëson gjithashtu referimin në bashkëpunim me KVDHF në shërbime të tjera shtesë, siç janë shërbimet e strehimit në qendra rezidenciale, shërbimet psikologjike afatgjata, shërbimet mjekësore dhe shërbime juridike.

Shërbimet afatgjata dhe ri-integruese

Qendrat e shërbimeve afatgjata janë shërbime të përkohshme, të specializuara, rezidenciale dhe jorezidenciale, që ofrojnë shërbim të specializuar, strehimin, sigurinë fizike, ushqimin, kujdesin shëndetësor, rehabilitimin psikosocial, terapinë fizike, aktivitete profesionale, kalimin e kohës në komunitet, edukimin, në varësi të nevojave të identifikuara dhe të zgjedhura nga viktima. Ky shërbim mund të ofrohet nga institucione publike dhe jopublike. Aktualisht kjo paketë e plotë shërbimesh ri-integruese ofrohet nga Qendra Psiko – Sociale “Vatra” dhe “Të Ndryshëm dhe të Barabartë” në bashkëpunim me institucionet vendore përgjegjëse për raste nga e gjithë Shqipëria.

HAPI I PESTË : NDJEKJA E RASTIT NË VAZHDIMËSI

Ndjekja e rastit në vazhdimësi bëhet kryesisht nëpërmjet KVDHF i/e cili/cila bashkëpunon dhe me menaxheren/menaxherin e rastit kur viktima është sistemuar në një qendër

shërbimesh mbështetëse të specializuara. Ndjekja e rastit mund të bëhet përmes takimeve me viktimën, sipas një kalendari takimesh të dakordësuara paraprakisht me të, ku janë specifikuar edhe elementë të tjerë lidhur me mjedisin ku do të bëhet takimi, kohëzgjatjen, etj.

MONITORIMI DHE VLERËSIMI.

Monitorimi i rasteve viktime të dhunës seksuale kryhet nga KVDHF nëpërmjet kontakteve me viktimën me qëllim vlerësimin e ecurisë dhe efikasitetin e ndërhyrjeve të përcaktuara në Planin Individual të Ndhmës. Monitorimi i rastit analizon gjithashtu veprimet dhe masat e ndërmarra për të vlerësuar nëse ato po zbatohen sipas planit, nëse janë akoma të nevojshme dhe nëse kanë nevojë për përshtatje në përputhje me nevojat në ndryshim të viktimës.

Gjatë ndjekjes në vazhdimësi të rastit monitorohen dhe vlerësohen:

- **Gjendja dhe funksionimi psiko-emocional i viktimës.** Nëse vihet re se ka paqëndrueshmëri apo përkeqësim në këtë drejtim, atëherë duke u përpjekur të dakordësohet edhe me viktimën, bëhet referimi për një shërbim psikologjik më të specializuar e më të thelluar në këtë drejtim.
- **Vlerësimi i zbatimit të planit individual të ndihmës, së bashku me viktimën.** Këtu diskutohet me të se sa është mundësuar ofrimi i shërbimeve të planifikuara, sa janë arritur qëllimet dhe për çfarë tjetër ka nevojë viktime.
- **Përditësimi i planit individual të ndihmës.** Bazuar në diskutimet dhe gjetjet nga diskutimi mbi zbatimin e planit individual të ndihmës, në bashkëpunim me viktimën dhe me antarët e ETN-së bëhet dhe përditësimi i këtij plani, me qëllim që të adresojë aspekte të tjera të nevojave, apo nevoja të reja të identifikuara.
- **Zbatimi i planit të rishikuar individual të ndihmës.** Pasi përditësohet, fillon ndjekja dhe zbatimi i këtij plani, ku sipas nevojës ribëhen referime duke u paraprirë nga marrjet e pëlqimit të informuar dhe të gjitha procedurat siç u theksuan me detaje në këtë protokoll.

Duhet të mbahet në konsideratë fakti që jetët e viktimeve nuk janë kaq të kornizuara me hapa të rregullt dhe për shkak të dhunës së pësuar ato kanë nevojë të here pas hershme të adresimit të situatës së tyre, duke ripërsëritur hapa të caktuar të menaxhimit të rastit. Po kështu, nevojat e tyre janë shumë komplekse dhe MKR-ja jo domosdoshmërisht mund të arrijë t'i plotësojë të gjitha ato. E rëndësishme është që të gjithë antarët të përpiqen maksimalisht në këtë drejtim.

HAPI I GJASHTË: MBYLLJA E RASTIT

Ekipi Teknik Ndërdisciplinar (ETN) pas monitorimit dhe vlerësimit të vazhdueshëm, kur e konsideron se janë përbushur të gjitha veprimet e planifikuara për ndjekjen e një rasti dhe secili institucion ka kryer me përgjegjshmëri detyrimet e tij, vendos të shkojë drejt hapit të mbylljes së rastit. Në mbylljen e rastit, ETN vlerëson me kujdes situatën e viktimës, nëse viktime ka përfutur shërbimet që i nevojiten, nëse pas këtyre shërbimeve të vazhdueshme është kaluar trauma e dhunës së përjetuar, nëse viktime është në një gjendje shëndetësore të mirë dhe është rehabilituar me të gjitha shërbimet e nevojshme. Vendimi për mbylljen e rastit merret nga KVDHF pasi ka dakordësuar paraprakisht me të gjithë antarët e ETN bërthamë dhe të tjerë që u përfshinë në menaxhimin e rastit, si dhe duke bashkëbiseduar dhe dakordësuar edhe me viktimën, kur:

Ndërhyrjet e ndërmarra e kanë reduktuar nivelin e rrezikut, në rrezik të ulët ose mungesë rreziku;

- gjatë monitorimit të vazhdueshëm nuk kanë rezultuar rrethana ose fakte që viktime mund të kthehet në situatën e mëparshme si një rast recidivist apo siç mund të

jenë p.sh. pamundësi e ri-integrimit të viktimës (për shkaqe të lidhura me mungesën e strehimit, punësimin, etj).

- nëse si rezultat i shërbimeve dhe mbështetjes së ofruar rezulton se është kapërcyer trauma e dhunës me të cilën është përballur viktimja;
- viktimazhvendoset në një zonë tjetër dhe referohet për ndjekje tek KVDHF/ ETN e asaj zone, pasi është bashkëpunuar për dhënien e informacionit të nevojshëm dhe për çdo nevojë tjetër nga KVDHF/ ETN e vendbanimit të përhershëm.
- Viktimja humbet jetën/vdes.

Rastet të cilat rezultojnë të mos jenë në rrisht pas monitorimeve të vazhdueshme mbylljen nga KVDHF vetëm pasi pas përfundimit të shërbimeve të ofruara, dhe vetëm pasi kryhet edhe një tjetër vlerësim, bazuar në rezultatet e të cilit anëtarët e ETN-së dhe profesionistët të cilat/cilët kanë ofruar shërbime për rastin, bien dakord për mbylljen e tij.

Duhet mbajtur në konsideratë fakti që edhe vetë viktimja mund të vendosë që rasti të shkojë drejt mbylljes, nëse nuk jep pëlqimin e informuar për vijimin e hapave të mëtejshëm të mbështetjes, pavarësisht se mund të mos jenë adresuar plotësisht të gjitha nevojat e saj, siç ishin parashikuar në planin individual të ndihmës. Në këtë situatë, ETN duhet të respektojë dëshirën/vendimin e viktimës, duke i bërë paraprakisht të qartë pasojat/efektet që mund të ketë mbyllja e rastit pa adresuar plotësisht nevojat e identifikuar me shërbimet e parashikuara.

2.4. MENAXHIMI I RASTEVE TË DHUNËS SEKSUALE TË USHTRUAR TEK PERSONAT E MITUR NË FAMILJE

Gjatë punës për menaxhimin e rasteve të dhunës seksuale tek personat e mitur të dhunuar në familje, duhet të kemi parasysh që pavarësisht nëse dhuna seksuale e ushtruar në marrëdhëniet familjare ka ndodhur rishtazi apo kohë më parë, **rastet do raportohen domosdoshmërisht pranë policisë**, për shkak të moshës së personit të dhunuar dhe faktit që e mitura/i mituri ende vijon të jetojë në familje ndoshta shumë pranë me dhunuesin dhe ndoshta edhe në rrisht të përsëritjes apo përshkallëzimit të dhunës.

Trajtimi i një personi të mitur të dhunuar seksualisht në marrëdhëniet familjare do të bëhet në bashkëpunim me Specialistin/Specialistin e Mbrojtjes së Fëmijëve dhe me institucionet përgjegjëse si ASHDMF, etj. Këto institucione kanë përgjegjësi parësore në vendim-marrjen për mënyrën se si do të trajtohet një fëmijë i dhunuar seksualisht, por kur flitet për dhunë seksuale në marrëdhëniet familjare, bashkëpunimi me ETN bërthamë, është domosdoshmëri. Edhe nëse rasti evidentohet nga vetë këto institucione, është detyrim njoftimi i KVDHF dhe ETN bërthamë, për të trajtuar rastin bashkërisht. Denoncimi/raportimi i rastit të dhunës seksuale tek një i mitur është detyrim ligjor për të gjithë anëtarët e ETN-së.

Menaxhimi i rastit të fëmijës së dhunuar seksualisht do të kalojë nëpër të gjitha hapat e menaxhimit të rastit të përshkruar në seksionin 2.3 të këtij protokollit ku u trajtua menaxhimi i rastit të viktimës së rritur të dhunës seksuale, por duke pasur në konsideratë specifikat kur flitet për trajtimin dhe menaxhimin e rastit të një fëmije si dhe duke iu referuar Vendimit nr. 578, datë 03.10.2018 “Për procedurat e referimit e të menaxhimit të rastit, hartimin dhe përmbajtjen e planit individual të mbrojtjes, financimin e shpenzimeve për zbatimin e tij, si dhe zbatimin e masave të mbrojtjes”.

HAPI I PARË: IDENTIFIKIMI DHE ANGAZHIMI

Identifikimi i një rasti të dhunës seksuale të ushtruar tek një person i mitur, mund të kryhet si përmes denoncimit të vetë personit, apo të kujdestarit të tij në organet përkatëse të policisë ashtu edhe nëpërmjet marrjes dijani nga ana e vetë personit apo nga familjarët / të afërmit / miqtë me të cilët personi mund të ketë arritur të flasë rreth situatës, apo të cilët mund të kenë qenë dëshmitarë të dhunës seksuale të ushtruar. Pavarësisht mënyrës se si identifikohet një rast emergjent i dhunës seksuale tek një person i mitur, cilido institucion anëtar i ETN-së që është pika e parë e kontaktit (pra që merr dijani fillimisht për rastin) duhet të veprojë me profesionalizëm, përparësi e kujdes maksimal, për të mundësuar ofrimin e gjithë mbështetjes dhe ndihmës së nevojshme, duke filluar që me njoftimin e menjëhershëm të policisë, **edhe nëse viktima apo kujdestari ligjor nuk e dëshiron denoncimin e rastit, pikërisht sepse bëhet fjalë për dhunë seksuale në familje dhe duhet të merren masa për largimin e menjëhershëm të dhunuesit apo të fëmijës nga ky ambient i dhunshëm.**

Përpara raportimit të rastit në polici, institucioni i parë me të cilin kontaktohet sigurohet që të komunikojë në mënyrën e duhur, të ofrojë informacion mbi shërbimet në dispozicion dhe hapat që do të ndërmerren, si dhe të përpiqet të marrë një pëlqim të informuar nga vetë viktima, kuptohet në përputhje me moshën dhe zhvillimin e saj. Të gjitha këto hapa duhet të hidhen në praninë e Specialistit/Specialistes së Mbrojtjes së Fëmijëve, i cili/e cila ka dhe detyrimin të informojë dhe koordinojë veprimet e Grupit Teknik Ndërsektorial që vijon më tej me marrjen në mbrojtje dhe menaxhimin e rastit të fëmijës së dhunuar seksualisht.

HAPI I DYTË: VLERËSIMI

Vlerësimi i një rasti të dhunës seksuale tek një person i mitur në familje, duhet të kryhet menjëherë dhe pa humbur kohë nga policia në praninë dhe në bashkëpunim me Specialistin/Specialistin e Mbrojtjes së Fëmijëve, Psikologun e Policisë dhe Koordinatorin/Koordinatorin Vendor kundër dhunës në familje. Ky ekip bërthamë do të jetë përgjegjës si për kryerjen e vlerësimit të riskut ashtu edhe për vlerësimin e nevojave të mëtejshme emergjente dhe afatgjata të rastit, me qëllim orientimin e punës dhe mbështetjes për hapat në vijim.

HAPI I TRETË: PLANIFIKIMI I NDIHMËS

Pasi është përfunduar vlerësimi, duhet të hartohet një plan ndihme dhe mbrojtjeje i cili përmban hapat që duhet të ndërmerren nga aktorët e ndryshëm, për të përmbushur nevojat e fëmijës viktimë të dhunës seksuale në familje. Plani hartohet nga Punonjësja/Punonjësi për Mbrojtjen e Fëmijëve në bashkëpunim me Koordinatorin/Koordinatorin Vendor dhe miratohet gjatë takimit të Grupit Teknik Ndërsektorial, ku mund të ftohen edhe anëtarët e ETN bërthamë. Ky plan adreson nevojat e fëmijës dhe familjes, përcakton shërbimet e nevojshme, ofruesit e këtyre shërbimeve si dhe afatet kohore se kur do të ofrohen shërbimet.

HAPI I KATËRT: ZBATIMI I NDIHMËS SË PLANIFIKUAR ASISTENCA LIGJORE/HETIMI/ Mbledhja e provave

Intervistimi

Mbrojtja dhe mbështetja për viktimat e mitur/fëmijë nënkupton masa për të garantuar që fëmijët, viktima të dhunës seksuale janë të mbrojtur dhe mund të marrin shërbimet e nevojshme si trajtim mjekësor, këshillim, mbështetje psikoemocionale.

Në lidhje me mjetet administrativo civile, struktura përgjegjëse pranë Policisë së Shtetit, në rastin kur fëmijët janë viktima të dhunës së drejtpërdrejtë në familje, menjëherë pas marrjes në mbrojtje të fëmijës dhe referimit të rastit pranë Njësisë për Mbrojtjen e Fëmijëve në Bashki / punonjësit për mbrojtjen e fëmijëve në njësitë administrative të Bashkisë, harton raportin e vlerësimit të

riskut në prani të përfaqësuesit të kësaj të fundit²⁸. Nëse rezulton risk për jetën lëshohet Urdhri për Masat Paraprake të Mbrojtjes së Menjëhershme.

Punonjësi i policisë, pasi ka analizuar vlerësimin e riskut, harton raportin e vlerësimit të riskut. Këtë raport ia paraqet titullarit të strukturës vendore të policisë, duke sugjeruar ndër të tjera edhe vendosjen e viktimës pranë qendrave të menaxhimit të krizës, për rastet e dhunës seksuale si edhe zbatimin e UMPMM-së, në rastin e dhunës së ushtruar drejtpërdrejt mbi fëmijët në qasje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e fëmijëve, nën përgjegjësinë e Njesisë për Mbrojtjen e Fëmijëve²⁹;

Lëshimi i UMPMM-së nuk pengon ndjekjen penale të dhunuesit.

Në lidhje me ndjekjen penale të çështjes, në mbledhjen e provave gjatë intervistimit të viktimës së dhunës seksuale të mitur, policia të sigurohet që për trajtimin dhe intervistimin e tyre të zbatohen detyrimet e Kodit të Drejtësisë Penale për të miturit, sipas PSV nr. 336, datë 04.04.2018 “Për trajtimin e të miturve gjatë fazës së hetimeve paraprake”.

Në lidhje me informimin në rastin e një viktime të dhunës seksuale të mitur informohet përfaqësuesi ligjor.

Prokuroria, policia gjyqësore ose NJMF marrin masa për shmangien e kontaktit të drejtpërdrejtë midis të miturit viktimë ose dëshmitar dhe të akuzuarit, në çdo fazë të procesit.

Rregulla të veçanta të pyetjes së të miturit viktimë dhe/ose dëshmitar i shfrytëzimit seksual ose dhunës seksuale

1. Përveç rregullave të parashikuara në nenin 58/b, të Kodit të Procedurës Penale, zbatohen rregullat e parashikuara në nenin 40, të këtij Kodi, në pyetjen e të miturit viktimë dhe/ose dëshmitar, të shfrytëzimit seksual ose dhunës seksuale. Për këta të mitur, regjistrimi audio dhe video gjatë pyetjes është i detyrueshëm.

2. Dëshmia në audio dhe video e dhënë nga i mituri/e mitura mund të shfaqet gjatë seancës gjyqësore.

3. Dëshmia e të miturit/miturës viktimë e shfrytëzimit seksual dhe/ose abuzimit seksual mund të dëgjohet në sallën e gjyqit pa qenë i pranishëm vetë i mituri/ e mitura, nëpërmjet përdorimit të teknologjive të nevojshme të komunikimit.

4. E mitura/i mituri dëshmitar ose viktimë e dhunës në familje ndalohet të merret në pyetje në praninë e prindit ose të afërmit abuzues gjatë procedurës së vendosjes së urdhrin të mbrojtjes, urdhrin të menjëhershëm të mbrojtjes.

5. Në rastet me të mitura/mitur viktime ose dëshmitarë të shfrytëzimit seksual dhe/ose abuzimit seksual, gjithë procesi i gjykimit zhvillohet me dyer të mbyllura.

Ndihma juridike falas

Të mkturat/miturit viktime gëzojnë të drejtën e ndihmës juridike falas në çdo fazë të procedimit penal, referuar nenit 11, “Kategoritë e veçanta të përfituesëve të ndihmës juridike” të ligjit nr.111/2017, “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”. E mitura/i mituri viktimë ka të drejtë të mbrohet pa pagesë gjatë gjithë procesit të drejtësisë nga një avokate/avokat, të cilën/cilin e zgjedh nga lista përkatëse e hartuar nga Dhoma Kombëtare e Avokatisë.

²⁸Udhëzim i përbashkët, nr. 866, datë 20.12.2018, Për procedurat dhe modelin e vlerësimit të riskut për rastet e dhunës në familje.

²⁹Udhëzim i përbashkët, nr. 866, datë 20.12.2018, Për procedurat dhe modelin e vlerësimit të riskut për rastet e dhunës në familje.

Neni 45 i Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur parashikon në nenin 45 të drejtën për kompensim të viktimës. E drejta për kompensimin e dëmit 1. Të miturit viktimë të veprës penale, si edhe përfaqësuesit të tij ligjor i komunikohet dhe i shpjegohet vendimi i gjykatës lidhur me veprën penale përkatëse, në mënyrë sa më të përshtatshme për moshën dhe nivelin e kuptueshmërisë. 2. Gjykata, nëse është rasti, e informon të miturin viktimë të veprës penale dhe përfaqësuesin e tij ligjor lidhur me të drejtën për kompensimin e dëmit të shkaktuar.

DOKUMENTIMI DHE REFERIMI

Punonjësja/Punonjësi për Mbrojtjen e Fëmijëve bashkëpunon ngushtësisht me KVDHF për ruajtjen e të dhënave individuale për rastin dhe menaxhimin e tij. Informacioni në dosjen e fëmijës viktimë të dhunës seksuale në familje përdoret për veprimet që do të ndërmarren për zgjidhjen e rastit, duke ruajtur konfidencialitetin dhe interesin më të lartë të fëmijës. Fëmijët, kujdestarët dhe familjet përgjegjëse informohen për ndarjen e informacionit dhe i kërkohet të nënshkruajnë formularin e miratimit për ndarjen e informacionit kur kjo është e mundur dhe nuk bie ndesh me interesin më të lartë të fëmijës. Kur një familje ose fëmijë nuk jep aprovimin për ndarjen e informacionit, por kjo gjykohet si e nevojshme për të siguruar mbrojtjen e fëmijës, atëherë informacioni duhet ndarë edhe pa marrë miratimin e tyre nga Punonjësi/ja për Mbrojtjen e Fëmijëve. Çdo rast i dhunës/krimeve seksuale dokumentohet, nëpërmjet përdorimit të të gjitha veprimeve hetimore të bazuara në legjislacionin në fuqi. Punonjësi i policisë përgatit dosjen me të gjitha të dhënat/informacionet e grumbulluara dhe e dërgon atë pranë organit kompetent për ndjekjen penale. Koordinatorja/Koordinatori Vendor në bashkëpunim me Punonjësin/Punonjësen për Mbrojtjen e Fëmijëve sigurojnë referimin e fëmijës/fëmijëve viktimave të dhunës seksuale në familje në shërbime afatshkurtra dhe afatgjata.

Shërbime pranë Qendrës LILIUM:

Në rastin e fëmijëve të abuzuar seksualisht në familje, të drejtën e marrjes së vendimit për përfitimin e shërbimeve nga fëmijët, bazuar në dhënien e një informacioni të plotë e të përditësuar e ka Njësia për Mbrojtjen e Fëmijëve në bashkëpunim me GTN që ngrihet për shqyrtimin e rastit. Ata janë pjesë e rëndësishme e përgatitjes së planit të nevojave të viktimës së mitur të dhunës seksuale së bashku me pjesëmarrjen e fëmijës.

Ofrimi i shërbimit psikologjik për fëmijët viktime të dhunës seksuale është shumë i rëndësishëm për të rikthyer sigurinë, besimin dhe kapërcimin e traumës nga sulmi seksual.

Rasti referohet pranë Qendrës LILIUM dhe përfiton të gjitha shërbimet e integruara që ofron kjo qendër për viktimat e dhunës seksuale të përmendura më lart.

Referimi i rastit pranë strukturave mbrojtëse për fëmijët dhe ofrimi i shërbimeve afatgjata është një moment shumë i rëndësishëm në menaxhimin e rastit.

HAPI I PESTË:NDJEKJA E RASTIT NË VAZHDIMËSI MONITORIMI DHE VLERËSIMI.

Monitorimi i rasteve të fëmijëve viktime të dhunës seksuale në familje kryhet nga Punonjësja për Mbrojtjen e Fëmijëve në bashkëpunim me Koordinatorin/Koordinatorin Vendor nëpërmjet kontakteve me rastin, me qëllim vlerësimin e ecurisë dhe efikasitetin e ndërhyrjeve të përcaktuara në Planin Individual të Ndihmës. Monitorimi i rastit analizon gjithashtu veprimet dhe masat e ndërmarra për të vlerësuar nëse ato po zbatohen sipas planit, nëse janë akoma të nevojshme dhe nëse kanë nevojë për përshtatje në përputhje me nevojat në ndryshim të fëmijës.

HAPI I GJASHTË: MBYLLJA E RASTIT

Vendimi për mbylljen e rastit merret nga Punonjësi/Punonjësja për Mbrojtjen e Fëmijëve pas dakordësimit nga të gjithë antarët e GTN-së. Ky vendim i komunikohet edhe KVDHF-së, meqenëse flitet për rast të dhunës seksuale në familje. Ky vendim merret kur:

Ndërhyrjet e ndërmarra e kanë reduktuar nivelin e rrezikut, në rrezik të ulët ose mungesë rreziku;

- gjatë monitorimit të vazhdueshëm nuk kanë rezultuar rrethana ose fakte që viktima mund të kthehet në situatën e mëparshme;
- nëse si rezultat i shërbimeve dhe mbështetjes së ofruar rezulton se është kapërcyer trauma e dhunës me të cilën është përballur viktima;
- viktima zhvendoset në një zonë tjetër dhe referohet për ndjekje tek PMF/GTN në bashkëpunim dhe me KVDHF e asaj zone, pasi është bashkëpunuar për dhënien e informacionit të nevojshëm dhe për çdo nevojë tjetër nga PMF/KVDHF e vendbanimit të përhershëm.
- Viktima humbet jetën/vdes.

III. UDHËZIME TË MËTEJSHME PËR PARANDALIMIN DHE TRAJTIMIN E RASTEVE TË DHUNËS SEKSUALE

3.1. ROLI I INSTITUCIONEVE NË PARANDALIMIN E RASTEVE TË DHUNËS SEKSUALE

Parandalimi i rasteve të dhunës seksuale është një strategji që përfshin një tërësi veprimesh si në nivelin individual edhe në atë të komunitetit, kryesisht për mobilizimin e këtij të fundit për të promovuar ndryshimet nënormat dhe sjelljet gjinore, si dhe përpjekjet për të përmirësuar statusin social dhe ekonomik tëviktimave.

Anëtarët e MKR-ve duhet të mbajnë në konsideratë që ndërhyrja për parandalimin e dhunës seksuale mund të jetë në formën e:

a) Ofrimit të mbështetjes dhe kujdesit në aspektin psikologjik. Iniciativa të tilla si këshillimi, terapia apo grupet mbështetëse janë identifikuar si të dobishme veçanërisht pasi ka ndodhur sulmi seksual, sidomos në përshpejtimin e rikuperimit të dëmit psikologjik që lind nga trauma. Gjithashtu, duke qenë se viktimat e dhunës seksuale shpesh fajësojnë vehten për dhunën e pësuar, mbështetja dhe kujdesi në aspektin psikologjik i ndihmon ato të rikuperohen më shpejt dhe të mund të largojnë ndjesinë e dëmshme të vetëfajësimit.

b) Programeve për dhunuesit. Programe efektive në këtë drejtim janë ato që arrijnë që përmes punës me autorët e krimit (dhunës seksuale) t'i bëjnë ata të pranojnë përgjegjësinë dhe të shihen publikisht si përgjegjës për veprimet e tyre. Kjo nënkupton që këto programe duhet të bashkëpunojnë ngushtësisht me shërbimet mbështetëse të specializuara për viktimat, si dhe të organizojnë bashkërisht fushata ndërgjegjësimi kundër dhunës seksuale. Dhunuesi ndjek këto programe në zbatim të masave të marra në urdhrat e mbrojtjes, pas kryerjes së ndëshkimit për dhunën e ushtruar, ose mund t'i ndjekë ato paralelisht kur ofrohen në burgje.

c) Programeve edukuese. Në këtë kuadër vlen kombinimi i programeve edukuese mbi shëndetin seksual dhe të drejtat riprodhuese me çështje që lidhen me të drejtat e grave dhe mbrojtjen nga forma të ndryshme të dhunës së ushtruar ndaj tyre, përfshirë edhe dhunën seksuale. Këtu përfshihen edhe programe rehabilitimi psikosociale dhe/ose në programe të

aftësimin prindëror, të organizuara nga subjekte publike ose private të licensuara. Programe të tilla mund të ndiqen në mënyrë të kombinuar nga burra dhe gra, pasi edhe diskutimet mbi temat e trajtuara mund të kryhen më lehtësisht dhe ndihmojnë sidomos burrat dhunues të kuptojnë dhe marrin përgjegjësi për veprimet e tyre. Aktivitete të tilla mund të jenë edhe sesionet e informimit në shkolla apo fokus grupe në komunitet.

d) Trajnimeve dhe përmirësimit të kapaciteteve të profesionisteve e profesionistëve, për të shpjeguar më në detaje këtë formë të dhunës, shkaqet e pasojat e saj, mënyrën se si mund të trajtohen dhe menaxhohen rastet përmes qasjes shumë-sektoriale të koordinuar, detyrimet dhe përgjegjësitë sipas fushës profesionale, etj.

e) Ngritjes së qendrave të shërbimeve mbështetëse të specializuara për trajtimin e rasteve të dhunës seksuale, në të cilat rastet menaxhohen përmes qasjes shumë-sektoriale të koordinuar, nga një ekip i përbërë nga profesioniste e profesionistë të mirëtrajnuar.

f) Fushatave informuese dhe parandaluese, ku edhe vetë roli i medias merr një rëndësi të veçantë, si në shpjegimin e formës së dhunës ashtu edhe në dhënien e një informacioni të saktë mbi qendrat e specializuara të shërbimeve apo mbi veprimet e tjera që duhet të ndërmerren për parandalimin, mbrojtjen dhe trajtimin e rasteve të tilla, deri në procesin e riintegritimit. Po kështu angazhimi i djemve dhe burave si aleatë në luftën kundër formave të ndryshme të dhunës ndaj grave përfshirë dhe dhunën seksuale, është një tjetër element ndërhyrjeje efikase në këtë drejtim.

g) Programeve të bazuara tek edukimi në shkollë, ku veç shpjegimeve rreth kësaj forme dhune jepet një informacion i detajuar edhe mbi aktorët që duhet të përfshihen dhe veprimet që duhet të ndërmarrin për menaxhimin e rasteve.

h) Përgjigjes përmes kuadrit ligjor e të politikave të përmirësara, në përputhje me standardet ndërkombëtare. Kjo nënkupton përmirësimin në mënyrë të vazhdueshme të këtij kuadri ligjor, si dhe zbatimin e tij në mënyrën e duhur në praktikë.

3.2. INFORMACION MBI INDIVIDËT MË NË RREZIK PËR T'U PREKUR NGA DHUNA SEKSUALE

Dhuna seksuale është një nga format më të rënda të dhunës me bazë gjinore. Ajo kërcënon jo vetëm vajzat dhe gratë, por edhe të miturat/miturit, djemtë dhe burrat dhe në mënyrë të veçantë ajo rrezikon individë që u përkasin komuniteteve dhe grupeve sociale që jetojnë në kushte të disfavourshme, si rrjedhojë e karakteristikave specifike të tyre siç janë minoritetet etnike, personat me aftësi të kufizuara fizike dhe mendore, personat e braktisur, personat orientim seksual dhe shprehje të identitetit gjinor ndryshe nga sa pritet nga shoqëria, personat e institucionalizuar, personat konsumues të substancave, etj.

Asnjë nga viktimat nuk është përgjegjëse për dhunën seksuale që ka përjetuar. Megjithatë, disa karakteristika mund ta bëjnë një person më të cenueshëm ndaj dhunës seksuale dhe llojeve të saj. Këta faktorë rrisin riskun që shërbejnë për të fajësuar viktimën, por për të parandaluar dhunën seksuale duke ndihmuar personat e targetuar si më në rrezik dhe tek të cilët evidentohen faktorët në fjalë. Përgjegjësia për dhunën seksuale është gjithmonë e atij që e kryen atë, pra e dhunuesit.

Individët më në rrezik për t'u prekur nga dhuna seksuale janë:

- Gratë kryefamiljare të vetme, përfshirë vajzat-nëna;

- Të rejat dhe gratë, të cilat kanë qenë të keqtrajtuara apo të dhunuara seksualisht në fëmijëri, si dhe që mund të jenë përdorues të alkoolit apo drogës, ose trafikimit dhe shfrytëzimit të formave të ndryshme;
- Fëmijët, kryesisht fëmijët vajza, të moshës 6 - 17 vjeç (ku nga mosha 6-11 vjeç janë më të rrezikuar nga incesti), të cilët janë jashtë vëmendjes/mbikëqyrjes së prindërve, kanë prindër nën varësi të alkoolit dhe substancave narkotike, ose jetojnë në familje me njerëz/njerë;
- Fëmijët nën kujdes alternativ;
- Fëmijë dhe të rritur me aftësi të kufizuara fizike dhe/ose mendore;
- Fëmijë dhe të rritur përdorues të drogës dhe alkoolit;
- Fëmijë dhe të rritur të cilët kanë përjetuar dhunë dhe abuzim në të kaluarën;
- Fëmijë dhe të rritur në situatë rruge ose/dhe të pastrehë;
- Fëmijë dhe adoleshentë të pashoqëruar;
- Vajzat, të rejat dhe gratë që mbajnë fëmijët e konceptuar nga përdhunimi, si edhe vetë fëmijët e tyre të lindur nga përdhunimi;
- Personat nga komuniteti LBGTI+;
- Vajzat dhe gratë nga komuniteti Rom dhe Egjiptian;
- Gratë e moshuara;
- Gratë, të rejat, vajzat, burrat, të rinjtë dhe djemtë e ndaluar, arrestuar, në pritje të dënimit apo të dënuar.

3.3. KËSHILLA PËR PROFESIONISTET / PROFESIONISTËT QË PUNOJNË DREJTPËRDREJT ME VIKTIMAT E DHUNËS SEKSUALE

Puna me viktimat e dhunës seksuale nuk është asnjëherë e lehtë. Më poshtë jepen disa këshilla praktike se si profesionist/profesionistët mund të bashkëveprojnë me viktimat dhe në të njëjtën kohë të shmangim riviktimizimin e tyre.

Viktimat e dhunës seksuale duhet të:

- Trajtohen me dinjitet dhe respekt, përgjatë gjithë kohës së marrjes së shërbimeve. Kujdesi veçantë duhet treguar gjatë ekzaminimit dhe mbledhjes së provave mjekoligjore, proces ky që duhet paraprirë dhe shoqëruar me informacionin e nevojshëm;
- Njihen me kuadrin ligjor dhe të drejtat e tyre për të përfituar mbrojtje, trajtim, si dhe për të denoncuar rastin me qëllim që dhunuesi të ndiqet penalisht;
- Kenë të drejtën të zgjedhin shërbimet apo trajtimin që do të marrin, pasi të jenë informuar paraprakisht, si dhe të kenë dhënë pëlqimin e informuar. Përrjashtim këtu përbën detyrimi nga ana e profesionistëve për të denoncuar rastin e dhunës seksuale, sipas legjislacionit në fuqi;
- Trajtohen në privatësi dhe sipas parimeve të respektimit të konfidencialitetit dhe ruajtjes së fshehtësisë së të dhënave, përveç rasteve kur ndarja e tyre ndërmjet profesionistëve apo institucioneve të caktuara, përbën detyrim ligjor;
- Mos diskriminohen;
- Informohen mbi shërbimet në dispozicion dhe hapat që do të ndërmerren, në qendrat e specializuara të trajtimit të rasteve të dhunës seksuale, si dhe të referohen për trajtime të mëtejshme afatgjata, në qendra/shërbime mbështetëse të specializuara sipas nevojave që paraqesin.

Profesionistet/profesionistët e të gjithë disiplinave që përfshihen në trajtimin e rasteve të dhunës seksuale, duhet të shmangin:

- Qëndrimet paragjyqese që i fajësojnë viktimat për dhunën e pësuar;

- Veprimet që i bëjnë ato të ndiehen të pafuqishme apo të ripërzjetojnë traumën e dhunës seksuale të pësuar (referim në një institucion pa dhënë shpjegime për shërbimin që do të ofrohet, kryerja e procedurave të ekzaminimit të pashoqëruara me informacionin përkatës mbi këto procedura, kërkesë për të firmosur formularë të caktuar pa dhënë më parë informacionin e duhur mbi përmbajtjen e tyre, etj);
- Komentet që i bëjnë viktimat të ndihen të turpëruara;
- Diskriminimin e viktimave për shkak të gjinisë, moshës, etnisë, aftësisë së kufizuar, orientimit seksual, etj;
- Trajtimin e njëanshëm dhe përjashtues, ose të pa përshtatur me nevojat emergjente, afatmesme apo afatgjata të viktimave.

Profesionistet/profesionistët që punojnë drejtpërdrejt me viktimat e dhunës seksuale këshillohet të:

- Besojnë viktimën pa kushte;
- Pranojnë atë që dëgjojnë pa gjykim;
- Tregojnë viktimës se abuzimi nuk ndodhi për fajin e saj/tij;
- Shmangin pyetje të tilla si “Pse ishte në atë zonë në atë kohë”?
- Kuptojnë që nuk mund të kontrollojnë se si ndiehet viktimja. Është e rëndësishme që të mos supozohet se e dinë se si viktimja ndihet - pothuajse çdo reagim nga ana e viktimës është i mundur dhe plotësisht normal;
- Jenë dëgjues të mirë dhe tregohen të durueshëm;
- Sigurojnë viktimën se janë atje për të kur ajo/ai është gati të flasë;
- Lejojnë të flasë kur dhe nëse viktimja dëshiron të flasë për sulmin seksual;
- Ndihojnë viktimën të rimarrë kontrollin mbi jetën e saj/tij;
- Mbështesin vendimet dhe zgjedhjet që bëjnë viktimja pa dhënë gjykim. Të mundohen të mos i tregojnë viktimës se çfarë të bëjë. Të ndihojnë atë me dhënien e mundësive dhe burimeve që ajo/ai të marrë vendimin e duhur;
- Respektojnë nevojën e viktimës për intimitet;
- Nëse viktimja dëshiron të rrijë vetëm, të respektojnë atë vendim, por mos e lënë atë jashtë vëmendjes;
- Mos sugjerojnë që viktimja “të vazhdojë” me jetën e saj/tij dhe të harrojë abuzimin. Viktimja ka nevojë për mundësinë për të punuar mbi traumën dhe për të filluar procesin e shërimit.
- Mos harrojnë të kujdesen për veten dhe të kërkojnë mbështetje nëse kanë nevojë për të.

3.4.FAKTORËT E RISKUT TEK NJË VIKTIMË E DHUNËS SEKSUALE

Faktorët e rrezikut janë një grup sjelljesh dhe /ose kushtesh të cilat rrisin rrezikun e të qenit viktimë e dhunës seksuale. Një kombinim i faktorëve individualë, ndërpersonalë, komunitarë dhe shoqërorë rrisin gjasat që një individë të jetë viktimë e dhunës seksuale.

Faktorët individual:

- Vetëvlerësim i ulët;
- Beson në të gjithë mitet për marrëdhëniet e dhunshme midis burrit dhe gruas;
- Beson në vlerat e familjes tradicionale dhe të bashkuar dhe respekton e praktikon rolet gjinore tradicionale.
- Merr përgjegjësi dhe fajëson veten për veprimet e kryera nga dhunuesi;
- Mohon frikën dhe zemërimin që ndjen;
- Mban qëndrim pasiv;
- Shfaq shenja dhe bie në situatë stresi, të shoqëruar me ankesa psiko-fiziologjike;

- Përdor marrëdhëniet seksuale për të vendosur marrëdhënie intime;
- Beson se askush nuk mund ta ndihmojë t'i zgjidhë problemet.

Faktorët ndërpersonalë:

- Mjedis familjar i karakterizuar nga dhuna
- Histori të abuzimit fizik, seksual ose emocional;
- Mjedis familjar emocionalisht jo-mbështetës;
- Marrëdhënie të dobëta prindër-fëmijë;
- Përfshirja në një marrëdhënie intime të dhunshme ose abuzive fizike dhe konflikti.

Faktorët komunitarë:

- Varfëria;
- Mungesa e mundësive për punësim;
- Mungesa e mbështetjes institucionale;
- Toleranca e përgjithshme ndaj dhunës seksuale, si dhe mungesa e diskutimeve të hapura rreth kësaj forme dhune brenda komunitetit;
- Numri i ulët i denoncimeve të rasteve të dhunës seksuale dhe i ndëshkimit të dhunuesve.

Faktorët shoqërorë:

- Normat shoqërore që nxitin/favorizojnë dhunën seksuale;
- Normat shoqërore që mbështesin epërsinë dhe të drejtën e burrave për të kryer marrëdhënie seksuale;
- Normat shoqërore që ruajnë inferioritetin dhe nënshtrimin seksual të grave;
- Mungesa e zbatimit korrekt dhe në kohën e duhur të kuadrit ligjor mbi dhunën ndaj grave e dhunën në familje;
- Nivele të larta krimi dhe forma të tjera dhune;
- Shoqëria nuk pranon dhunën seksuale në marrëdhëniet martesore dhe nuk flet për të.

IV.ANEKSE

ANEKS 1: FORMAT TIP REFERIMI TË RASTIT NË QENDRËN E MENAXHIMIT TË KRIZËS PËR RASTET E DHUNËS SEKSUALE

Format TIP referimi të rastit në Qendrën e menaxhimit të krizës për rastet e dhunës seksuale

Data e referimit:	Numri i identifikimit të rastit: (Plotësohet vetëm nga qendra e menaxhimit të krizës për rastet e dhunës seksuale)		
Emri i personit që bën referimin:	Institucioni:		
Pozicioni/Roli i personit që bën referimin:	Numër telefoni: Email:		
Lloji i shërbimit për të cilin ka nevojë rasti			
Ekzaminim mjeko-ligjor <input type="checkbox"/>	Vlerësim psikologjik <input type="checkbox"/>	Akomodim <input type="checkbox"/>	Mbështetje mjekësore <input type="checkbox"/>

Detajet/të dhënat e rastit	
Emri: Mbiemri: Data e lindjes: Mosha:	Numër telefoni: Email:
Adresa:	Të dhënat e prindit/kujdestarit ligjor (plotësohet vetëm për të mitur) Emri: Mbiemri: Adresa: Numër telefoni: Email:
Gjinia:	Orientimi seksual:
Etnia:	Kombësia:
Gjuha:	Nevojitet interpret i gjuhës së shenjave: PO <input type="checkbox"/> JO <input type="checkbox"/>
Gjendja civile:	Punësimi:

Arsimi:
Dhunë seksuale e përsëritur: PO <input type="checkbox"/> JO <input type="checkbox"/>

III.

Aftësi e kufizuar		Nevojat komplekse			
Sëmundje afatgjatë <input type="checkbox"/>	Fizike <input type="checkbox"/>	Alkool <input type="checkbox"/>	Drogë <input type="checkbox"/>	Shëndeti mendor <input type="checkbox"/>	Vetëdëmtim <input type="checkbox"/>
Dëgjim <input type="checkbox"/>	Të nxënë <input type="checkbox"/>	Veprimtari të paligjshme <input type="checkbox"/>	Martesë në të moshë hershme <input type="checkbox"/>	E/I pastrehë <input type="checkbox"/>	Viktimë trafikimi <input type="checkbox"/>
Shikimi <input type="checkbox"/>	Asnjë <input type="checkbox"/>	Shfrytëzim seksual <input type="checkbox"/>	Përdhunim <input type="checkbox"/>		
Çështje të tjera:					

IV.

Informacion për abuzuesin				
Emri: Mbiemri: Data e lindjes: Mosha:	Adresa:			
Gjinia:	Orientimi seksual:			
Marrdhënia me viktimën:	Gjendja civile:			
Etnia:	Punësimi:			
Arsimi:				
Për sa kohë e ka njohur viktimën:	Për sa kohë e ka abuzuar:			
Profili i abuzuesit				
Alkool <input type="checkbox"/>	Drogë <input type="checkbox"/>	Aftësi e kufizuar <input type="checkbox"/>	Shëndet mendor <input type="checkbox"/>	Vetëdëmtim <input type="checkbox"/>
Histori mëparshme të dhunë <input type="checkbox"/>	Historik të sulmit seksual <input type="checkbox"/>	Përdorues droge <input type="checkbox"/>	E/I pastrehë <input type="checkbox"/>	Probleme ekonomike <input type="checkbox"/>
Veprimtari të paligjshme <input type="checkbox"/>	Dënime të mëparshme <input type="checkbox"/>		Asnjë <input type="checkbox"/>	E/I panjohur <input type="checkbox"/>
Çështje të tjera:				

V.

Të dhëna për fëmijët (plotësohet vetëm nëse rasti ka fëmijë)					
Emri	Mbiemri	Data e lindjes	Mosha	Gjinia	Etnia

Adresa e fëmijës/ve:
(nëse është e ndryshme nga e rastit)

Fëmijë të birësuar: PO JO

VI.

A është viktima shtatzënë? PO / JO A është shtatzania pasojë e abuzimit: PO / JO

A ka persona të tjerë që jetojnë në të njëjtën banesë? PO / JO
Specifiko:

VII.

Shërbim-ofruar të tjerë në kontakt me rastin

Emri:	Kontakt:	Numër telefoni:
-------	----------	-----------------

Lloji i shërbimit:

VIII.

Historik i rastit

Data e incidentit të fundit:	Raportuar në polici: PO / JO	Sa herë ka ndodhur abuzimi:
------------------------------	------------------------------	-----------------------------

Arsyet për referim dhe abuzimi i përjetuar:

ANEKS 2: FORMAT REFERIMI I RASTIT NË INSTITUCIONET E TJERA

Format referimi i rastit në institucionet e tjera

Data e referimit:	Institucioni që merr referimin:
	Emri i personit të kontaktit:
	Numër telefoni:
	Email:
Emri i personit që bën referimin:	Institucioni:
Pozicioni/Roli i personit që bën referimin:	Numër telefoni:
	Email:

Emri/Mbimri i rastit/viktimës:	Emri/mbimri i abuzuesit:
Gjinia:	Gjinia:
Adresa:	Adresa:
Telefon:	Telefon:

Arsyet për referim:

Përmbledhje e rrezikut/rreziqeve për rastin:

Shërbime të ofruara:

<u>Agjensi të tjera të përfshira në trajtimin e rastit:</u>
<u>Nënshkrimi i rastit/viktimës: (Pajtohem që të referohem në: _____ . Unë jam informuar nga referuesi dhe më janë shpjeguar arsyet për referim)</u>

Vlerësimi i rrezikut për viktimat e dhunës seksuale

Emri i personit/institucionit që bën raportimin:					
Data kur është bërë raportimi:					
Marrdhënia me viktimën:					
Viktima					
Emri:	Mbiemri:				
Etnia:	Gjinia:	Data e lindjes:			
Nevoja të veçanta/ aftësi të kufizuara/probleme të shëndetit mendor nëse ka:					
A ka dëmtime të dukshme:	Po	Jo	A raporton viktimat dhimbje:	Po	Jo
A janë përdorur armë:	Po	Jo	A mendon viktimat se është droguar:	Po	Jo
A ka përdorur viktimat alkool:	Po	Jo	A ka përdorur viktimat vullnetarisht substanca të tjera:	Po	Jo
A është abuzuar viktimat në mënyrë të vazhdueshme:	Po	Jo	A mendohet se ka viktimat të tjera të mundshme:	Po	Jo
A raporton viktimat probleme shëndetësore? Specifikoj.	Po	Jo			
A ndjehet viktimat shumë frikësuar nga dhunuesi?	Po	Jo	A është larguar nga shtëpia? A dëshiron të largohet nga shtëpia?	Po	Jo
Dhunuesi					
Emri Mbiemri:					

<u>Gjinia:</u>					
<u>Mosha:</u>					
Konflikt me ligjin/dhunë seksuale/armëmbajtje pa leje/vepra të tjera penale,	<u>Po</u>	<u>Jo</u>	Probleme nga përdorimi i alkoolit/narkotikëve	<u>Po</u>	<u>Jo</u>
Probleme nga përdorimi i alkoolit/narkotikëve	<u>Po</u>	<u>Jo</u>	Probleme të shëndetit mendor	<u>Po</u>	<u>Jo</u>
A është ushtruar dhuna seksuale në prani të fëmijëve?	Po	Jo	A përbën dhunuesi një rrezik për fëmijët?	Po	Jo
<u>Konsiderata të tjera në lidhje me viktimën:</u>					
<u>Konsiderata të tjera në lidhje me dhunuesin:</u>					
<u>Informacion mbi incidentin/et</u>					
Vendndodhja e viktimës përpara sulmit:					

Vendi ku ka ndodhur sulmi:					

<u>Përshkruaj incidentin e fundit</u>					

<u>Përshkruaj incidentet e kaluara, nëse rezulton se viktimja është abuzuar seksualisht në mënyrë të vazhdueshme.</u>					

Nëse rezulton se viktimja është abuzuar seksualisht në prani të fëmijëve, Cila është gjendja e fëmijëve që kanë qenë të pranishëm gjatë ushtrimit të dhunës?					

<u>Lloji i presionit të ushtruar:</u>					
<input type="checkbox"/> Mos-respektim i mungesës së pëlqimit					
<input type="checkbox"/> Presion/detyrim verbal					
<input type="checkbox"/> Presion si shkak i autoritetit					
<input type="checkbox"/> Ushtrim i forcës/dhunës fizike					
<input type="checkbox"/> Kërcënim me armë					
<input type="checkbox"/> Kërcënim me vdekje					
<input type="checkbox"/> Rrëmbim					
<u>Lloji i sulmit të kryer</u>					
Në tentativë	I përfunduar				
		Përdhunimi (shtrëngim fizik ose penetrim duke përdorur shtrëngimin – edhe nëse në masë të vogël - të vulvës ose			

		anusit, duke përdorur një penis, pjesë të tjera të trupit ose një objekt)
		Kontakt i detyruar oral-gjenital
		Tjetër (specifiko)

Kujdes: Faktorët e riskut të sipërcituar nuk janë ezaurues, ato mund të pasurohen më tej në varësi të specifikave të rastit.

FORMULARI IPËLQIMITPËR RAPORTIMIN E RASTIT

Unë _____ i nënshkruari/e nënshkruara _____ me anë të këtij formulari i japmiratimin tim (emri i institucionit/menaxherit të rastit), të ndajë të dhënat dhe informacione personale me ofruesit e tjerë të shërbimeve, duke përfshirë informacione mbi gjendjen mjekësore, shëndetin mendor, situatën ligjore dhe informacione të tjera të nevojshme. Pajtohem që të kryhet referimi i rastit në mënyrë që të adresohen nevojat e mia tek shërbimet ekzistuese dhe të specializuara.

Unë e kuptoj që (emri i institucionit/menaxherit të rastit) mund të ruajë të dhëna dhe informacione të mbledhura nga institucione/individë të ndryshëm dhe të drejtat e mia nuk do të çenohendhe do të përpunohen dhe administrohen në përputhje me ligjin “Për mbrojtjen e të dhënave personale” dhe akteve nënligjore përkatës.

Deklarata e Pëlqimit:

- Unë e kuptoj që do të ruhen të dhëna personale;
- Unë kam pasur mundësinë të diskutoj mbi pasojat e ndarjes dhe të mos ndarjes së të dhënave personale.
- Pajtohem që të dhënat personale të ndahen me institucionin/et si më poshtë:
 1. Emri i institucionit me të cilin do të ndahet informacion: _____
 2. Emri i institucionit me të cilin do të ndahet informacion: _____

A ka ndonjë institucion me të cilën nuk dëshironi të ndahen informacione apo të dhëna personale? Ju lutemi renditini këtu:

Pëlqimi juaj për të ndarë informacione personale është plotësisht vullnetar.

Emri

Mbiemri

Nënshkrimi


Data

Nënshkrimi i përfaqësuesit/es së institucionit/ menaxherit/es së rastit:

Emri i institucionit

HARTA E SHËRBIMEVE REZIDENCIALE PUBLIKE DHE JO-PUBLIKE TË STREHIMIT AFATGJATË PËR VIKTIMAT E DHUNËS ME BAZË GJINORE DHE DHUNËS NË FAMILJE

Qendrat rezidenciale publike dhe jopublike që ofrojnë shërbime afatgjata, për viktimat e dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje



Kontakte:

➤ Tiranë:

- Qendra Kombëtare e Trajtitimit të Viktimave të Dhunës në Familje; Tel: +355695500895
- Strehëza për Gratë dhe Vajzat e Dhunuara, Tiranë; Tel: +355 042261885/ + 355 692070031; E-mail: sawg.albania@gmail.com

- Qendra Kombetare Pritëse e viktimave të Trafikimit; Tel: +355692649181
- Qendra Të ndryshëm dhe të Barabartë, Email: different&equal@icc-al.org
- Tel: 0696308188
- Streha LGBTI; Tel: +355699839189; Email: sos@strehalgbt.al
info@strehalgbt.al ndihme@strehalgbt.al;
- **Shkodër:** Komuniteti Papa Xhovanni XXIII; Tel: +355 682142650
- **Vlorë:** Qendra Psiko - Sociale "Vatra, Tel: +355 33 224078 /+ 355 698884613;
Email: info@qendravatra.org.al;
- **Elbasan:** Tjetsan: avatTel: +355 692030201 Email: tjetervizion@gmail.com

V. REFERENCA

- “Responding to sexual violence: community approaches”, Human Rights Center, University of California, Berkeley, May 2011.
- “Interagency gender-based violence cases’ management guidelines”, GBV IMS Steering Committee, 2017
- “Caring for Child survivors of sexual abuse”, International Resque Committee, 2012
- “Protokolli Ndërkombëtar për Dokumentimin dhe Hetimin e Dhunës Seksuale në Konflikt”, qershor 2014
- UN Women Virtual Knowledge Center